# PLANI VENDOR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE NË BASHKINË PRRENJAS 2025-2029

**Gusht, 2025**

Ky studim është pregatitur me mbeshtetjen e projektit Bashki të Forta zbatuar nga Helvetas përmes fondeve të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përgjatë periudhës Shtator 2023– Mars 2024.

Një falenderim i veçantë shkon për stafin e dldp HELVETAS Sëiss Intercooperation Znj. Valbona KARAKAÇI dhe Z. Arben KOPLIKU, dhe për stafin e asistencës teknike të EcoDES **Consultancy** Z. Konalsi GJOKA dhe Znj. Teida SHEHI që kontribuan në hartimin e planit lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve për Bashkinë Prrenjas.

Një kontribut të veçantë ka dhënë stafi i Bashkisë Prrenjas i kryesuar nga Kryetari I Bashkisë Z. Nuri Belba , i cili ka luajtur një rol kyç në ecurinë e procesit të hartimit planit si dhe stafi teknik, i kryesuar nga zv. Kryetari Z. Aurel KARRIQI, Ing. Mjedisit Znj. Gordana KARAJ,Drejtori i Shërbimeve Publike Z.Olgert ALLA , Drejtori i të Ardhurave dhe Tatimeve Znj.Marseda VASKU

Gjithë të drejtat janë të rezervuara. Materiali në këtë studim mund të citohet lirisht, pasi të sigurohet autorësia. Çdo përdorim tjetër komercial ose për qëllime të tjera përfituese duhet të marri aprovimin paraprak nga bashkia Prrenjas.

**SHKURTIMET**

| | |
|---|---|
| DLDP | Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal |
| DPTSHIP | Drejtoria e planifikimit të territorit shërbimeve dhe infrastrukturës publike |
| EZ | Ekipi i zbatimit |
| GP | Grupi i punes |
| LMIM | Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| EDS | EcoDES Studio |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NJA | Njësia Administrative |
| PGM | Pikë grumbullimi mbetjesh |
| PVMMU | Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane |
| PKMM | Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve |
| PRMM | Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve |
| RrC | Rregjistri Civil |
| SKM | Strategjia Kombëtare e Mbetjeve |
| VGM | Vend grumbullimi mbetjesh |
| ZAM | Zona e Administrimit të Mbetjeve |

# Përmbajtja:

**LISTA E TABELAVE, HARTAVE DHE GRAFIKËVE ..... 7**

**I. HYRJE ..... 9**

1.1 Çfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake? ..... 9

1.2 Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet ..... 10

1.3 Procesi i hartimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes ..... 11

**II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKA KOMBËTARE E RAJONALE ..... 14**

2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar ..... 14

2.2 Politikat kombëtare ..... 16

2.3 Politikat sipas planit rajonal ..... 16

**III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME ..... 18**

3.1 Profili i Bashkisë ..... 18

3.1.1 Pozita gjeografike e Bashkisë ..... 18

3.1.2 Hidrografia ..... 20

3.1.3 Demografia ..... 21

3.1.4 Bizneset dhe Institucionet ..... 25

3.1.5 Rrjeti rrugor ..... 25

3.1.6 Gjëndja e përgjithshme mjedisore ..... 26

3.2. Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve ..... 27

3.2.1 Organizimi në nivel qendror ..... 27

3.2.2 Organizimi në nivel rajonal ..... 28

3.2.3 Organizimi në nivel lokal ..... 28

3.2.4 Struktura e Bashkisë për mbetjet ..... 29

3.2.5 Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet ..... 30

3.3 Analiza e mbetjeve ..... 31

*3.3.1 Shërbimet e mbetjeve* ..... 31

*3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane* ..... 32

3.3.3 Pastrimi i rrugëve ..... **Error! Bookmark not defined.**

3.3.4 Depozitimi ..... 54

3.3.5 Riciklimi ..... 56

3.4 Ekonomia dhe Financimi.....57

3.4.1 Buxheti vjetor dhe investimet.....57

3.4.2 Ndarja e kostove.....58

3.4.3 Tarifat dhe realizimi i të ardhurave.....58

3.5 Performanca aktuale e administrimit të mbetjeve vendore.....68

3.5.1 Analiza e indikatorëve të performancës.....68

3.5.2 Vlerësimi i performancës përmes kënaqësisë së banorëve**Error! Bookmark not defined.**

**IV. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE.....70**

4.1 Vizioni.....70

4.2 Objektivat.....70

4.3 Objekti i Planit.....71

4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekt i planit.....71

4.4 Skenarët e administrimit të mbetjeve.....73

4.4.1 Menaxhimi i mbetjeve bazuar ne objektivat ndërkombëtar, kombëtare dhe rajonale.....74

4.4.2 Administrimi i mbetjeve bazuar në grumbullimin miks të tyre.....76

4.4.3 Buxhetimi në bazë aktiviteti.....82

**V. PERSPEKTIVA FINANCIARE.....97**

5.1. Çështja e financimit dhe strategjia e "mbulimit të kostos".....97

**VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....102**

6.1 Rregullorja vendore.....102

6.2 Detyrimi dhe sanksionet.....103

6.3 Liçencimi Mjedisor.....105

6.4 Pjesëmarrja e Sektorit Privat.....105

6.5 Mbështetja Politike.....106

**VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK.....108**

**VIII. PLANI I AKTIVITETEVE.....111**

**IX. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....117**

Detyrat e ekipit monitorues.....119

**SHTOJCA.....**ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Inventari i rrjetit rrugor, Bashkia Prrenjas.....122

PËRCAKTIMI I VENDEVE TË KONTENIERËVE TË MBETURINAVE**Error! Bookmark not defined.**

## Lista e tabelave, hartave dhe grafikëve

*Tabela 1. Fazat e procesit të hartimit të PVMMU në Bashkinë Prrenjas*
*Tabela 2. Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet*
*Tabela 3. Ndarja sipas njësive administrative dhe përbërja në qytete dhe fshatrave*
*Tabela 4: Shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshave CENSUS*
*Tabela 5: Shpërndarja e popullsisë sipas të dhenave të GJC*
*Tabela 6: Shpërndarja e banesave sipas llojit dhe kateve*
*Tabela 7. Familjet me ndihmë ekonomike e aftësi të kufizuar, Bashkia Prrenjas*
*Tabela 8: Shpërndarja e institucioneve dhe bizneseve sipas NJA*
*Tabela 9: Rrjeti rrugor ne Bashkinë Prrenjas*
*Tabela 10: Gjenerimi i mbetjeve*
*Tabela 11:Mbulimi i shërbimit në vitet 2025-2029*
*Tabela 12: Infrastruktura e mbetjeve në Bashkinë Prrenjas*
*Tabela 13: Sipërfaqe rrugë e trotuare që pastrohen*
*Tabela 14: Kosto e nevojshme për mbylljen e Vend depozitimit Krastë*
*Tabela 15: Treguesit kryesorë të shërbimit të pastrimit*
*Tabela 16: Programi i shërbimeve Publike*
*Tabela 17: Niveli i tarifave dhe të ardhurat për vitin 2025*
*Tabela 18: Planifikimi dhe realizmi i të ardhurave sipas viteve 2025-2026-2027*
*Tabela 19: Pesha specifike e kostos së pastrimit, Bashkia Prrenjas për vitin 2025*
*Tabela 20: Kosto analitike e shpenzimeve, Bashkia Prrenjas për vitin 2025*
*Tabela 21:. Të dhëna të ngarkesës së punës së punonjësve të shërbimit të pastrimit*
*Tabela 22:. Indikatorët e performancës, viti 2022*
*Tabela 23: Politikat e PVMMU*
*Tabela 24: Mbetjet sipas fraksioneve që nuk depozitohen në landfill*
*Tabela 25: Kosto transporti që kursehet nga mosdepozitimi i mbetjeve në landfill*
*Tabela 26: Dendësia e PGM-ve*
*Tabela 27: Numri banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2025-2029*
*Tabela 28: Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve në bazë vjetore*
*Tabela 29: Mbledhja e mbetjeve për vitet 2025-2029*
*Tabela 30: Llogaritja e numrit të kontenierëve për vitet 2025-2029*
*Tabela 31: Kosto e fshirjes së rrugëve*
*Tabela 32: Kosto e larjes së rrugëve*
*Tabela 33: Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh*
*Tabela 34: Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme*
*Tabela 35: Kosto e larje e disfektim kontenierë*
*Tabela 36: Kosto e mirëmbajtjes*
*Tabela 37: Kosto e grumbullimit të mbetjeve*
*Tabela 38: Kosto e transportit të mbetjeve*
*Tabela 39: Kosto e shoferëve dhe operatorëve*
*Tabela 40: Kosto e amortizimit*
*Tabela 41: Kosto administrative*
*Tabela 42: Kosto e totale e shërbimit*
*Tabela 43: Struktura e kostos së shërbimit*
*Tabela 44: Kosto e totale e shërbimit*
*Tabela 45: Struktura e kostos së shërbimit në vitin 2029*
*Tabela 46: Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2025-2029*
*Tabela 47: Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave*
*Tabela 48: Koeficineti i mbulimit të kostos 2025-2029*
*Tabela 49: Aktorët kryesor dhe përgjegjësitë e tyre*
*Tabela 50: Skema e raportimit mbi monitorimin e shërbimit*

*Harta 1: Ndarja administrative e qarkut Elbasan*
*Harta 2: Ndarja adminsitrative e Bashkisë Prrenjas*
*Harta 3: Harta Fiziko - Gjeografike e Bashkisë Prrenja*
*Harta 4: Kushtet Klimatike*
*Harta 5: Hidrografia e Bashkise Prrenjas*
*Harta 6: Shpërndarja e banesave sipas NJA*
*Harta 7: Infrastruktura Rajonale*
*Harta 8: Skema e organizimit institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor*
*Harta 9: Organograma e Bashkisë*
*Harta 10: Mbulimi i shërbimit në Bashkinë Prrenjas*
*Harta: 11: Shpërndarja e PGM në qytetin e Prrenjasit*
*Harta 12: Shpërndarja e PGM në Prrenjas fshat*
*Hartat 13: Shpërndarja e PGM në fshatin Rashtan*
*Hartat 14: Shpërndarja e PGM në fshatin Bërzeshtë*
*Hartat 15: Shpërndarja e PGM në fshatin Karkavec*
*Hartat 16: Shpërndarja e PGM në fshatin Manastrec (Dritaj)*
*Harta 17: Shpërndarja e PGM në fshatin Pishkash -Qendër*
*Harta 18: Shpërndarja e PGM në fshatin Pishkash -Veri*
*Harta 19: Shpërndarja e PGM në fshatin Qukës-Qendër*
*Harta 20: Shpërndarja e PGM në fshatin Qukës-Shkumbin*
*Harta 21: Shpërndarja e PGM në fshatin Qukës-Skëndërbej*
*Harta 22: Shpërndarja e PGM në fshatin Skroskë*
*Harta 23: Shpërndarja e PGM në fshatin Bardhaj*
*Harta 24: Shpërndarja e PGM në fshatin Rrajce-Skenderbej*
*Harta 25: Shpërndarja e PGM në fshatin Gjashtë -Lis*
*Harta 26: Shpërndarja e PGM në fshatin Katjel*
*Harta 27: Shpërndarja e PGM në fshatin Kotodesh*
*Harta 28: Shpërndarja e PGM në fshatin Urake*
*Harta 29: Shpërndarja e PGM në fshatin Rrajcë*
*Harta 29: Shpërndarja e PGM në fshatin Sutaj*
*Harta 31: Shpërndarja e PGM në fshatin Stravaj*

*Grafiku 1: Shkalla e papunësisë sipas zonave urbane/rurale*
*Grafiku 2: Shkalla e papunësisë sipas grupmoshës dhe gjinisë*
*Grafiku 3: Prodhimi i mbetjeve ne nivel vendor*
*Grafiku 4: Struktura tarifave sipas grupimeve tatimore 2025*
*Grafiku 5: Niveli i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave 2025-2029*
*Grafiku 6: Struktura e kostos së shërbimit 2025*
*Grafiku 7: Skema ideale e mbledhjes së mbetjeve*
*Grafiku 8: Skema e manaxhimit miks të mbetjeve*
*Grafiku 9: Rritja e numrit të kontenierëve në 5 vitet e ardhshme*
*Grafiku 10. Struktura e kostos operacionale*
*Grafiku 11: Ndryshimi i kostos së shërbimeve 2025-2029*
*Grafiku 12: Struktura e kostos së shërbimit në vitin 2029*

# I. HYRJE

## *1.1 Çfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake?*

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane (PVMMU) është një dokument udhëzues dhe planifikues, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare dhe rajonale të mbetjeve në nivel vendor, pra, mundëson orientimin strategjik të Bashkisë Prrenjas drejt një menaxhimi të integruar e të qëndrueshëm të mbetjeve.

Qëllimi i këtij plani është të parashtrojë një përqasje të qartë të politikave të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, duke tentuar drejt një harmonizimi sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës të interesave dhe qëndrimeve të përbashkëta midis aktorëve të ndryshëm të interesuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

PVMMU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Më konkretisht, PVMMU përcakton mënyrën sipas të cilës do të manaxhohen mbetjet në Bashkinë Prrenjas dhe ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj, duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- Të ndërtojë dhe krahasojë skenarët specifikë të menaxhimit të mbetjeve për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon dhe rekomandon teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjesimin) final të mbetjeve;
- Të propozojë dhe rekomandojë hartimin e instrumentave të rëndësishëm institucionale, organizativ dhe financiar. Plani mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij;
- Të parashikojë koston operative të shërbimit dhe nevojat financiare për investime, duke përshkruar dhe argumentuar këto nevoja të lidhura me zbatimin e skemave efektive të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Të ndërtojë instrumentat për informimin, komunikimin dhe monitorimin e planit në përgjithësi dhe treguesve të shërbimit në vecanti.

**Ky është plani i  dytë për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Prrenjas.**

## *1.2 Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet*

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të "granteve të pakushtëzuara".

Bashkia Prrenjas tashmë përfshin një territor të zgjeruar me zona urbane dhe rurale, ku prezantohen sisteme menaxhimi të ndryshme dhe mungesë e shërbimit në të gjithë territorin.

Sistemet kryesore për menaxhimin e mbetjeve kanë konsistuar vetëm në grumbullimin miks të mbetjeve të ngurta urbane dhe transportimin e tyre drejt vendeve të grumbullimit nën administrimin e vetë njësive lokale, por mungojnë nismat dhe politikat vendore, për të zvogëluar dhe diferencuar sasinë e mbetjeve në burim.

Në përgjithësi, problematika në sektorin e mbetjeve lidhet ngushtë me mungesën e instrumenteve të duhura për menaxhimin mjedisor të tyre, mungesën e teknologjive dhe investimeve dhe kapacitetet e pamjaftueshme në burimet njerëzore dhe financiare.

Për më tepër, përpjekjet e deritanishme për të adresuar këtë problematikë kanë qenë të pa koordinuara, të fragmentarizuara dhe joefikase.

**Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit**

Vendim Nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035.

Polotika strategjike dhe Plani Kombëtar I menaxhimit te integruar te mbetjeve 2020 -2035.

Politika kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, përfshin edhe detyrimin ligjor për hartimin e një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane, (SKMM, PKMM, neni 12 i ligjit Nr.10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"), që çdo njësi të qeverisjes vendore apo grup njësish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve[1]; ku mbrojtja e mjedisit nga ndotja përbën përparësi dhe është e detyrueshme edhe nga bashkia[2]; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të Integruar të mbetjeve".

Hartimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve[3], planit rajonal dhe atij lokal është një detyrim, që rrjedh nga direktivat e Këshillit të Evropës që Shqipëria duhet të zbatojë si një vend potencial për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian[4].

.

[1] Bashkia përgatit planin vendor të menaxhimit të mbetjeve konform kërkesave të nenit 10 të ligjit 10463/2011.

[2] Sipas nenit 11 të ligjit 10431/2011, Bashkia brenda kompetencave të saj, harton planin përmes bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit

[3]Miratuar: VKM nr.175, datë 19.1.2011 në qershor 2006 është firmosur Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dherrjedhimisht Qeveria Shqiptare ka marrë një seri angazhimesh që janë përqendruar në arritjen e pranimit në BE.

### *1.3 Procesi i hartimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes*

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në mirëqeverisjen vendore të bashkisë Prrenjas në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane duke ngritur kapacitetet e administratës dhe përmirësuar kuadrin rregullator të menaxhimit të mbetjeve urbane.

Nëpërmjet këtij projekti përpjekjet tona më të mëdha u fokusuan në promovimin e përqasjes gjithëpërfshirëse, transparencës në hartimin e planit vendor si një ndër treguesit kryesor të mirëqeverisjes dhe demokracisë. Për herë të parë PVMMU është bazuar mbi indikatorë të performancës duke synuar monitorimin e cilësisë së shërbimit si edhe përfshirjen e publikut në proces. Procesi i hartimit të PVMMU në Bashkinë Prrenjas filloi në shkurt të shtator 2023 dhe kaloi në 5 faza kryesore (figura 1)






*Tabela 1. Fazat e procesit të hartimit të PVMMU në Bashkinë Prrenjas*

Plani u hartua si një proces, i cili kaloi në fazat e mëposhtme:

> **Grumbullim informacioni > Analizë e gjendjes > Projektim > Diskutim > Konsultime > Projektim > Verifikim në terren > Grumbullim të dhënash të mëtejshme > Projektim > Konsultim > Dakortësim > Finalizim > Miratim.**

Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor i miratuar nga KKT Nr.03 datë 17.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkisë Prrenjas objektivat kryesore për mbrojtjen e mjedisit janë:

**Sistemi - urban/natyror realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/ depozitimi/ bartja (trajtimi në Elbasan).**




*Harta 1: Ndarja administrative e qarkut Elbasan*

## Objektivat

- Menaxhimi i territorit në lidhje me ciklin e mbetjeve
- Rizhvillimi dhe mbrojtja e vlerave mjedisore dhe qëndrueshmëria
- Mbrojtja e vlerave ekologjike dhe ndikimet mjedisore të antropogjenëve

## Veprimet dhe përshkrimi

- Prezantimi i menaxhimit të integruar dhe të strukturuar i mbledhjes së mbetjeve
- Identifikimi dhe zbatimi i një vendi për grumbullim dhe për mbetjet stok të dërguara (për çdo njësi administrative)

Veprimet e propozuara kërkojnë të punohet për zbatimin e ligjit për braktisjen e mbetjeve dhe ndotjes si dhe për të menaxhuar mbetjet në të gjithë rrugën e tyre, të mbledhjes e asgjesimit.

Qëllimi është për të krijuar një sistem të centralizuar të mbledhjes për çdo strehim bazë dhe për çdo njësi administrative, në të cilën ka zona ekologjike në të cilat mund të depozitohen mbetjet ose kazanët e pozicionuar në zonat strategjike; për më tepër ajo ka për qëllim të krijojë një sistem të grumbullimit të strukturuar ku mbetjet më pas grumbullohen në një qender vetëm për të kryer si duhet përpunimin/trajtimin në Elbasan.

**KOHERENCA ME OBJEKTIVAT E PLANIFIKIMIT KOMBËTAR**

- Zhvillimi i qëndrueshëm, rritja e qëndrueshme dhe e balancuar e territorit;
- Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve;
- Krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversitetit, burimeve natyrore, trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Pajtueshmëria e zgjedhjeve me udhëzimet evropiane për zhvillimin e territorit;
- Përdorimi dhe menaxhimi inteligjent i ekosistemeve urbane në veçanti në marrëdhëniet e tyre me rrugët ujore, të energjisë dhe mbetjeve;
- Ruajta e pejsazhit si një bashkim i elementëve antropike e natyrore të organizuar sipas një skeme territoriale funksionale për zhvillimin e aktivitetit dhe për të ruajtur mjedisin në tërësinë e tij;
- Realizimi i ndërhyrjeve me impakt të ulët në pejsazh, në të cilin të vihet theksi në organizimin dhe eficenca prodhuese por në mënyre që të mos rezultojë dëmtuese për pejsazhin dhe cilësinë e territorit;
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisore që ndodhen në këto territore;

# II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKA KOMBËTARE E RAJONALE

## *2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar*

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE.

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së MTM. Ndarja e mbetjeve në burim, rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plotë i hedhjes së mbetjeve në vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plotë i djegies së mbetjeve, ndërtimi i landfilleve sipas standardeve te BE-së, sigurimi i lehtësive për mbetjet e rrezikshme, spitalore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve të reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit te mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë.
LMIM adapton shumicën e direktivave, vendimet dhe rregulloret e BE-së, dhe parashikon prioritetet dhe hierarkinë për menaxhimin e mbetjeve që paraprihet nga: (1) parandalimi; (2) ripërdorim; (3) riciklimi; dhe (4) alternativa të tjera, si burim energjie; dhe (5) asgjësimin përfundimtar".

Ligji përcakton njëherazi dhe hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, ndër të tjera pushteti vendor duhet të hartojë, miratojë dhe zbatojë PVMMU.

Përveç kësaj, akte të tjera ligjore, të cilat janë zhvilluar më vonë për zbatimin e ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, kanë përcaktuar përgjegjësi të detajuara institucionale, duke përfshirë MTM dhe MIE:

- ✓ VKM nr. 509, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit”;
- ✓ VKM nr. 504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Enrgjisë”;

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve plotësohet me Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili në nenin 23, përcakton që mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, është tërësisht një përgjegjësi funksionale dhe organizative e bashkisë.

Ligji për koncesionet dhe PPP 125/2013 i miratuar nga Parlamenti më 25/04/2013, lehtëson njësitë e qeverisjes vendore në përfshirjen e kapitalit privat përmes zhvillimit të programeve të PPP.

Më poshtë pasqyrohet përmbledhja ligjore në fushën e mbetjeve:

| | |
|---|---|
| **Ligjet kryesore në fushën e mbetjeve** | **Ligji nr.10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar me ligjin nr.156, date 10.1 2013.** |
| | **Ligji nr. 8094**/1996 "Për largimin publik të mbetjeve". |
| | **Ligji nr. 9537**/2006 "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", iazhornuar me ligjin nr.9890, datë 20.03.2008. |
| **Ligjet dytësore në fushën e mbetjeve** | **VKM nr. 389/2018** "për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të këshillit të ministrave, "për lendfillet e mbetjeve" |
| | **VKM 319/2018** për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve |
| | **VKM 232/2018** për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të këshillit të ministrave, për ambalazhet dhe mbetjet e tyre; |
| | **VKM nr. 652/2016** "për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura" |
| | **VKM nr.687/2015** "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve". |
| | **VKM nr.575/2015** "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". |
| | **VKM 418/2014** "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" |
| | **VKM 641/2014** "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte" |
| | **VKM nr.608/2014** "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre". |
| | **VKM 117/2013** "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje" |
| | **VKM Nr. 866 / 2012** "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre". |
| | **VKM Nr. 705 /2012** "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës" |
| | **VKM nr. 452/2012** "Për lendfillet e mbetjeve" |
| | **VKM Nr. 178/2012** "Për Incinerimin e mbetjeve" |
| | **VKM nr. 177/2012** "Për amballazhet dhe mbetjet e tyre, ndryshuar me VKM nr.52, date 5.2.2014". |
| | **VKM Nr. 765/2012** "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur" |
| | **VKM nr. 333/2011** "Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane". |
| | **VKM 175/2011 "**Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve" |
| | **VKM 798/2010 "**Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" |
| | Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 "Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe shkatërrimet, nga krijimi, transporti dhe deri tek trajtimi përfundimtar" |
| | Rregullore nr. 6, datë 30.11.2007 "Për administrimin e mbetjeve spitalore" |
| | Udhëzues nr. 6, datë 27.11.2007 "Për aprovimin e rregullave, përmbatjes dhe afatave për skicimin e planeve për menaxhimin e mbetjeve" |
| **Akte të tjera ligjore që lidhen direkt apo indirekt edhe me menaxhimin e** | **Ligji nr.10431/2011** "Për mbrojtjen e mjedisit". |
| | **Ligji nr.9663/2006** "Për koncensionet", të ndryshuar me ligjin 10157, date 15.10.2009 |
| | **Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"** |
| | **VKM nr.247/2014** "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen |

| | |
|---|---|
| **mbetjeve** | mjedisore". |
| | **Vendimi nr. 103/2002** "Në lidhje me monitorimin mjedisor në Republikën e Shqipërisë" |
| | **Ligji nr. 10440/2011**, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" |
| | **Ligji nr.10081/2009** "Mbi licensimin, autorizimin dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". |

*Tabela 2. Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet*

### *2.2 Politikat kombëtare*

Strategjia dhe Plani Kombëtar 2011 – 2017 përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Këto dokumente janë në proces rishikimi dhe rikonceptimi që ka nisur në vitin 2017 dhe mbulon periudhën 2018 – 2033. Draft Strategjia e rishikuar ka si qëllim kryesor të përditësojë politikat dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe të rivlerësojë aftësitë e vendit për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE dhe specifikisht acquis communautaire të mishëruara në Kapitullin 27 për mjedisin. Ky dokument do të përshtasë drejtimet strategjike për ti bërë ato me efikase dhe të realizueshme për zbatuesit e politikave të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor.

Objektivat specifike të strategjisë janë:

- Përmbushja e detyrimeve specifike të acquis të KE-së për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Zbatimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave që kanë të bëjnë me sektorin e mbetjeve.
- Adresimi i problemeve kryesore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat ballafaqohet vendi në një mënyrë të koordinuar dhe të integruar.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015-2020) fokusohet midis të tjerave edhe në politikat e menaxhimit të integruar të mbetjeve me fokus përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, trajtimin e mbetjeve brenda këtyre standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme të mbetjeve në mjedis.

### *2.3 Politikat sipas planit rajonal*

Ministri i Mjedisit ka nxjerrë udhëzimin "Për rregullat, përmbajtjen dhe afatet e aprovuara që janë përcaktuar për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, nr. 6, datë 27.11. 2007. Sipas udhëzimit, brenda një viti nga miratimi i Planit Kombëtar, duhet të hartohen planet rajonale në përputhje me parimet dhe objektivat e Planit Kombëtar (neni 8). Po ashtu ne bazë të ligjit të MIM (neni 13 i ligjit 10463/2011 te amenduar me 2013) qarku është institucioni përgjegjës për aprovimin dhe ndjekjen e zbatimit të planit rajonal të MIM dhe atë planeve vendore, përmes dhe raportimeve që ky institucion bën në ministrinë përkatëse.

Planet rajonale përcaktojnë masat që duhen ndjekur nga autoritetet e qeverisë vendore për zbatimin e objektivave të PKMM të ngurta (neni 10).

Qarku i Elbasani nuk ka ende një plan rajonal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake, pritet që në 2020 të nisë puna për hartimin e tij për zonën respektive të mbetjeve;

Ndërkohë objektivate draft Strategjisë që lidhen me kompetencat në nivel rajonal dhe vendor janë:

• Afatshkurtra (2018-2023)
  - Zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve bashkiake në 50% të NJA
  - Zhvillimi i Studimeve të Fizibilitetit për MMN rajonale me prioritet "Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve"
  - Mbulimii 80% të popullsisë me shërbimin e grumbullimit
  - 20% e popullsisë, por jo më pak se 10% e popullsisë në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë, (zona urbane) janë mbuluar nga shërbimi i integruar i mbetjeve

- Afatmesem (2023-2028)
  - Zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve bashkiake në të gjitha bashkitë
  - Zhvillimi i Studimeve të Fizibilitetit për MMN rajonale të të gjitha ZMM
  - Mbulimi i 90% të popullsisë me shërbimin e grumbullimit
  - 25% e popullsisë, por jo më pak se 20% e popullatave në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) mbulohen nga shërbimi i integruar i menaxhimit të mbetjeve.


- Afatgjata (2020-2035)
  - 95% e popullsisë mbulohet nga shërbimi i grumbullimit të mbetjeve
  - 30% e popullsisë, por jo mëpak se 30% e popullatave në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) mbulohen nga shërbimi i integruar i menaxhimit të mbeturinave.

# III. Përshkrimi i situatës së përgjithshme

## *3.1 Profili i Bashkisë*

### 3.1.1 Pozita gjeografike e Bashkisë

Bashkia Prrenjas bën pjesë në Qarkun Elbasanit dhe përbëhet nga qyteti Prrenjas dhe 3 Njësi Administrative: Rrajcë, Qukës dhe Stravaj. Bashkia ka një qytet dhe 25 fshatra. Kufizohet në veri me Bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Qendra e Bashkisë është qyteti i Prrenjasit.





*Harta 2: Ndarja adminsitrative e Bashkisë Prrenjas*

| Njësitë Administrative | | Qytetetdhe fshatrat në përbërje të tyre |
|---|---|---|
| **Prrenjas** | 1 qytet<br>2 fshatra | Qyteti i Prrenjasit<br>Prrenjas Fshat, Rashtan |
| **Rrajcë** | 7 Fshatra | Rrajcë, Skenderbe, Sutaj, Bardhaj, Urak, Kotodesh, Katjel |
| **Qukës** | 11Fshatra | Pishkash, Qukes Shkumbin, Qukës Skenderbej, Skroske, Menik, Gurre, Berzeshte, Fanje, Karkavec, Dritaj, Pishkash Veri |
| **Stravaj** | 5 Fshatra | Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponje, Sopot |

*Tabela 3. Ndarja sipas njësive administrative dhe përbërja në qytete dhe fshatrave*

Bashkia e re e Përrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re. Zonat e Rrajcës, Qukësit dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmtuar pyjet në një masë të gjerë.




*Harta 3: Harta Fiziko - Gjeografike e Bashkisë Prrenja*
*Burimi: PPV, Bashkia Prrenjas*

Nga pikpamja gjeografike, Bashkia Përrenjas shtrihet në Krahinën Malore Qëndrore, në pjesën jugore të saj, në Fushëgropën e Përrenjasit. Kjo Fushëgropë, shtrihet midis malit të Shebenikut në veri dhe malësisë së Mokrës në jug. Në lindje shkon deri në rrëzë të Qafës së Thanës dhe kurrizit të Muçalit, ndërsa në perëndim kurrizi i ulët e kodrinor i Rashtanit e ndan nga lugina e Shkumbinit të Sipërm. Brenda këtyre kufijve fushëgropa ka gjatësi lindje-perëndim deri rreth 7 km, gjerësi deri 5 km.Ajo përbëhet nga tri fusha kryesore, fusha e Domosdovës, e Rajcës dhe ajo e Katjelit. Dy të parat ndodhen në të njëjtin nivel, ndërsa e treta ndodhet rreth 20 m më lart, dhe ndahet prej tyre nga një kurriz i ulët kodrinor me lartësi relative deri në 100 m.


Zona natyrore e mbrojtur, ndodhet ne basenin ujembledhes të lumit të Bushtricës, i cili ne kete zonë ka prurje të mëdha, gjatësia totale brenda zonës është 18,5km dhe 7km jashtë saj e derisa derdhet në Shkumbin. Në zallin e lumit të krijuar nga gërryerja e tokës gjendet bimësi si rrapi dhe shelgje. Ajo që e bën të veçantë këtë lumë është prania e ujërave të pastërta e të ëmbëla, duke krijuar ambjentin e jetesës së Troftës së malit (salmotruta) dhe të Lundërzës (lunderza lutra). Të dyja speciet rrezikohen për t'u zhdukur në këtë zonë. Përrenjte kryesore që derdhen në lumin e Bushtricës janë përroi i Moravës, i Kunjit, përroi i Peshkut, përroi i Artinit, përroi i Skalavës dhe përroi i Shurit të Zi.

Prrenjasi ndodhet në zonën klimatike mesdhetare paramalore, në nënzonën klimatike mesdhetare paramalore jugore. Larmia e formave të relievit të kësaj nënzone ndikon në regjimin e elementeve klimatikë. Pozicioni që ka kjo bashki, larg bregdetit dhe në lartësi mbi

nivelin e detit, bën që temperatura e ajrit të karakterizohet nga vlera relativisht të ulta. Kjo është më e theksuar gjatë stinës së dimrit ku erërat që fryjnë nga brendësia e territorit ndikojnë dukshëm në uljen etemperaturës. Temperatura mesatare e ajrit varion nga 2.7ºC në janar deri në 21.0ºC në korrik.

Regjimi i reshjeve në zonën e Prrenjasit është një regjim mesdhetar që karakterizohet nga sasi të bollshme gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë stinës së verës.

Shuma vjetore e reshjeve është rreth 870mm, 63%e së cilës bie gjatë stinës së vjeshtës dhe dimrit dhe 37% në dy stinët e tjera. Muaji në të cilin bien më shumë reshje është muaji nëntor gjatë të cilit bien mesatarisht 119.0 mm, ndërsa muaji më i thatë është muaji korrik në të cilin bien vetëm 26.6 mm shi. Numri i ditëve me reshje është një parametër tjetër i rëndësishëm i cili shpreh regjimine reshjeve. Numri i ditëve me reshje më shumë se 1mm që vrojtohen gjatë një viti është mesatarisht 92.1 ditë. Shpërndarja gjatë vitit e numrit të ditëve me reshje është praktikishte njëjtë me atë të sasisë së reshjeve. Muaji me numrin më të madh të ditëve me reshje është muaji dhjetor (10.7 ditë) ndërsa muaji me numër më tëvogël të ditëve me reshje është muaji korrik  (3.9 ditë). Nëqytetin e Prrenjasit, mesatarisht në një vit vrojtohen 12.1 ditë me shtresë dëbore. Lartësia më e madhe e shtresës së dëborës e vrojtuar është 57cm.




*Harta 4: Kushtet Klimatike*
*Burimi: PPV, Bashkia Prrenjas*


### 3.1.2 Hidrografia

Zona e Prrenjasit paraqet larmishmëri formash, gjendjesh dhe dinamike. Burimet hidrike të zonës janë mjaft të pasura dhe të larmishme në formë. Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin, që formon dhe grabenën më tipike të zonës. Së dyti, ka mjaft burime ujore malore që dergjen në të dyja shpatet kufizuese të lumit Shkumbin. Dhe së treti janë burimet ujore statike, pra liqenore ku padyshim më të rëndësishme janë ato të liqeve të Rrajcës, rezervuarë të cilat krijojnë impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko- kimik dhe organoleptik të përshtashëm për pirje por dhe për shfrytëzim në ekonomitë e njësive. Hulumtimet konstatojnë se sipërfaqet ujore liqenore natyrale dhe artificiale kanë një trend në rritje të shkallës së ndotjes së tyre.

Zona natyrore e mbrojtur, ndodhet në basenin ujëmbledhës të lumit të Bushtrices, i cili në këtë zonë ka prurje të mëdha, gjatësia totale brenda zonës është 18,5 km dhe 7km jashtë saj e derisa derdhet në Shkumbin.

**Liqenet** Në këtë zonë ndodhen 4 liqene në shpatin lindor të malit të Shebenikut. Janë liqenet e vendosur në fundin e një kompleksi akullnajor, ata janë të ndarë njeri nga tjetri me depozitime moremike dhe shkëmbinj njërrësore. Thellësia e liqeneve shkon disa metra, ato kanë ujë të ftohtë dhe shumë të pastër. Gjatë dimrit liqenet ngrijnë në sipërfaqe shtrese të fortë akulli, mbi të cilën bie dëbora deri kur fillon shkrirja e akullit në pranvere. Këto liqene kanë bukuri të rralla natyrore.Tre liqene që njihen me emrin liqene të Rrajcës kanë siperfaqen më të madhe, ato ndodhen në shpatin lindor të Shebenikut, poshtë majes së Fursit. Një nga speciet e rralla bimore Aster (Lilium) Albanicum gjendet pikërisht në zonën e Rrajcës, aty ku gjenden 16% të specieve bimore botërore.

*Harta 5: Kushtet Klimatike*
*Burimi: PPV, Bashkia Prrenjas*




*Harta 6: Hidrografia e Bashkise Prrenjas*
*Burimi: PPV, Bashkia Prrenjas*

### 3.1.3 Demografia

Sipas Censusit të vitit 2011, Prrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil të vitit 2023, kjo bashki ka 33,303banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe

prej 322.95 km$^2$. Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km$^2$ ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 102.279 banorë/km$^2$.

Bashkia e Prrenjasit paraqet një përqindje të popullsisë në moshë pune prej 68,3% dhe një koeficient varësie rezultant prej 31,7%. Ajo paraqet plakje më të ulët të popullsisë (8,0%) krahasuar me Cërrikun (11,6%) dhe 0,2% më të lartë krahasuar me Librazhdin (7,8%). Ky koeficient plakjeje është rreth 2 pikë përqindjeje më i ulët edhe në krahasim me mesataren rajonale prej (10,2%). Shpërndarja sipas grupmoshave dhe gjinisë është e ngjashme me atë të qarkut të Elbasanit, pasi në të dy rastet meshkujt përbëjnë rreth 49,7% të popullsisë së përgjithshme (50% për qarkun e Elbasanit) dhe përberja moshore e tyre është praktikisht e njëjtë me atë të femrave.

Referuar të dhënave të marra nga Censusi i vitit 2011, numri i popullsisë dhe shpërndarja e saj sipas grupmoshave, është si në vijim:


| Njësitë Administrative | Nr. Total i popullsisë | 0-14 vjeç | 15-64 vjeç | 65+ vjeç |
|---|---|---|---|---|
| **Prrenjas** | 5847 | 1384 | 3994 | 469 |
| **Stravaj** | 2427 | 587 | 1587 | 253 |
| **Rrajcë** | 8421 | 1966 | 5688 | 767 |
| **Qukës** | 8211 | 1896 | 5501 | 814 |
| **Totali** | **24906** | **5833** | **16770** | **2303** |

*Tabela 4:Shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshave CENSUS 2011*

| Njësitë Administrative | Nr. Total i popullsisë | Nr.i familjeve |
|---|---|---|
| **Përrenjas** | **8936** | **2524** |
| **Stravaj** | **3028** | **857** |
| **Rrajcë** | **10431** | **2776** |
| **Qukës** | **10840** | **2903** |
| **Totali** | **24906** | **5833** |

*Tabela 5: Shpërndarja e popullsisë sipas të dhenave të GJC*

Ndërtesat e banimit janë shumë familjare dhe një familjare. Ndërtesat shumë familjare janë përqendruara ty ku ka zënë fill qyteti, në pjesën qendrore të tij. Ato anë kryesisht 1 deri 3 kate dhe janë ndërtuar para viteve 80. Vitet e fundit janë ndërtuar dhe banesa shumë familjare 5 katshe.




*Harta 6: Shpërndarja e banesave sipas NJA*
*Burimi: PPV Bashkia Prrenjas*

| Njësitë Administrative | Nr. Total i banesave | Nr. Objekt banimi vile | Nr. Objekt Pallat | Nr. Banesë 1 Kat | Nr. Banesë 2 Kat | Nr. Banesë 3-5 Kat | Nr. Banesë 6+ Kat |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prrenjas** | 851 | 659 | 92 | 699 | 79 | 70 | 3 |
| **Stravaj** | 727 | 724 | 3 | 700 | 22 | 5 | 0 |
| **Rrajcë** | 2080 | 2077 | 3 | 1782 | 253 | 23 | 22 |
| **Qukës** | 1841 | 1834 | 7 | 1711 | 115 | 10 | 5 |
| **Totali** | **5499** | **5294** | **105** | **4892** | **469** | **108** | **30** |


*Tabela 6: Shpërndarja e banesave sipas llojit dhe kateve*

Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Përrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.

**Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale**


Popullsia aktive dhe papunësia - Popullsia në moshë pune e qarkut të Elbasanit në bazë të Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011 ishte rreth 203,000 banorë. Ajo përbën 69% të popullsisë totale te qarkut. Duke analizuar te dhenat e tabeles se meposhtme verejme se ne vitin 2011 ishin ekonomikisht aktive (te punesuar dhe te papune) 101,700 persona, rreth 50% te popullsise ne moshe pune. Kjo përqindje ishte më e lartë për meshkujt (55.6%) sesa për femrat (37.5%). Nga ana tjetër niveli i papunësisë krahasuar me popullsinë aktive shënon një përqindje të përgjithshme prej 27%, shifër e shpërndarë në mënyrë disi më të barabartë, në raport me përqindjen e popullsisë aktive, mes meshkujve (25.6%) dhe femrave

(29.5%). Shpërndarja e papunësisë ndryshon nga zonat urbane në ato rurale, këto të fundit numërojne rreth dyfishin e banorëve papunë të zonave urbane, ndonëse përqindja e papunësisë në raport me popullsinë totale përmbys plotësisht këtë raport duke bërë që shkalla e papunësisë në zonat rurale të jetë shumë më e vogël në krahasim me zonat urbane. Kjo vjen si pasojë e përqëndrimit të popullsisë në qytete dhe zonat periferike rreth tyre. Grafiku që vijon vë në dukje këtë fenomen.




*Grafiku 1: Shkalla e papunësisë sipas zonave urbane/rurale*
*Burimi: Theorema mbi te dhenat e censusit 2011*

Shkalla e papunësisë e analizuar sipas grupmoshave tregon që ky tregues është më i lartë ndër të rinjtë (shkalla e papunësisë ishte më e lartë për grupmoshën 15-39 vjec dhe vjen duke u ulur me rritjen e moshës. Femrat mbeten kategoria me shkallën më të lartë të popullsisë dhe hendeku më i thellë mes dy gjinive regjistrohet për grupmoshën 30-39 vjec.





*Grafiku 2: Shkalla e papunësisë sipas grupmoshës dhe gjinisë*

| NjA | Familje gjithsej | Familje me ndihmë ekonomike | | Me aftësi të kufizuar (PAK+Invalid Pune) |
|---|---|---|---|---|
| | | Numri | Në % ndaj totalit | Numri |
| **Prrenjas** | 2926 | 257 | 2.32% | 603 |
| **Rrajcë** | 3634 | 629 | 5.69% | 698 |
| **Qukës** | 3521 | 603 | 5.45% | 652 |
| **Stravaj** | 972 | 255 | 2.3% | 254 |
| **Shuma** | 11053 | 1744 | 15.76% | 2207 |

*Tabela 7. Familjet me ndihmë ekonomike e aftësi të kufizuar, Bashkia Prrenjas*

*Burimi: Zyra e Ndihmës Ekonomike, Bashkia Prrenjas*




Të dhënat mbi numrin e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë një tregues indirekt i nivelit të varfërisë në Bashkinë Prrenjas. Këtë ndihmë e përfitojnë në total rreth1744 familje, nga të cilat 257 në qytetin e Prrenjasit. Në raport me numrin total të familjeve, rezulton se në Bashkinë e Prrenjasit përfitojnë ndihmë ekonomike rreth 15.76 % e familjeve.

### 3.1.4 Bizneset dhe Institucionet

Në të gjithë bashkinë e re rezultojnë të regjistruara 503 biznese të cilat e kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në shërbime. Një pjesë e vogël e bizneseve merren me kultivimin e troftës.

| Nr. | Biznese sipas aktivitetit | Totali | Sipas NJA | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Prrenjas | Rrajce | Qukes | Stravaj |
| A | Institucione | 3 | 3 | | | |
| B | Shoqata | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| C | Biznese | 503 | 331 | 97 | 62 | 13 |

*Tabela 8: Shpërndarja e institucioneve dhe bizneseve sipas NJA*
*Burimi: Zyra e Taksave vendore, Bashkia Prrenjas*

### 3.1.5 Rrjeti rrugor

Gjithsej Bashkia Prrenjas ka një gjatësi rrugësh urbane  dhe rurale prej 165.22 km, të cilat janë të asfaltuara dhe 12.12 km rrugë rurale për të tre njësitë administrative, ku 5.2 km janë të asfaltuara rruge urbane ne qytetin e Prrenjasit.

| Njësit Administrative | Rrugët (Nr) | Lloji i shtresës (asfaltuar /km) | Gjatësia (km) | Gjerësia (m) |
|---|---|---|---|---|
| Bashkia Prrenjas | 26 | 5.2 | 17.8 | 4 |
| NjA Qukës | 35 | 5.4 | 58.52 | 4 |
| NjA Rrajcë | 46 | 4.77 | 61.33 | 4 |
| NjA Stravaj | 16 | 1.95 | 27.57 | 4 |
| Shuma | 123 | 17.32 | 165.22 | 4 |

*Tabela 9: Rrjeti rrugor ne Bashkinë Prrenjas*

*Harta 7: Infrastruktura Rajonale*
*Burimi: PPV Bashkia Prrenjas*

### 3.1.6 Gjëndja e përgjithshme mjedisore

Bashkia karakerizohet nga parametra optimalë të ajrit. Kjo është e lidhur me gjeografinë, relievin, klimën, biodiversitetin dhe veprimtaria jo eficente e minierave aktuale në shfrytëzim. Sigurisht që kryeqendra e bashkisë ku është përqëndruar aktiviteti më i lartë social ekonomik por dhe pozicionimi në grabenë e kodrave rrethuese tregon një cilësi të ajrit në përkeqësim.

Zona paraqet larmishmëri formash, gjendjesh dhe dinamike. Burimet hidrike të zonës janë mjaft të pasura dhe të larmishme në formë. Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin, që formon dhe grabenen më tipike të zonës. Problem evident është ndotja e lumit që vjen nga disa faktorë:


- Mënyra e shfrytëzimit të minierave të Hekur Nikelit (Pishkash, Katjel)
- Shkarkimet e pakontrolluara të ujarve të zeza dhe të përdorura nga zonat rurale që kufizojnë shtratin lumor
- Shkarkimet ilegale të mbetjeve të ngurta familjare, industriale, etj
- Shfrytëzimi për inerte apo cfarëdolloj tjetër që pakëson aftësinë filtruese dhe zbërthimin biologjik, cka akumulon ndotje në rrjedhje e mëposhtme duke ndikuar në iktiofaunën etij.

Menaxhimi i mbetjeve përfaqëson një nga problemet më serioze për qytetin por sidomos për njësitë administrative të cilat kanë shtrirje shumë të madhe dhe praktikisht nuk mund të krijohet lehtë një sistem i integruar i menaxhimit të tyre. Problemi në planin organizativ dhe realizues është më i thjeshtë në qytet dhe në disa fshatra përreth me urbanizim më të përqëdruar. Fakti i gjenerimit të tyre me tipologji heterogjene, grumbullimi i padiferencuar, mosmenaxhimi i sistemit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit, shkakton ndikim të ndjeshëm mjedisor. Vlerësohet se mesatarisht gjenerohen 230-250 ton mbetje të ngurta në vit për person, cka mosmenaxhimi i duhur shkakton depozitime të pakontrolluara, kontaminime, ndikim në parametrat e ajrit dhe në tërësi në shëndetin e njerëzve.

Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujërave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin. Komuniteti dhe shërbime te aktiviteteve ekonomike, gjenerojnë mbetje ujore të patrajtura me tipologjitë ndryshme.

Gjithashtu raporti midis qendrave të banuara dhe zonave ujëmbajtëse është në disfavour të cilësisë së ujit për shkak të mënyrës së menaxhimit të veprimtarisë urbane si rrjet kanalizimesh dhe përpunues. Shtimi i fenomentit të erozionit ka shtuar depozitimet inerte në sipërfaqet ujore dhe është çekuilibruar ballanca aerobike-anaerobike duke stimuluar fenomenin e eutrofizimit.

Toka e zonës paraqet strukturë komplekse dhe me relieve variacional nga fushore në kodrinore deri malore. Një pjesë e tyre janë rezultat i shpyllëzimeve të cilat tashmë kanë




filluar të popullohen nga flora natyrale barishtore, shkurrore dhe drunore. Ndërkohë që një pjesë e mirë janë kthyer në vreshtari apo kultivuar me drurë frutor autokton apo të introduktuar.

Por krahas këtij fenomeni me impakt pozitiv konstatohet shpyllëzime masive dhe rrëshiqtje cka ka rritur ndjeshëm erozionin dhe njëheraz pamundësi rigjenerimi të biodiversitetit duke kërcënuar seriozisht statusin e llojeve endemike apo subendemikeme.

## *3.2. Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve*

### 3.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me agjencitë e tyre respektive.

**MTM** është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Mjedisor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

**MIE** ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat
zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i lendfilleve dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane.

**MSHMS** harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore.

**MBZHR** është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore. Rregullorja nuk është hartuar ende.

**MFE** është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për taksat e ndryshme mjedisore. Deri tani janë paraqitur dy taksat e para mjedisore (taksa e gjelbër dhe taksa e ambalazhimit mbi pijet).

**AKUKIM** - është përgjegjëse për zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndërmarrjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.

### *3.2.2 Organizimi në nivel rajonal*

**Inspektorati Mjedisor** është përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret teknike dhe teknologjitë.

**Agjencitë Rajonale të Mjedisit** janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal. Kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

**Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit,** miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për *landfill*-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

| 1 | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8=7*15** | **9=8*4*12** |
| 1 | Punetore pastrimi | Qyteti Prrenjas | **8** | 49.4 | 6,175 | 1 | 22 | 2,112 |
| | **TOTALI** | | **8** | **49.4** | **6,175** | **1** | **22** | **2,112** |

*Tabela 21. Të dhëna të ngarkesës së punës së punonjësve të shërbimit të pastrimit*
*Burimi: Bashkia Prrenjas, sipas buxhetit të vitit 2019*

Në këtë situatë, kur shërbimi vjetor i pastrimit gjatë vitit 2019-2024 është kryer pjesor dhe me probleme administrimi/funksionimi, edhe pse analiza financiare e shërbimit ka vlera të dala nga çdo analizë e kostos së shërbimit, një përcaktim për koefiçentin e saktë të mbulimit të kostos nga të ardhurat nga tarifa e pastrimit nuk mund të japim. Të dhënat në tabelën e mësipërme, së bashku me të dhënat analitike të kostos së karburantit, do t'i shërbejnë realizimit dhe përpunimit të skenarëve të mundshëm për zgjedhjen sa më ekonomike që do të bëjë Bashkia për PVMMU.

## *3.5Performanca aktuale e administrimit të mbetjeve vendore*

Për të vlerësuar performancën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, ekspertët dhe GP, ndërmorën një analizë të detajuar të sistemit por edhe perceptimin e publikut në lidhje me shërbimin e pastrimit. Analiza e sistemit është realizuar si në indikatorët e performancës ashtu edhe në identifikimin e avantazheve, dobësive, mundësive dhe rreziqeve që i gjithë sistemi apo elementët përbërës të tij shfaqin. Për këtë qëllim, analiza u bazua në të gjithë të dhënat e marra nga takimet, si dhe duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje të drejtpërdrejtë apo indirekte me menaxhimin e mbetjeve, në drejtim të aspekteve ligjore dhe administrative, cilësore dhe efektive, ekonomik dhe mjedisor që lidhet me veprimet apo mosveprimet e bashkisë, ashtu dhe me ndikimin e faktorëve të tjerë në këtë performancë të përgjithshme.

### 3.5.1 Analiza e indikatorëve të performancës

Bazuar në metodologjinë[4] që në fillim të procesit u prezantuan indikatorët e përzgjedhur për monitorimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në nivel bashkie. Të dhënat e përftuara do të ndihmojnë në krijimin e një pasqyre të qartë të realitetit por edhe në vendosjen e objektivave të qartë dhe plotësisht të matshëm për bashkinë për një periudhë të përcaktuar. Këto indikatorë që do të përshkruhen më poshtë do të maten dhe rishihen në baza një vjeçare dhe do të jenë shumë të rëndësishme edhe gjatë periudhës së raportimit pranë këshillit bashkiak. Gjithsej do të maten dhe monitorohen 8 indikatorë të ndarë në ato që lidhen me (i) cilësinë e shërbimit, (ii) indikatorë të qëndrueshmërisë mjedisore dhe (iii) indikatorë të qëndrueshmërisë ekonomike, financiare dhe institucionalë. Jemi të vetëdijshëm se për disa nga indikatorët informacioni apo të dhënat e grumbulluara janë jo zyrtare apo të dhëna që nuk janë grumbulluar ndonjëherë ndaj duke qënë se mblidhen për herë të parë krahas vlerës përkatëse do të ketë dhe një kategorizim sipas saktësisë së informacionit në tre nivele e ulët, e mesme dhe e lartë.

**Indikatorët e cilësisë së shërbimit**

***"Efikasiteti në mbledhjen e mbetjeve"*** shpreh sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoriteti i autorizuar për këtë shërbim përkundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në NJQV si për zonën urbane dhe për atë rurale. Besimi në këtë indikator varet shumë nga metodat e përdorura për grumbullimin e të dhënave. Duke qenë se nuk ka të dhëna të sakta në lidhje më sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe as të dhëna të sakta mbi sasia e mbetjeve të depozituara në vend depozitim mund të themi se besueshmëria e këtyre të dhënave është e ulët dhe mbështetur në hamëndësime. Megjithatë nga të dhënat e mbledhura shkalla e mbulimit të mbledhjes së mbetjeve është 72% (në NJA Stravaj ky shërbim nuk i ofrohet fare për shkak të largësisë së madhe dhe infrastrukturës së keqe rrugore).

***"Pastërtia e qytetit"*** shpreh efektivitetin e mbledhjes së mbetjeve dhe fshirjes së rrugëve. Vlerësohet në tre aspekte: në efektivitetin e mbledhjes së mbetjeve, të pastrimit të rrugëve dhe në atë të zonave rurale. Për sa i takon prezencës së mbetjeve përreth kontenierëve mund të themi që në qytetin e Prrenjasit (ku ka PGM) vihet re prezencë e moderuar e mbetjeve, ndërsa

[4] Metodologji e zhvilluar nga projekti dldp (per qeverisje dhe decentralizim vendor)

në rrugë ka prezencë të ulët të mbetjeve. Në zonat rurale ka prezencë të moderuar të mbetjeve dhe numër të vogël hot spotesh të krijuara. Në vlerësimin tonë ky indikator klasifikohet në kategorinë e mesme (50%) me saktësi të mesme pasi një pjesë e të dhënave vijnë dhe nga sondazhi i limituar i bërë përgjatë muajit shkurt 2025.

***"Perceptimi Publik"*** më i fundit është realizuar në 2022, gjatë një vlerësimi të shërbimit të ndërmarrë nga vetë bashkia. 90% e të intervestuarve shprehen se nuk e marrin shërbimin e pastrimit dhe 85% u përgjigjen se cilësia e pastrimit në zonën ku banojnë është problematike.

**Indikatorët e Qëndrueshmërisë Mjedisore**

*"**Ripërdorimi: shkalla e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonat urbane"*** përfaqëson shkallën e sasisë së mbetjeve të mbledhura zyrtarisht nga një cikël i mbyllur që nga pikat e grumbullimit në qendrën e trajtimit të mëtejshëm. Nuk ka të dhëna zyrtare, por ndërkohë ka iniciativa të komunitetit egjiptian për ndarje mbetjesh në burim (plastikë, qelq dhe metal). Por ky aktivitet nuk kalon vlerën 5%.

***"Mbrojtja e burimeve natyrore:** shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfill sanitar ose vend depozitime të aprovuara".* Të gjitha mbetjet e grumbulluara përgjatë këtyre viteve janë dërguar në venddepozitimin e qytetit por shkalla e vërtetësisë është e mesme pasi nuk ka rekorde zyrtare.

***Indikatorët e Qëndrueshmërisë Institucionale***

*"**Mbulimi i kostos përmes tarifës**"* Krahason koston totale për shërbimin dhe financimin e tij përmes tarifës së vendosur dhe nivelit të mbledhjes së saj. Nëse i referohemi tabelës së mësipërme, të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e pastrimit për 2023 janë 6,071,307lekë, ndërsa kosto operative vjetore është 6.550.000 ALL, pra mbulimi i kostos është 92.6%. Gjithsesi kjo kosto nuk është reale ndaj për vitin 2025 Bashkia ka llogaritur koston e shërbimit bazuar dhe mbi modelin e kosto tarifËs.

*"**Kontributi i qytetarëve** në financimin e shërbimit: niveli i mbledhjes së tarifës"* reflekton kapacitetin/dëshirën e popullsisë për të paguar tarifën. Nëse i referohemi tabelës së mësipërme, të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e pastrimit për 2018 janë 6,071,307 lekë, ndërsa totali i të ardhurave të planifikuara 7,500.000 leke, pra të adhurat realizohen në masën 80.9%.

*"**Transparenca e sistemit të faturimit**"* Vlerëson kapacitetin e bashkisë për t'i dhënë faturë klientit. Aktualisht bashkia ka një sistem faturimi për shërbimin e pastrimit, por klientët njihen me të kur vijnë në bashki për të kërkuar shërbim dhe nuk ka një informim aktiv të qytetarëve nga vetë bashkia. Ndaj mund të thuhet që transparenca ka qënë e ulët.

Vihet re se ne Bashkinë Prrenjas nuk ka një mekanizëm për të monitoruar performancën në drejtim të mbulimit, qëndrueshërisë mjedisore dhe asaj financiare e institucionale, mbledhjes së tarifave. Nuk ka një database elektronik, por vetëm një rregjistër elektronik të klientëve.

# IV. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE

## *4.1 Vizioni*

Vizioni i PVMMU të Bashkisë u formëzua si një proces i analizimit, diskutimit dhe konsultimeve me stafin e bashkisë Prrenjas.
Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, prioriteteve të përgjithshme dhe konkrete si dhe pritshmërive e vlerave dhe normave qytetare, realiteteve dhe sfidave, dhe dëshirës e bindjes për ndryshim, u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

***"Bashkia Prrenjas synon një mjedis të pastër me cilësi të lartë dhe kontribut të komunitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke synuar minimizimin e mbetjeve, ruajtjen e burimeve natyrore dhe për një jetesë të shëndetshme***!

## *4.2 Objektivat*

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Mbetjeve kanë përcaktuar 3 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2010-2015 dhe 2015-2020) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe faza e tretë (2023-2035) ku synohet arritja e standardeve dhe objektivave të BE.

Në këtë kuadër ky plan synon progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standarteve kombëtare e ndërkombëtare. Plani do të adresojë nevojat lokale për periudhën 5 vjeçare 2019-2024. Fokusi në këtë fazë do të jetë në marrjen e masave emergjente gjatë vitit 2019 për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës bashkiake për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve, pastrimin e qytetit si dhe rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

Për periudhën 2024-2029 synimet do të jenë në arritjen e objektivave strategjike kombëtarë, në përputhje me standardet e legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe principet e mbetjeve, për të minimizuar sasinë e mbetjeve që shkojnë në *vend depozitim*.

Në vijim të përmbushjes të vizionit të planit si dhe bazuar në objektivat kombëtarë, u përcaktuan drejtimet strategjike dhe objektivat vendore për një periudhë 5 vjecare, si më poshtë:

A. Infrastruktura dhe Mjedisi
   - Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të Mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore deri në vitin 2029
   - Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve duke e shtrirë në 92% të territorit deri në vitin 2029;
   - Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim

B. Ndërgjegjësimi i komunitetit

- Sensibilizimi i komunitetit dhe biznesit për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë
- Rritja e transparencës dhe e përgjegjshmërisë ndaj komunitetit të bashkisë së Prrenjasit

C. Forcimi Institucional
   - Forcimi i kapaciteve të stafit për menaxhimin dhe monitorimin e mbetjeve
   - Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve
   - Forcimi i koordinimit ndërinstitucional rajonal për një menaxhim të integruar të mbetjeve

D. Ekonomia dhe financat
   - Forcimi i qëndrueshmërisë financiare duke rritur mbledhjen e tarifës së pastrimit gjatë periudhës 5 vjeçare në masën 90% nga familjet për të rritur të ardhurat në funksion të mbulimit të kostos së shërbimit

## *4.3 Objekti i Planit*

### 4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekt i planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake për të cilën Bashkia e Prrenjasit është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- **Mbetje urbane** (ushqim, bimë, të ricikluesshme, të dekompozuara, etj[5].), dhe
- **Mbetje të veçanta bashkiake** (mbetje inerte e ndërtimore, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- **Mbetje të rrezikshme** që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës: (MF) mbetjet e prodhuara nga familjet; (MB) mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane. Ndërkohë, rryma të tjera mbetjes klasifikohen si mbetje masive, mbetje të ngurta (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta' për të cilat njësia vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

### 4.3.2 Integrimi me aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera strategjike vendore dhe rajonale, që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me mbetjet

Me qëllim efektivitetin dhe integrimi me planet, strategjitë, aktet nënligjore apo studimet të tjera në nivel rajonal dhe vendor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, ky plan vendor për menaxhimin e mbetjeve ka marrë parasysh përcaktimet e këtyre dokumentave, ndërkohë që përcakton objektivat, identifikon apo vlerëson mundësitë për realizimin e tyre:

[5] Siç përshkruhet në "Karakteristikat e Mbetjeve"

- Plani i Përgjithshëm Vendor që është në fazën e fundit të konsultimeve.
- Projekt plani rajonal i menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake për zonën Elbasanit përcakton në mënyrë të detajuar zgjidhjet teknologjike të nevojshme (impiantet ekzistuese, nevojat dhe specifikimet lokale, mundshmëria ekonomike dhe zhvillimet teknologjike).

### 4.3.3 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit


Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, rekomandohet që zona e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë të ndahen në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshtaten më mirë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

i. **Zona e Parë, qyteti Prrenjas, Njësitë Administrative Rrajcë + Qukës :** karakterizohet si zona urbane e qendrës së Bashkisë dhe rurale , ku janë përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, shkollave dhe institucioneve të tjera, si dhe zonë urbane dhe rurale me densitet të lartë. Në këtë zonë ndodhen pjesa më e madhe e pallateve/banesave. Aktualisht në qytetit e Prrenjasit ka 75 kontenierët të rinj dhe 75 janë në Njësitë Administrative dhe janë në gjendje të mirë. Shpesh ka mbetje rreth tyre. Mbetjet depozitohen në inceneratorin e Elbasanit . Shërbimi i pastrimit për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve realizohet 4 herë në javë. Shërbimet e parashkuara në këtë zonë janë largimi i mbetjeve çdo ditë, fshirja e rrugës kryesore dhe sheshit rreth 49,416$m^2$ çdo ditë si dhe lagia e rrugës kryesore 53,596$m^2$ dy herë në ditë gjatë periudhës së verës.

ii. **Zona e Dytë, Qyteti Prrenjas dhe Njësia Administrative Stravaj :** karakterizohet si zonë Semi urbane përfshin qyteti Prrenjas dhe Njësinë Administrative Stravaj .Shërbimi i pastrimit për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve realizohet 1 herë në javë. Nuk realizohet fshirje dhe lagie.

iii. **Zona e tretë , Qyteti Prrenjas dhe fshati Rashtan :** karakterizohet si zonë Semi urbane përfshin qyteti Prrenjas dhe fshatin Prrenjas dhe Rashtan .Shërbimi i pastrimit për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve realizohet 1 herë në javë. Nuk realizohet fshirje dhe lagie.

iv. **Zona e katëert , qyteti Prrenjas :** Karakterizohet si zonë urbane dhe përfshin qytetin Prrenjas dhe fshatin Prrenjas. Për realizimin e këtij shërbimi janë vendosur 75 kontenierë të rinj. Shërbimi i pastrimit për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve dhe do të realizohet 1 herë në javë.





*Harta 14: Zonat e Mbetjeve*

### *4.4 Skenarët e administrimit të mbetjeve*

Skenarët në lidhje me manaxhimin e mbetjeve është mirë të përqëndrohen në mbledhjen e mbetjeve urbane dhe elementët e tjerë si ndarja e mbetjeve, riciklimi, kompostimi etj., të lidhen drejtpërdrejt me metodën e zgjedhur të mbledhjes së mbetjeve.

Shërbimet e pastrimit dhe alternativat e depozitimit të mbetjeve urbane, riciklimi, kompostimi dhe manaxhimi i mbetjeve voluminoze janë pjesë e sistemit dhe rrjedhojë e skemës së përzgjedhur nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve. Kështu duke marrë në konsideratë që sistemi në bashkinë Prrenjas bazohet në një sistem me pika të përbashkëta, iniciativat për ndarjen e mbetjeve duhet të fokusohen në sistemin e përbashkët me dy kosha në vitin 2024, të riciklueshme dhe të njoma për pjesën e qendrës së qytetit.

Më poshtë është një skemë e zakonshme se si mund të menaxhohen mbetjet në bashki, duke konsideruar dhe aktivitetet e mësiperme:




*Grafiku 7: Skema ideale e mbledhjes së mbetjeve*

### 4.4.1 Menaxhimi i mbetjeve bazuar ne objektivat ndërkombëtar, kombëtare dhe rajonale

Neni 4 i Direktivës Kuadër të BE-së për Mbetjet, i rishikuar (ËFD 2008/98/EC), përcakton pesë hapa për trajtimin e mbetjeve në bazë të prioriteteve. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është një udhëzues i pranuar kombëtar dhe ndërkombëtar, për t'i dhënë prioritet praktikave të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim arritjen e rezultateve optimale mjedisore. Kjo hierarki përcakton rendin e preferuar të praktikave për menaxhimin e mbetjeve, nga më të preferuarat tek ato më pak të preferuara.

***Shmangia*** e gjenerimit të mbetjeve në Prrenjas është akoma në një fazë shumë të hershme. Megjithatë, në nivel shkollash, nxënësit mund të edukohen për përdorimin e kujdesshëm të produkteve (cantat prej beze, shishe personale uji). Rezultatet e kësaj politike do të jenë të vështira për t'u matur, por mund të vëzhgohen.
Të qënurit një bashki e varfër nga ana ekonomike, ***ripërdorimi*** i materialeve është shumë i rëndësishëm (si psh shishet plastike, qelqit, kavanozët, rrobat e vjetra, druri dhe gomat). Promovimi i ripërdorimit të materialeve është shumë i arritshëm dhe nis me ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Materiali i ***riciklueshëm*** nuk është në sasi shumë të madhe, pasi shumica e mbetjeve janë organike për vetë faktin se zona ka në përgjithësi karakter rural. Megjithatë, riciklimi është i mundshëm në dy drejtime kryesore:

> *1. Kompostimi* - është një mënyrë e shkëlqyer për të ricikluar mbetjet e kopshteve dhe të kuzhinës, si për shembull krasitjet nga bimët dhe ushqimi i mbetur. Të gjithë qytetarët dhe bizneset në fshat do të inkurajohen dhe do të edukohen të shmangin plotësisht mbetjet organike nga sistemi i menaxhimit. Një politikë e tillë pritet të reduktojë maksimalisht, me rreth 50%, sasinë e mbetjeve në nivel lokal.
> *2. Zbatimi i një sistemi për ndarjen e mbetjeve dhe rikuperimi* - Një sistem i grumbullimit të mbetjes së thatë në disa fshatra, së bashku me mbetjet e grumbulluara në zona/ shkolla pilot të qytetit do të krijojë mundësinë e grumbullimit të sa më shumë mbetjeje të thatë, e cila do ti jepet kolektorëve dhe ato më pas ua shesin kompanive të

riciklimit. Shkollat e qytetit mund të kenë skemë pilote me dy kosha, për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku në njërin kosh do të hidhet mbetja e thatë dhe në koshin tjetër mbetja organike.

Mbetjet për ***energji*** janë një mundësi për bashkinë, edhe pse sasia e mbetjeve të grumbulluara është e pakët, bazuar dhe në master plan bashkia do operojë me dërgimin e mbetjeve në inceneratorin e Elbasanit.

***Depozitimi i mbetjeve*** do të jetë mundësia e vetme për 5 vitet e ardhshme. Pritet që ng a 2024 venddepozitimi ekzistues do të mbyllet, rehabilitohet për të zvogëluar mundësinë e pasojave jo të këndshme mjedisore dhe shëndetësore. Në Planin e Përgjithëshëm Vendore është përcaktuar një zonë për ngritjen e një stacion transferimi  në rastin e mbylljes së venddepozitimit.

Duke u kthyer tek objektivat e përcaktuara me stafin e bashkisë, por edhe në linjë me angazhimet e qeverisë shqiptare, synohet:

- të bëhet grumbullim i diferencuar për 50% të mbetjeve Brenda 5 viteve që nga miratimi i planit, pra deri në vitin 2029.
- dërgimi i mbetjeve në inceneratorin e Elbasanit  brenda 5 viteve që nga miratimi i Planit, pra deri në vitin 2029.

Nëse Bashkia do të zbatonte këto objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm sipas skemës së mësipërme të administrimit të mbetjeve, pra do të diferenconte mbetjet në burim dhe do t'i grumbullonte në kontenierë të vecantë, atëherë sasia e mbetjeve që do të përfundonin në landfill, do te ishte si më poshtë:

| **Objektivat sipas SKMM** | **Njesia** | **v.2025** | **v.2026** | **v.2027** | **v.2028** | **V.2029** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Politikat rajonale për grumbullim të diferencuar** | Në % | 5% | 20% | 25% | 30% | 40% |
| **Do të përfundojnë në landfill** | **ton/vit** | **2982** | **2511** | **2354** | **2197** | **1883** |
| **Riciklohen dhe kompostohen** | **ton/vit** | **157** | **628** | **785** | **942** | **1256** |

*Tabela 23. Politikat e PVMMU*

Pra, bazuar në skenarin optimist të mësipërm do të shkonin në landfill mbetje të ricikluеshme dhe të kompostueshme në sasi shumë më të vogël dhe kjo do të sillte indirekt jo vetëm përdorim eficent të vend depozitimit, por edhe kursim të kostos së bashkisë për transportin e mbetjeve në vend depozitim.

**Sasia e mbetjeve që shmangen nga vend depozitimi**

Pra, bashkia nëse do të aplikonte një skenar të tillë, pra nëse banorët dhe bizneset do të ndanin një pjesë të vogël të mbetjeve që në burim dhe ato do të grumbulloheshin dhe transportoheshin

në destinacionin e duhur, atëherë sasia e mbetjeve që do të përfundonin në vend depozitim do të ulej nga viti në vit.

Tabela e mëposhtme tregon sasinë e mbetjeve sipas fraksioneve që do të shmanget nga venddepozitimi dhe mund të përdorej nga industria ricikluese apo kompostuese.

| Mbetjet që shmangen nga landfilli sipas fraksioneve | Njësia | v.2025 | v.2026 | v.2027 | v.2028 | v.2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Leter&Karton** | **ton/vit** | 34.3 | 137.16 | 171.45 | 205.74 | 274.32 |
| **Plastike** | **ton/vit** | 68.58 | 274.32 | 343 | 411 | 549 |
| **Qelq** | **ton/vit** | 17 | 68.6 | 86 | 102.8 | 137 |
| **Metale** | **ton/vit** | 17 | 68.6 | 86 | 102.8 | 137 |
| **Të biodegradueshme** | **ton/vit** | 156.7 | 630 | 790 | 947 | 1260.5 |
| **TOTALI** | | **293.58** | **1178.68** | **1476.45** | **1769.34** | **2357.82** |

*Tabela 24: Mbetjet sipas fraksioneve që nuk depozitohen në landfill*

**Kosto depozitimi që kursehet**

Si rezultat i aplikimit të objektivave bashkia kursen:

- ✓ **Kosto transporti të mbetjeve në vend depozitim**

Në Prrenjas dhe në qarkun e Elbasanit operojnë disa individë që mbledhin materiale ricikuese, të cilat mund të hynin në partneritet me bashkinë për mbledhjen dhe trajtimin më tej të mbetjeve të riciklueshme, gjë që do të sillte dhe kursim të kostos së transportit të tyre pasi vetë grumbulluesit/ricikluesit do të merrnin përsipër transportin për në desinacionin e biznesit riciklues. Pra, mund të mbledhin derë më derë mbetjet e riciklueshme ose mund të marrin direkt nga kontenierët e veçantë mbetjet e riciklueshme.

| Kosto transporti që kursehet | Njësia | v.2025 | v.2026 | v.2027 | v.2028 | V.2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kosto transporti** | Lekë/ton | 1352 | 1352 | 1352 | 2224 | 2224 |
| **Sasia e mbetjeve që diferencohen dhe nuk shkojnë në landfill** | Ton/vit | **293.58** | **1178.68** | **1476.45** | **1769.34** | **2357.82** |
| **Përfitimi i bashkisë nga kursimi i kostos së transportit** | Lekë/vit | -396,920 | -1,593,575 | -1,996,160 | -3,935,012 | -5,243,792 |

*Tabela 25: Kosto transporti që kursehet nga mosdepozitimi i mbetjeve në landfill*

- ✓ **Kosto depozitimi të mbetjeve në landfill** për momentin bashkia Prrenjas i depoziton mbetjet në inceneratori dhe aplikon tarife për trajtimin e mbetjeve 2500 leke pa tvsh, është e vështirë të përcaktohet vlera në lekë që do të kursehet nga largimi i këtyre mbetjeve nga rryma kryesore. 4.4.2 Administrimi i mbetjeve bazuar në grumbullimin miks të tyre

Duke ju referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij

plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar mbetet në nivelin e 72%, por që Bashkia Prrenjas është e motivuar dhe angazhuar të shtojë sipërfaqen e pastrimit deri në 95% dhe duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithashtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve.

Duke kaluar në një përqasje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe largimin e mbetjeve në funksion të tipeve të ndryshëm të konsumatorëve, të përshtatshme për tipologjinë urbane apo karakteristikave të tjera të zonës dhe konsumatorëve. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm "mbetjet urbane" sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i bashkiak për mbledhjen e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtëquajtura "të veçanta" që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për mbledhjen e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094/1996), mbetjet e konsumatorëve jo-banorë që prodhojnë mbi ¼ e sasisë që mund të vendosen në një kontenjer mbetjesh (zakonisht 1.1 $m^3$) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të mbledhjes së mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për mbledhjen e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.


Në funksion të përcaktimeve të mësipërme, ekzistojnë disa alternativa të mundshme për mënyrën e organizimit të shërbimit të mbledhjes dhe largimit (transportit) të mbetjeve. Këto alternativa lidhen me organizimin, infrastrukturën e nevojshme, rregullsinë dhe specifikime të tjera. Për secilën alternativë Bashkia nënvizon avantazhet dhe disavantazhet në lidhje me zbatueshmërinë, efektivitetin, mjedisin dhe burimet natyrore si dhe pranueshmërinë shoqërore. Ka edhe ndryshime mes alternativave për sa i përket përfshirjes së konsumatorit (qëndrimi pasiv apo aktiv).

<u>Skema e mikse e menaxhimit të mbetjeve</u>

Mbledhja dhe largimi/transporti i mbetjeve bazohet në përqasjen e zakonshme të organizimit të menaxhimit të mbetjeve. Kjo skemë e mbledhjes dhe largimit të mbetjeve është një vazhdim i skemës aktuale të mbledhjes së mbetjeve (grumbullimit[6] të mbetjeve në anë të rrugës) dhe mbështetet në një sistem të përbashkët të grumbullimit të mbetjeve, ku konsumatorët janë të detyruar të nxjerrin jashtë dhe depozitojnë mbetjet urbane ditore ose të një periudhe të caktuar, pranë pikave të miratuara (PGM), ndërsa ndërmarrja e pastrimit (ose operatori në një të ardhme) mundëson mbledhjen dhe largimin e mbetjeve urbane për në vendin e përcaktuar për trajtimin apo depozitimin final të tyre.

Më poshtë paraqitet skema e thjeshtë e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Prrenjas.

[6] "Grumbullimi i mbetjeve" nënkupton mbledhjen dhe largimin e mbetjeve




*Grafiku 8: Skema e manaxhimit miks të mbetjeve*

Pra, sipas skemës, familjet, bizneset dhe institucionet çojnë në pikat e grumbullimit ku janë vendosur kontenierët të gjitha mbetjet e gjeneruara dhe më pas nëpërmjet mjeteve të transportit ato destinohen në venddepozitimin/ landfillin më të afërt, ku realizohet dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre.

*Vendodhja e PGM*

Duke iu referuar sistemit aktual të PGM-ve dhe problematikës që lidhet me to, çështjet për tu marrë në konsideratë janë:

- ✓ Eshtë e rëndësishme që shpërndarja e PGM të mbulojë sa më shumë zonën e mbetjeve në mënyrë që konsumatorët të kenë mundësi dhe lehtësi për t'i përdorur për hedhjen e mbetjeve, por që njëkohësisht duhet të mundësohet infrastruktura rrugore e nevojshme për vendosjen e PGM-ve dhe lëvizjen e makinës teknollogjike.
- ✓ Vendodhja dhe dendësia e tyre lidhet drejtpërsëdrejti me vendodhjet e zonave urbane dhe rezidenciale si dhe dendësinë e tyre si dhe kushtin e infrastrukturës dhe disponueshmërisë së hapësirës së nevojshme. Kështu për zona të ndryshme brenda qytetit (sipas klasifikimit të bërë me siper) kemi distanca të ndryshme midis PGM-ve apo largësi të ndryshme të tyre nga konsumatorët.

Në tabelën e mëposhtme rekomandohen disa standarde të largësisë mesatare mes llojeve të ndryshme të zonave urbane ku respektimi i tyre varet nga infrastruktura e përshtatshme dhe hapësirat e nevojshme për vendosjen e PGM.

| Tipet e zonave | Shumë të dendura | Të dendura | Mesatar | Të rralla |
|---|---|---|---|---|
| **Distanca mesatare (m)** | 50-100 | 100-150 | 150-200 | 200-250 |

*Tabela 26: Dendësia e PGM-ve*

Mbështetur dhe në standardet e mësipërme, pikat për grumbullimin e mbetjeve do të respektojnë standartin dhe sipas çdo zone mbetjesh pasqyrohen në tabelën e mëposhtme. Në çdo pikë Bashkia do të vendosë të paktën 1-2 kontenierë. Në zonat me densitetit të familjeve dhe bizneseve mund të vendosen edhe tre kontenierë.

**Kapaciteti dhe infrastruktura**

Për të përcaktuar infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve duke marrë parasysh nevojat reale të zonës së mbetjeve dhe synim përmbushjen e objektivave për përmirësimin e shërbimit, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierët dhe makinat teknollogjike. Për të konkluduar me analizën e mësipërme, më parë përcaktohet kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenierët me volum 1.1m$^3$ (që përdoren aktualisht në qytet si dhe gjerësisht të përdorshëm në vend dhe rajon), rekomandohen si më të përshtatshëm për këtë skemë grumbullimi mbetjesh. Gjithashtu rekomandohet që kontenierët të jenë metalik dhe vaskë (trashësi 1.5-2 mm) dhe sistem rrotash të qëndrueshëm, për të mundësuar qëndrueshmërinë e tyre nga ndikimi i faktorëve të jashtëm.

Ndërsa për zonat e thella rurale ku dhe aksesi është i limituar sugjerohet të vendosen kontenierë më të mëdhenj 1.7 m$^3$ (ose 2.2 m$^3$) të shoqëruar dhe me vende betoni në lagje të ndryshme të fshatrave.

- ***Të dhëna mbi popullsinë dhe bizneset***

Për parashikimin e numrit të popullsisë për vitet 2025-2029 u konsiderua:

- Popullsia sipas RrC.
- Duke qenë se emigrimi (si brenda qyteteve të tjera dhe jashtë Shqipërisë) ka pësuar rritje të qëndrueshme me 1% dhe nga ana tjetër rritja natyrale e popullsisë është në po të njëjtat nivele ne do të konsiderojmë si popullsi për zonën popullsia e korrektuar si më lart.
- Bizneset dhe Institucionet për periudhën 2025-2025, do të konsiderohen ato që janë rregjistruar në vitin 2023

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin total të banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2025-2029:

| Nr | Popullsia | V.2023 | | Planifikimi 2025 -2029 |
|---|---|---|---|---|
| | | Popullsia (GJ C) | Biznese & Instituc. | Popullsia |
| | | Nr | Nr | Nr |
| | **Totali** | **33425** | **503** | **33425** |
| **1** | **Prrenjas** | 8,831 | 331 | 8,831 |
| **2** | **NjA Qukes** | 10,512 | 62 | 10,512 |
| **3** | **NjA Rrajce** | 11,161 | 97 | 11,161 |
| **4** | **NjA Stravaj** | 2,828 | 13 | 2,828 |

*Tabela 27: Numri banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2019-2024*

***i. Gjenerimi i mbetjeve nga çdo zonë mbetjesh***

Duke i shtuar numrit të popullsisë së korrigjuar të vitit 2019 dhe numrin e bizneseve, bazuar dhe në totalin e mbetjeve të gjeneruara prej 5 ton/ditë në zonën urbane, 4 ton /dite për bizneset

dhe 9 ton /ditë për dy njësitë administrative apo 6388 ton/vit kemi një normë gjenerimi 0.6 kg/banorë/ditë në zonën urbane dhe 0.4 kg/banorë/ditë në zonën rurale.

Referuar shpërndarjes së bizneseve dhe institucioneve sipas çdo njësie administrative dhe gjenerimit ditor të mbetjeve nga çdo konsumator, rezulton që gjenerimi i mbetjeve ditor, në herë mbledhje dhe ai vjetor në çdo zonë mbetjesh të jetë si më poshtë:

| Nr | Emertimi Zones | Popullsia | popullsia e korrektuar | Frekuenca dite ne jave | Gjenerimi (kg/dit) | Gjenerimi (ton/dit) | Gjenerimi ton/here | Mbetje ton/vit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Zona 1 Semi Urbane | 18,500 | 14,800 | 4 | 8140.00 | 8.10 | 32.40 | 1684.80 |
| **2** | Zona 2 Semi Urbane | 11,629 | 9,303 | 1 | 5116.65 | 5.10 | 5.10 | 265.20 |
| **3** | Zona 3 Semi Urbane | 8,831 | 7,948 | 1 | 5563.60 | 5.56 | 5.56 | 289.28 |
| **4** | Zona 4 Urbane | 8,831 | 7,948 | 1 | 5563.60 | 5.56 | 5.56 | 289.12 |
| | Totali | **47,791.00** | **39,999.00** | 1 | **24383.85** | **24.32** | **48.62** | **2528.40** |

*Tabela 28: Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve në bazë vjetore*

### ii. Llogaritja e numrit të nevojshëm të kontenierëve

Llogaritja e kontenierëve të domosdoshëm për grumbullimin e mbetjeve është në funksion të tre faktorëve të domosdoshëm që janë gjenerimi i mbetjeve nga familjet, biznesi dhe institucionet, frekuenca e mbledhjes s tyre dhe kapaciteti i kontenierit. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh "të mëdha" duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Një kontenier tipik ka një vëllim 1.1$m^3$, i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 ton/$m^3$ për mbetjet. Kjo dendësi është matur në disa njësi vendore gjatë një fushate peshimi, por që është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin nevojat aktuale për kontenierë (1.1 $m^3$) ne vitin 2020, në zbatim të skemës së përbashkët të grumbullimit miks të mbetjeve:

| Zona | Mbetje ton/vit | Mbetje (ton/dit) | Frekuenca dite/jave | Gjenerimi ton/here | Dendesia e mbetjeve ton/m3 | Koef. mbushjes | Nevoja Kazane kontenier | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
| **Zona 1** | 1684.8 | 8.1 | 4 | 32.4 | 0.125 | 0.85 | 175 | 175 | 175 | 175 |
| **Zona 2** | 265.2 | 5.1 | 1 | 5.1 | 0.125 | 0.85 | 12 | 12 | 12 | 12 |
| **Zona 3** | 289.28 | 5.6 | 1 | 5.6 | 0.125 | 0.85 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| **Zona 4** | 289.12 | 5.6 | 1 | 5.6 | 0.125 | 0.85 | | | | |
| **Mirembajtje** | | | | | | | 5 | 10 | 10 | 10 |
| **TOTALI** | | | | | | | 192 | 192 | 192 | 192 |

*Tabela 30: Llogaritja e numrit të kontenierëve për vitet 2020-2024*

Pra, për mbledhjen mix të mbetjeve sipas frekuencave të propozuara, bashkia duhet të shpërndajë në vitin 2025 në territorin e saj në zonën 1. 174 kontenjerë dhe në zonën 2. respektivisht 12 dhe ne zonën 3 .5 kontenierë aq sa është dhe numri aktual i tyre.

### iii. Makinat për grumbullimin e mbetjeve

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë zakonisht vetëngjeshës me kapacitet 10 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë së njësisë.

Normalisht një zonë rurale përdor kamionë me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamionë me kapacitet 10 ton. Numri i kamionëve varion bazuar në sasinë e mbetjeve për t'u mbledhur dhe numrin e turneve të nevojshme për çdo kamion. Kapaciteti aktual i ngarkimit për një përbërje tipike mbetjesh është rreth 85% të kapacitetit total mbajtës të kamionit.

Bashkia Prrenjas për specifikën e zonës përdor kamionët 10 ton dhe një 5 tonëshe për të katërta zonat. Në funksion të variablave të mësipërm, pra të sasisë ditore të mbetjeve të gjeneruara, distancave dhe shtrirjes në vite si dhe kapacitetit mbushës bashkisë i nevojiten rreth 2 kamionë një 10 ton dhe tjetri 5 ton në vitin 2025 pasi do të shtohen dy zona njëra për Njësinë Administrative Stravaj me kamion 5 ton dhe një zonë riciklimi për qytetin Prrenjas një kamion tjetër 10 ton.

Deri në fund të vitit 2025 dy makinat teknologjike 10 ton për mbetjet mikse, një makinë teknologjike 5 ton për njësinë Stravaj dhe një për zonën e riciklimit makinë teknologjike 10 ton janë të mjaftueshme për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në venddepozitimin e "Krastës".

- **Intenerari i grumbullimit të mbetjeve dhe transporti i tyre**

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të grumbullimit dhe transportimit lidhen drejtpërsëdrejti me intinerarin e përzgjedhur të lëvizjes së makinës si dhe me kohën efektive të punës gjatë ndalesave në çdo PGM. Ulja e kohës së përgjithshme të mbledhjes, më saktë – kohës së ngarkimit, shmangies së rrugëve me gjysmë ngarkesë apo përdorimi i kamionëve të mirë me kapacitet më të mirë ngarkimi do të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e mbledhjes së mbetjeve[7].

Për të përmirësuar kohën e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, duhet të merren në shqyrtim itinerarët aktualë në zbatim të parimeve të listuara më poshtë:

- Itinerarët nuk duhet të copëtohen apo të mbivendosen. Secili itinerar duhet të jetë kompakt, i përbërë nga segmentet e mbledhura në të njëjtën zonë gjeografike;
- Itinerari i mbledhjes duhet të nisë sa më pranë autoparkut që të jetë e mundur, duke marrë parasysh rrugët me trafik të madh dhe ato me një kalim;
- Në rastin e rrugëve me një kalim, është më mirë të fillohet itinerari në fundin e sipërm të rrugës, duke kaluar poshtë saj në kahun e rregullt;

[7] Koha e grumbullimit të mbetjeve për një pikë me 2 kontenierë të shkojë nga 2.5-3 min.

- Shërbimet në rrugët pa krye mund të konsiderohen si shërbime për segmente rruge që mund të ndërpriten, përderisa ato mund të mblidhen vetëm duke kaluar poshtë segmentit të rrugës. Për të mbajtur kthesat djathtas në minimum, (në vendet ku automjetet lëvizin në krahun e majtë), mbledhja e mbetjeve nga rrugët pa krye bëhet kur ato janë në të majtë të kamionit. Këto mbetje duhet të mblidhen duke ecur për poshtë, mbrapsht apo duke bërë një kthesë në formë U;
- Mbetjet në kodra të pjerrëta duhet të mblidhen, aty ku është praktike, në të dy krahët e rrugës kur kamioni po zbret për poshtë. Kjo lehtëson mbledhje të sigurt, të lehtë dhe të shpejtë. Kjo ul edhe amortizimin e automjetit si dhe kursen karburant.
- Për mbledhjen nga të dy krahët e rrugës në të njëjtën kohë, në përgjithësi është më mirë të bëhet itinerari në rrugë të drejtë sipas planit para se të kalohet në itinerarin në krahun e kundërt.

Pas verifikimit të plotësimit të parimeve të mësipërme, është e rëndësishme të bëhet matja/ testimi i kohës reale të grumbullimit të mbetjeve.

### 4.4.3 Buxhetimi në bazë aktiviteti

Metodologjia e përdorur është buxhetimi në bazë të programit, mbështetur në ligjin 9936/2008 "Për menaxhimin financiar në RSH" dhe në ligjin organik 139/2015: "Për vetëqeverisjen vendore" ku sipas nenit 23 (pika 10) *Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve përfshihet në programin e shërbimeve publike*.

Llogaritja e kostos për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në Bashkinë e Belshit, është bazuar në **VKM 319/2018** për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe modelin e përgatitur nga dldp.

Përllogaritja është bazuar në blloqet vijuese:

a. Të dhënat përmbledhëse për zonën administrative,
b. Investime kapitale (kamionë dhe kontenierët e nevojshëm),
c. Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel),
d. Kostoja për largimin në "landfill" (tarifa e depozitimit) është zero në momentin aktual,
e. Kostot e amortizimit (ri investimit),
f. Kostot administrative

A. Fshirja dhe larja e rrugëve

Bashkia tashmë ka përfunduar inventarizimin e rrugëve rurale, të cilat janë funksione të reja të saj. Bashkia synon përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe rritjen e zonës të mbuluar me shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shesheve, duke përfshirë gjithë zonën urbane dhe një pjesë të zonës rurale.

Aktualisht, mbulohet me shërbim fshirje sipërfaqja prej 49,416 $m^2$ rrugë, trotuare dhe sheshe. Gjithashtu lagen çdo ditë gjatë periudhës së maj-shtator 53,596 $m^2$ sipërfaqe.

Sipas objektivave të programit buxhetor afatmesëm, Bashkia Prrenjas do të krijojë një infrastrukture më bashkëkohore, pra do të rritë sipërfaqet e rrugëve të asfaltuara, duke tentuar drejt përmirësimit të standartit jo vetëm të rrjetit rrugor të qytetit, por edhe në zonat rurale.

Metodologjia e pastrimit të rrugëve është jo shumë efikase (nuk përdoren makina fshesë) dhe kjo metodologji do të përdoret dhe për 5 vitet e ardhshme, pra do të vazhdohet të fshihet me punëtorë (në mënyrë manuale).

**Politikat, objektivat dhe kostot e shërbimit**
**Politikat 2025-2029**

***i. Shërbimi i fshirjes së sipërfaqeve***

- Bashkia do të përfshijë në shërbimin e fshirjes, 49,416 m²/ditë rrugë e trotuare të qytetit të Prrenjasit.

***ii. Shërbimi i larjes së sipërfaqeve***

- Do të vazhdojë të laget e njëjta sipërfaqe prej 53,596 m²/ditë (dy herë në ditë gjatë periudhës maj-shtator) në qytetin Prrenjas.

**Kosto për çdo aktivitet**

Kur flasim për aktivitete të pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe shesheve, ato përfshijnë:

- fshirje me fshesë e 49,416 $m^2$ rrugë, trotuare dhe sheshe për qytetin Prrenjas të cilat do të fshihen tre ditë në javë.
- mbledhje e mbetjeve nga fshirja dhe nga koshat e vegjël të mbetjeve;
- depozitimi i këtyre mbetjeve në pikat e afërta të grumbullimit (kontenierët);
- lagija e përditshme (në 5-muaj) e sipërfaqeve prej 53 596 $m^2$, të përcaktuara në sezonin përkatës;

***Standarti i shërbimit***

a) Fshirje me fshesë çdo ditë e sipërfaqes prej 49,416 $m^2$,
b) Lagie çdo ditë / dy herë në ditë për periudhën 5- mujore, nga 1 maj-30 shtator e 53,596 $m^2$ sipërfaqe,
b) Norma e fshirjes rreth 6,000 $m^2$/punëtor,
c) Norma e lagies 153 ditë pune në vit,

***Llogaritja e qendrave të kostos për çdo aktivitet***

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktiviteteve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2025.
- ✓ Llogaritjet e fuqisë punëtore janë bërë sipas kodit të punës për 40 orë në javë, pra shtohen puntorë rezervë për të zëvëndësuar ditët e pushimit, festave, lejes së zakonshme dhe të ndonjë raporti mjekësor.
- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet për vitin 2019, u përdor si referencë për llogaritjen e kostos operative në vitet 2020-2024, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2019 rriten mbi bazën e sipërfaqeve të reja që Bashkia vendos të shtohen sipas mundësive buxhetore:

| Kosto Fshirjen e rrugëve (000/Leke) | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Zona I qyteti** | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 |
| **Zona II** | | | | | |
| **Zona III** | | | | | |
| **Zona IV** | | | | | |
| | | | | | |
| **Shuma** | **5,067,640** | **5,067,640** | **5,067,640** | **5,067,640** | **5,067,640** |
| **Lekë për $m^2$ fshirje** | **0.39** | **0.39** | **0.39** | **0.39** | **0.39** |

*Tabela 31: Kosto e fshirjes së rrugëve*

| Kosto larje e rrugëve/shesheve (000/Leke) | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Prrenjas** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Zona I** | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 |
| **Zona II** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **ZonaIII** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | |
| **Zona IV** | | | | | |
| **Shuma** | **1,817,550** | **1,817,550** | **1,817,550** | **1,817,550** | **1,817,550** |
| **Lekë për $m^2$ larje** | **0.221647357** | **0.2** | **0.2** | **0.2** | **0.2** |
| | | | | | |

*Tabela 32: Kosto e larjes së rrugëve*

Në anekse gjeni llogaritjen analitike të kostos së fshirjes dhe larjes së rrugëve.

**Mbledhja, largimi[8] dhe transporti miks i mbetjeve**

Mbledhja dhe llogaritja e të dhënave për periudhën 2025-2029, shërbeu për kuptimin dhe vlerësimin e situatës aktuale që lidhet me investime kapitale, shpenzimet operative, shpenzimet e personelit dhe shpenzime të tjera administrative. Informacioni u sigurua nga grupi i punës, si dhe bazat e të dhënave duke shfrytëzuar hartat, dokumentet strategjike, planet kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, dhe referencat e raporteve të ndryshme.

**Supozimet:**

- ✓ Supozohet se Zona I-rë do t'i largojnë mbetjet nga kontenierët 4-ditë në javë, Zona e II-të,III, të IV do t'i largojnë 1 herë në javë.
- ✓ Normalisht një kamion që grumbullon mbetjet duhet të vizitojë të gjithë zonat administrative (pikat e grumbullimit), duke udhëtuar përreth derisa kamioni të mbushet plot. Më tej, ai drejtohet në inceneratorin e Elbasanit dhe kthehet përsëri, gjë që mund të përkojë me një turn ose përfundimin e shërbimit të grumbullimit për një ekip 2 shofera plus 2 punonjës. Gjendja e rrugëve është shumë e rëndësishme pasi kjo lidhet kryesisht me konsumin dhe kostot e amortizimit dhe, për më tepër me kohën e

[8] Per termin "mbledhje dhe largim" sipas ligjit 139/2015, mund te perdoret fjala permbledhese "grumbullim

shpenzuar për grumbullimin. Rrugët e shtruara përmirësojnë shumë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve. Distancat të cilat u morrën në konsideratë janë:
- Distanca për grumbullimin, për të mbushur një kamion,
- Distanca për transportin, për të shkuar dhe kthyer ngainceneratori I Elbasanit.

Rezultatet e mbetjeve të gjeneruara, për qëllime të llogaritjes së kostos, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

| | **Zona 1** | | | | **Zona 2** | **Zona 3** | **Zona 4** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Dita e javës** | **E hënë** | **E martë** | **E mërkurë** | **E enjte** | **E premte** | **E shtunë** | **E dielë** |
| *Përshkrimi i zonës së shërbimit* | **Qyteti** dhe Njësia Administrative Rrajcë | **Qyteti** dhe Njësia Administratie Qukës | **Qyteti** dhe Njësia Administrative Rrajcë | **Qyteti** dhe Njësia Administrative Qukës | **Qyteti** Njësia Administrative Stravaj | **Qyteti** dhe fshati Rashtan | Vetëm **qyteti (5)** |
| *Popullsia e shërbyer* | **19850** | | | | **11718** | **8890** | **8350** |

*Tabela 33: Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh*

| **TE DHENAT BAZE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Emri i Zones se Mbetjeve (NjA)** | **Njësia** | **Zona I** | **Zona II** | **Zona III** | **Zona IV** |
| **Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve** | Nr. | 4 | 1 | 1 | 1 |
| **Kategoria** | | Semi urban | Semi urban | Semi urban | Urban |
| **Popullsia dhe biznesi i shërbyer në këtë zonë** | Nr. | 18,500 | 11,629 | 8,831 | 8,831 |
| **% e popullsisë që përjashtohen (të regjistruar, por jetojnë jashtë)** | % | 2,960.0 | 1,860.6 | 794.8 | 794.8 |
| **Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)** | Nr. | 14,800 | 9,303 | 7,948 | 7,948 |
| **Rrugët (distanca nga Landfilli vajtje-ardhje)** | Km | 112 | 112 | 112 | 112 |
| **Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit/turn për një kamion)** | Km | 80 | 72 | 24 | 16 |
| **Mbetjet e gjeneruara per njesi (banor, biznes, institucion)** | kg/njesi/dite | 8,140.0 | 5,116.7 | 5,563.6 | 5,563.6 |
| **Totali i mbetjeve të gjeneruara** | ton/dite | 8.1 | 5.1 | 5.6 | 5.56 |
| **Totali i mbetjeve të gjeneruara** | **ton/dite** | **8.1** | **5.1** | **5.563** | **5.56** |
| **Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve sipas frekuencës** | **ton/dite** | **8.1** | **5.1** | **5.563** | **5.56** |
| **Totali i mbetjeve të gjeneruar** | **ton/vit** | **1,685** | **265** | **289** | **289** |

Të gjitha shifrat e mësipërme kanë të bëjnë me mbetjet e ngurta urbane, duke mos përfshirë mbetjet e rrezikshme, bujqësore, inertet dhe mbetjet voluminoze, të cilat duhet të trajtohen veçmas në bazë të standardeve për menaxhimin e tyre.

## Politikat, objektivat dhe kostot

Sipas skemës miks të prezantuar më sipër familjet, bizneset dhe institucionet çojnë në pikat e grumbullimit ku janë vendosur kontenierët të gjitha mbetjet e gjeneruara dhe më pas

nëpërmjet mjeteve të transportit ato destinohen në venddepozitimin/ landfillin më të afërt, ku realizohet dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre.

## Politikat 2025-2029

**Mbi plotësimin e bashkisë me kontenierët e nevojshëm**

- ✓ Vitin e parë të planit, 2025, Bashkia do të shtrijë zonën e shërbimit në të katërta njësitë administrative plotesojë në masen 95% të bashkisë me kontenierë të rinj (rreth 192 kontenier) të domosdoshëm, duke vënë në dispozicion 80 kontenier në zonën e qytetit dhe 100 në zonën e Njësive Administrative Rrajcë dhe Qukës, sipas gjenerimit të mbetjeve në të dy zonat e mbuluara me shërbim në vitin aktual dhe 12 në Njësinë A dministrative Stravaj.
- ✓ Në vitin 2023 janw blerë të blihen 75 kontenier për të mbuluar zonat e reja të shtrirjes së shërbimit, dhe zonës së re dhe fillimi i krijimit të një rezereve te tyre prej 3 kontenierësh për raste riparimi.
- ✓ Nga vitin 2024, bashkia do të sigurojë numrin e nevojshëm të kontenierëve prej 122 kontenier të rinj, që sipas llogaritjeve të bëra dhe gjenerimit të mbetjeve dhe zgjerimit të zonave të shërbimit arrin në 192 kontenier, duke mbuluar 95% të NJA dhe krijuar një fond rezervë për riparime me 10-kontenier.

| Numri i kontenierëve sipas zonave | Numri aktual gjendje | Parashikimi I kontinerëve 2025-2029 | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **v. 2025** | v.2026 | v.2027 | v.2028 | v.2029 |
| **Zona 1** | 80 | 80 | 80 | 80 | 80 |
| **Zona 2** | 50 | 50 | 50 | 50 | 50 |
| **Zona 3** | 50 | 50 | 50 | 50 | 50 |
| **Zona 4** | 12 | 12 | 12 | 12 | 12 |
| Total | **192** | **192** | **192** | **192** | **192** |
| Kontenierë Shtesë per çdo vit | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

*Tabela 34: Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme*

**Mbi organizimin e pikave të vendosjes së kontenierëve**

Përcaktimi i pikave për vendosjen e kontenierëve do të jetë në funksion të grumbullimit miks të mbetjeve dhe në çdo pikë do të vendosen 1-2 kontenierë, pra mesatarisht bashkia do të ketë sipas numrit të kontenierëve 145 pika per vitet 2024-2029

- ✓ Aktualisht kemi 99 pika për grumbullimin e mbetjeve nga të cilat 51 pika në zonën 1 në qytetin e Prrenjasit dhe 48 në njësitë Administrative Rrajcë dhe Qukës.

## *OBJEKTIVAT*

***a) Objektivat për rezultatet***

- Mbulimi 95% i familjeve, bizneseve, institucioneve me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve ( nga 23% e familjeve, 94% e bizneseve dhe 69% e institucioneve që përfitonin shërbim në vitin 2020 do të perfitojnë 95 % e tyre në vitin 2025 e në vazhdim).
- Rritja me 100% e plotësimit të të gjithë territorit të Bashkisë me kontenierët e nevojshëm (nga 72% në vitin 2019 në qytetin e Prrenjasit dhe 0% në NjA të tjera).

*Llogaritja e qendrave të kostos për çdo aktivitet*

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktiviteteve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2025.
- ✓ Kosto për njesi shërbimi për çdo aktivitet të vitit 2025, u përdor si referencë për llogaritjen e kostos operative në vitet 2020-2024, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2025 rriten mbi bazën e gjenerimit te mbetjeve dhe shtimit të zonave të shërbimit në të gjithë territorin kostos së naftës si dhe rritjes së pagave .

Aktiviteti i mbedhjes dhe transportit të mbetjeve sipas skemës së mësipërme përfshin:

- Grumbullimin miks të mbetjeve urbane në të gjitha pikat publike me kontenierë
- Pastrimin e vendit rreth kontenierëve
- Transportin e mbetjeve në vend depozitimin e Krastes

***Standarti i shërbimit***

Bashkia do të largojë mbetjet çdo ditë për të gjitha zonat urbane dhe gjysëm urbane dhe 1 herë në javë për zonat rurale. Pra, këto frekuenca rezultojnë si më të përshtatshme për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve. Për më tepër konsumatorët e shërbimit janë më të familjarizuar më këto frekuenca shërbimesh.

Nga shërbimi i pastrimit në bashki, planifikohet se do të largohen të gjitha mbetjet e gjeneruara e grumbulluara në kontenierët sipas këtij grafiku:

1. Zona I-rë do t'i largojnë mbetjet 4-ditë në javë,
2. Zona e II-të do t'i largojnë 1- herë në javë,
3. Zona III-të do t'i largojnë1-herë në javë,
4. Zona IV-të do t'i largojnë1-herë në javë,

## C. Kostot e Mbledhjes dhe Transportit të Mbetjeve

### C.1 Kostot Kapitale


Bashkia është e domosdoshme të krijojë infrastrukturën bazë fizike të menaxhimit të mbetjeve. Si hap i parë, duhet llogaritur sa kamionë dhe konteniere nevojiten për të menaxhuar mbetjet në mënyrën e duhur. Blerja e këtyre mjeteve përfaqëson investimin kapital.

### C.1.1 Kosto kapitale për Kamionët

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 10 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë e njësisë. Normalisht në zonë rurale dhe gjysëm urbane mirë është të përdoret kamioni me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamioni me kapacitet 10 ton.
Deri në fund të vitit 2024 dy makina teknologjike, të një kapaciteti 10 ton janë të mjaftueshme për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në landfillin e Krastës.

### C.1.2 Kosto kapitale për Kontenierët

Një kontenier tipik ka një vëllim 1.1$m^3$, i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 ton/$m^3$ për mbetjet. Kjo dendësi është mirë të matet nga bashkia nëpërmjet peshimit, sepse është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve. Kapaciteti i një kontenieri është në varësi të madhësisë së tij dhe dendësisë specifike të mbetjeve në kontenier. Shifrat e dhëna mund të përdoren si vlerësim paraprak.




*Grafiku 9: Rritja e numrit të kontenierëve në 5 vitet e ardhshme*

Numri i kontenierеve të nevojshëm llogaritet duke marrë në konsideratë një tipologji të kufizuar të mbetjeve, kryesisht shtëpiake. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh "të mëdha" duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Sipas grafikut numri i kontenierëve të nevojshëm për grumbullimin e mbetjeve është 177.
Në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve në vite, bashkia do të plotësojë dhe numrin e nevojshëm të kontenierëve për vitet 2020-2024. Pra, kontenierët në vitin 2024 rriten me 27 copë krahasuar me vitin 2020 dhe për vitin 2025 do të rriten deri në 192 kontenierë .

### C.1.3. Larja e disifektimi i kontenierëve

Në planin e menaxhimit është analizuar edhe Larja e disifektimi i kontenierëve. Ky shërbim do të ofrohet për kontenierët e të katër  zonave të shërbimit:

| Kosto larje e disifektimit kontenierve (000/Leke) | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Të gjitha zonat 192 kontenierë total** | 1999 | 1999 | 1999 | 1999 | 1999 |
| **Shuma** | 1999 | 1999 | 1999 | 1999 | 1999 |
| **Lekë për1/kontenier larje** | **333.17** | **333.17** | **333.17** | **333.17** | **333.17** |

*Tabela 35: Kosto e larje e disfektim kontenierë*

### *C.2 Kostot Operative*

Kostot operative janë shpenzimet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e infrastrukturës (në lidhje me kamionët dhe kontenierët) dhe me transportin e mbetjeve, duke përfshirë koston e personelit. Këto kosto vjetore duhen mbajtur të ndara, sepse janë të lidhura ngushtë me ndryshimet e tregut dhe inflacionin.

Llogaritja e kostos operative varet nga disa variabla:

i. Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi, të cilat lidhen ngushtë me:
- frekuencën e grumbullimit të mbetjeve (nga 1 herë apo 7 herë në javë), pra me sasinë e mbetjeve që grumbullohen. Nëse ka një gjenerim mbetjesh prej rreth 8.1 ton/ditë, ka nevojë për shërbime të përditshme. Në rast se shërbimi nuk kryhet çdo ditë ka nevojë për shtim të numrit të kontenierëve.

ii. Kostoja e karburantit- Konsumi i karburantit varet nga një planifikim i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficent, gjendjes teknike të automjetit (*niveli i lartë i amortizimit sjell rritje të konsumit të karburantit në normativën për litra/km)* dhe ndikon shumë në kostot e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet gjatë viteve të planit të çmimit të karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.

### C.2.1 Kostot e Mirëmbajtjes

i. Mirëmbajtja e kamionëve

Kostot që lidhen me kamionët janë të larta dhe mirëmbajtja e tyre është kërkesë e legjislacionit. Mirëmbajtja e kamionëve është e lidhur me ndërrimin vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe kërkon një plan të mirë administrativ për mirëmbajtjen. Për më tepër, kostot e sigurimeve dhe taksave duhet të llogariten çdo vit.

Shifrat për sigurimet dhe taksat i referohen taksave kombëtare për tipin e kamionit të përdorur. Për shkak të ndarjes të bashkisë në 4-zona mbetjesh, kostot e mirëmbajtjes së 2-kamionëve 10 ton dhe 5 ton, janë përllogaritur në zonën e parë dhe të dytë të mbetjeve, por në se Bashkia do të bëjë një përllogaritje të detajuar dhe analitike për çdo zonë shërbimi, ajo duhet të shpërndahet në mënyrë proporcionale në të 4-zonat, sipas kilometrave dhe frekuences së mbledhjes e largimit për në landfill.

ii. Mirëmbajtja mekanike (shërbimet)

Mirëmbajtja mekanike lidhet me orët e punës së kamionit, me kushtet e rrugëve, përdorimin e kamionit. Këto kosto duhet të mbikqyren për t'i mbajtur sa të jetë e mundur në nivele të ulta.

Sasia e parave të kërkuar për mirëmbajtjen vjen nga përvoja e mëparëshme e kamionit në pronësi/përdorim, nga gjendja teknike dhe nga përdorimi i këtyre mjeteve me një skenar/grafik të ri sa më efiçent dhe i realizueshëm.

iii. Parkimi

Sugjerohet të përdoret për parkim të mjeteve toka e vetë bashkisë, se në rast të kundërt mund të ketë kosto të tjera që lidhen me qeranë, me mirëmbajtjen e parkimit, rojet, shpenzime të tjera etj. Sasia e parave të kërkuara për parkim bazohet në realitetin e njësisë. Nëse NJQV ka tokën e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndërtuar një park për të gjithë mjetet.

Tabela më poshtë tregon kostot totale të mirëmbajtjes[9] për çdo zonë mbetjesh, e llogaritur vetëm për dy kamionët dhe e ndarë për 1-zone:

| KOSTOT E MIREMBAJTJES | Njësia | Zona I makinë 10 ton | Zona II makinë 5 ton |
|---|---|---|---|
| **Sigurimi i kamionit + taksat** | leke/kamion/vit | 150,000 | 80,000 |
| **Vaj + filtra** | leke/kamion/vit | 90, 000 | 50,000 |
| **Goma** | leke/kamion/vit | 160,000 | 120,000 |
| **Mirëmbajtja mekanike** | leke/kamion/vit | 150,000 | 140,000 |
| **Parkim** | leke/kamion/vit | 50,000 | 50,000 |
| **Kostot totale të mirëmbajtjes** | **leke/kamion/vit** | **600,000** | **440,000** |

*Tabela 36: Kosto e mirëmbajtjes*

### C.2.2 Kostot e Mbledhjes dhe Transportit

Kostoja e mbledhjes dhe transportit varet nga:

i. ***Koha e shpenzuar (orë)*** - ka të bëjë me kohën për mbledhjen e mbetjeve në kohë për transportin e tyre në landfill. Kjo shifër varet nga lloji i automjetit dhe llojit të zonës (urban, gjysem urban, rural). Zakonisht për kohën e grumbullimit një kamion 5t do t'i duhen 3 orë për të përfunduar ndërsa një kamioni 10t do t'i duhen 4 orë (keto mund të maten nga vetë bashkia).

   Koha gjithashtu ndryshon në varësi të distancës në vend depozitim dhe shpejtësisë të kamionit. Në vend depozitim, kamionët kanë nevojë për një kohë shtesë për të shkarkuar që është mesatarisht 0,3 orë/turn.

ii. ***Distancat e përgjithshme (km)*** - llogaritur si distanca për grumbullimin e mbetjeve dhe distanca në vend depozitim. Një sistem rrugor i mirë i brendshëm do të rezultojë shumë eficient për të zvogëluar distancat e përgjithshme, pra, më pak kohë dhe më pak karburant. Intinerari i rrugëve të brendshme të kamionëve sugjerohet të studiohet më përpara, për të mos përshkuar (nëse është e mundur) të njëjtat rrugë dy herë.

iii. ***Konsumi i karburantit (l)*** - Varet nga lloji i automjetit dhe numri i shërbimeve. Nga përvoja konsumi për kamionë për grumbullimin e mbetjeve është përkatësisht: për kamionin 5t =3 litra/orë, për atë 10t = 5litra/orë.

[9] Kostot e mirëmbajtjes janë llogaritur për 2 kamionë dhe janë ndarë në mënyrë të barabartë për zonat.

Konsumi për kamionë gjatë transportit është konsideuar përkatësisht: për llojin 5t = 0.4 litra/km, për llojin 10t = 0.5litra/km.
Për të qenë sa më të saktë dhe për të përcaktuar ku janë kostot kryesore (dhe kursimet e mundshme), kështillohet të ndahen kostot për grumbullimin (kur kamioni është duke u mbushur) nga kostot e transportit (kur kamioni është e plot dhe rrugës për në 'vend depozitim').

### C.2.2/a Kosto e grumbullimit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e grumbullimit të mbetjeve:

| Kostot e grumbullimit | Njësia | Zona I | Zona II | Zona III | Zona IV |
|---|---|---|---|---|---|
| **Dite pune (nëse më pak se 2ton/ditë, grumbullimi 2herë/javë)** | dite | 208 | 52 | 52 | 52 |
| **Kostot e karburantit** | leke/liter | 200 | 200 | 200 | 200 |
| **Koha për të ngarkuar një kamion në herë - koha e grumbullimit** | ore | 5 | 5 | 5 | 5 |
| **Koha totale për grumbullim (nr. kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve)** | ore/dite | 5 | 5 | 5 | 5 |
| **Koha për të shkarkuar në "landfill" [h]** | ore | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 |
| **Proporcioni i kohës totale për grumbullim [%]** | % | 70% | 70% | 70% | 70% |
| **Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit** | litra/vit | 1,497,600 | 336,960 | 112,320 | 74,880 |
| **Kilometra rruge /vit ne total për grumbullim** | km/vit | 16,640 | 3,744 | 1,248 | 832 |
| **Kostot totale për grumbullim (vit)** | **leke/vit** | 1,497,600.0 | 336,960 | 112,320.0 | 74,880.0 |

*Tabela 37: Kosto e grumbullimit të mbetjeve*

### C.2.2/b Kosto e transportit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e transportit të mbetjeve:

| Kostot e transportit | Njësia | Zona I | Zona II | Zona III | Zona IV |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpejtësia e lëvizjes** | km/ore | 60 | 60 | 60 | 40 |
| **Koha e transportimit për në "landfill"** | ore | 2.0 | 2.0 | 2.0 | 2.0 |
| **Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët)** | ore/dite | 3.0 | 3.0 | 3.0 | 3.0 |
| **Proporcioni i kohës totale për transport [%]** | % | 30% | 30% | 30% | 30% |
| **Totali i km për transport për dit, të gjithë kamionat** | km/dite | 112 | 112 | 112 | 112 |
| **Karburan i konsumuar gjatë transportit** | litra/vit | 2,096,640 | 524,160 | 524,160 | 524,160 |
| **Kilometra rruge /vit ne total për transport** | km/vit | 23,296 | 5,824 | 5,824 | 5,824 |
| **Kostot totale për transport (vit)** | **leke/vit** | 2096640 | 524,160 | 524,160 | 524160 |

*Tabela 38: Kosto e transportit të mbetjeve*

### C.2.2/c Kosto e personelit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

Llogaritja e kostos së personelit është një komponent menaxhues i përgjegjshëm që duhet të adresojë edhe aspektet sociale.

Fokusohet tek kostot operative të personelit, por duke u kufizuar tek shoferët dhe operatorët e kamionëve. Pavarësisht se shërbimi mund të ofrohet nga vetë njësia ose kontraktohet së jashtmi, personeli i punësuar duhet të mbikqyret gjithmonë nga administratorët e shërbimeve

të bashkisë, për të siguruar që ekipi punon me eficiencë shërbimi (kohë, siguri, performancë të detyrës, etj.).

Kjo kosto kushtëzohet nga:

i. **Personeli (Numri)**

Një kombinim i mirë është 1 shofer për makinë dhe dy operatorë gjatë grumbullimit të mbetjeve. Operatorët nuk është gjithmonë e nevojshme të shoqërojnë kamionin në venddepozitim.
Numri i shoferëve dhe punëtorëve llogaritet duke marrë parasysh numrin e turneve për/kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë dhe javë. Pra një kamion mund të përdoret nga 2 shoferë, (*1 e përdor paradite dhe një mbasdite)*.
Personeli duhet mbështetur me uniforma, mjete per grumbullim, pastrues kimike etj.

ii. **Orari i punës**

Sipas kodit të punës 1 punëtor nuk mund të punojë më shumë se 48 orë në javë. Në rast të orareve të zgjatura mbi 8 orë, orët shtësë konsiderohen me pagesë, dhe nuk mund të punohet mbi 12 orë në ditë. Kur është e mundur, orët jashtë orarit të punës duhet të shmangen. Duhet të vendoset një ekuilibër i mirë mes numrit të turneve, orëve për turn dhe orët e totale të punës për çdo staf. Nëse është e pashmangshme, duhet të llogariten kostot shtesë për orët shtesë, ose, në qoftë se është vërtet e nevojshme, të pajtohet në punë më shumë personel.

Dita e punës së personelit përbëhet nga koha për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin (ditari) dhe takimet/trajnimet. Për llogaritjen e kostos duhet të kryhet një shpërndarje mes shërbimit të kamionit dhe mirëmbajtjes.

a) ***Llogaritja jonë:*** *maksimumi 8 orë në ditë dhe 40 orë një javë - kohë të përfshira këtu për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin, takime etj.*
b) ***Llogaritja jonë:*** *7.3% e kohës e harxhuar me punët e mirëmbajtjes dhe 7.7% e kohës për ditë pushime.*

**Paga -** është llogaritur në bazë të Kodit të Punës duke respektuar pagën minimale dhe pjesën tjetër në varësi të punës dhe kapacitetit. Paga përfshin pagesën dhe për detyra të tjera. Në pagesën mujore ligjore përfshihen dhe kritere të tjera si puna natën apo dhe vjetërsia në punë si dhe taksat.

Tabela e mëposhtme llogarit koston e shoferave dhe operatorëve:

| Kostot e shofereve dhe operatoreve | Njësia | Zona I | Zona II | Zona III | Zona IV |
|---|---|---|---|---|---|
| **Ditët e punës në javë** | dite/jave | 7 | | | |
| **Orët e punës në javë** | ore/jave | 42 | | | |
| **Orët e punës në ditë** | ore/dite | 6 | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mirëmbajtja (ne % ndaj kohës së punës)** | % | 7.30% | | | |
| **Pushimet** | % | 7.70% | | | |
| **Numri i shoferave bazuar në nevojën ditore (duke marrë në konsideratë kufizimet sipas turneve = nuk mund të ndërrohen shoferët në mes të turnit)** | 0 | 2 | 1 | 1 | 1 |
| **Orët e punës për javë / shofer (pa mirëmbajtjen dhe fundjavat)** | ore | 35.7 | | | |
| **Koha javore e nevojshme për mirëmbajtje** | ore/jave | 3.07 | | | |
| **Koha javore e nevojshme për pushim fundjave** | ore/jave | 3.23 | | | |
| **Orët e punës për javë / shofer (me mirëmbajtjen)** | ore/jave | 38.8 | | | |
| **Numri total i shoferave të nevojshëm (duke konsideruar orët maksimale të punës në javë)** | numri | 2 | 1 | 1 | |
| **Paga mujore e shoferave** | leke/vit | 60,000 | - | - | |
| **Taksat (ne % ndaj pages)** | % | 27.80% | 0.00% | 0.00% | |
| **Kosto vjetore per shoferet** | **leke/vit** | **1,840,320** | **-** | | **-** |
| **Numri i punonjesve/operatoreve per ekip ( 1 shofer X 2 operatore)** | numri | 2 | - | - | |
| **Ore e punes ne jave/operator (perfshijne mirembajtjen)** | ore/jave | 28.0 | | | |
| **Koha e mbetur per detyra te tjera ne jave / operator** | ore/jave | 14.0 | | | |
| **Paga mujore e punonjësve/operatorëve** | leke/vit | 50,000 | | | |
| **Taksat (ne % ndaj pages)** | % | 27.80% | | | |
| **Kosto vjetore per operatoret** | **leke/vit** | **1,533,600** | | | **-** |

*Tabela 39: Kosto e shoferëve dhe operatorëve*

### C.2.3 Kostot e Depozitimit të mbetjeve në landfill

Sipas legjislacionit për "mbetjet" çdo NJQV duhet t'i depozitojë mbetjet në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Kosto për depozitim mbetjesh është vendosur si tarifë hyrjeje dhe zakonisht paguhet për ton 2500 leke pa tvsh.

Kostot e depozitimit mund të jenë subjekt i ndryshimit, bazuar në sasinë e mbetjeve që shkon përditë në 'landfill' dhe sipas shërbimeve që kryhen në të. Si pasojë duhet të nënshkruhet një marrëveshje e qartë, e cila do ta adresojë tarifën bazuar në një plan biznesi të përshtatshëm dhe të shtrirë në kohë.

Bashkia i depoziton mbetjet në inceneratorit të Elbasanit

Në vitin 2023-2024 kjo kosto është zbritur dhe është rillogaritur kosto transporti vajtje-ardhje në landfill të Elbasanit me distancë 112 km, sepse mbetjet dërgohen në inceneratorin e Elbasanit. Ky ndryshim, ka sjellë një rritje të kostos së përgjithshme në dy vitet e fundit të planit, me 6,500,000 mijë lekë më shumë se në tre vitet e para.

### C.2.4 Kostot e Amortizimit

Në mënyrë që sistemi të mbahet në punë për një kohë të gjatë rëndësi ka llogaritja e kostove të nevojshme për riinvestim. Pra, konsiderimi i kostos së amortizimit është çështje e qëndrueshmërisë të sistemit dhe siguron një sistem funksional.

Llogaritja bazohet në legjislacionin shqiptar për amortizimin e pajisjeve, e cila parashikon një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe lidhen direkt me koston vjetore për amortizimin për kamionët dhe

kontenierët. Kjo i shtohet sistemit si një përqindje për vitin, që praktikisht paraqet 6-15% të shumës totale të kostos për kamionë dhe 2-6% të shumës totale të kostos kontenierë në vit.

Kjo nuk lidhet detyrimisht me amortizimin e vërtetë. Përdorimi i papërshtatshëm mund të shkurtojë jetën e pajisjeve dhe për këtë arsye të ndikojë ndjeshëm në koston për mirëmbajtjen, investimet, dhe eficiencën e shërbimit (koha, karburanti). Për kontenieret kjo llogaritje është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të tyre.

## B. PERMBLEDHESE E KOSTOS OPERATIVE DHE KAPITALE

### E.1 Kosto e vitit 2025

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e kostos totale për vitin e parë të planit 2025, dhe informon drejtorinë përkatëse mbi nevojat për investime, personel, operacione, amortizimin e mjeteve dhe kosto të tjera, në mënyrë që të jetë në gjendje të paraqesë vlerësimin e kostos në nivelin e duhur tek kryetari i bashkisë dhe këshilli i bashkisë.

| **Kosto totale operacionale** | **Njesia** | **Zona I** | **Zona II** | **Zona III** | **Zona IV** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mirembajtje** | Leke/vit | 8,093,160 | 861,120 | 636,480 | 599,040 | **10,189,800** |
| | | | | | | |
| **Kosto totale investime** | **Njesia** | **Zona I** | **Zona II** | **Zona III** | **Zona IV** | **Totali** |
| **Kamione(blerje/qera)** | Leke | - | | | | **-** |
| **Kontenier ( cope)** | Leke | - | | | - | **-** |
| **Kosto totale** | | **-** | | | | **-** |
| **Të ardhurat neto ( ne % ndaj kostos totale)** | % | | | | | |
| **Totali i të ardhurave neto** | **Leke/vit** | | | | - | **-** |
| **TOTAL KOSTO OPERACIONALE** | **Leke/vit** | **8,093,160** | **861,120** | **636,480** | **599,040** | **10,189,800** |
| **Kosto totale per fshirje** | **Leke/vit** | **5,067,640** | **0** | **0** | **0** | **5,067,640** |
| **Kosto totale per larje** | **Leke/vit** | **1,817,550** | **0** | **0** | **0** | **1,817,550** |
| **Kosto totale per larje dizifektim dhe deritazim i kontenierеve** | **Lek/vit** | **795,600** | **0** | **0** | **0** | **795,600** |
| **Kosto totale e depozitimit ne Landfill** | **Lek/vit** | **4,212,000** | **663,000** | **723,190** | **722,800** | **6,320,990** |
| **TOTALI I KOSTOS SHERBIMIT TE PASTRIMIT** | **Leke/vit** | **19,985,950** | **1,524,120** | **1,359,670** | **1,321,840** | **24,191,580** |


*Tabela 42: Kosto e totale e shërbimit*

Sipas peshës që zënë shpenzimet në strukturën e kostos 2025, nga të gjitha zërat e shpenzimeve janë grupuar për efekt të ndarjes sipas zërave buxhetorë, shpenzimet për

personelin në mbledhjen, grumbullimin, transportin, fshirjen dhe larjen, dhe paraqiten në tabelën e grafikun e mëposhtëm:

| Struktura e kostos se sherbimit te pastrimit | % | Leke ne vit |
|---|---|---|
| Mirëmbajtje | 2% | 600,000 |
| Grumbullim | 8% | 2,021,760 |
| Transport | 15% | 3,669,120 |
| Personeli | 35% | 8,568,990 |
| Amortizimi | 2% | 525,000 |
| Investime | 0% | - |
| Fshirje | 1% | 160,120 |
| Larje, Dizifektim dhe Deritazim i kontenierve | 3% | 795,600 |
| Larje | 6% | 1,530,000 |
| Depozitimi | 26% | 6,320,990 |
| TOTALI | 100% | 24,191,580 |

*Tabela 43: Struktura e kostos së shërbimit*




*Grafiku 10: Struktura e kostos operacionale*

Siç edhe evidentohet, shpenzimet për personelin zënë pjesën më të madhe, në 37% të kostos. Kjo shpjegohet me mënyren e realizimit të shërbimit, manuale, pa paisje, mjete e teknologji të reja që reduktojnë nevojën për fuqi punëtore e ulin numrin e madh të tyre. Gjithashtu, kjo ka lidhje me mundësitë e pakta financiare të bashkisë dhe nivelin ekonomik të komunitetit.

### E.2 Kosto e viteve 2025-2029

Bazuar në normat për njësi të kostos së vitit 2025dhe disa shtesave të tjera u llogarit dhe kosto për periudhën 2025-2029

Planifikimi 5-Vjecare i Menaxhmit të Mbetjeve 2025-2029

*Tabela 44: Kosto e totale e shërbimit*

| KOSTO TOTALE E MENAXHMIT TE MBETJEVE | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| Kosto e mbledhjes se grumbullimit dhe transportimit te | 10,189,800 | 10,189,800 | 10,189,800 | 10,189,800 | 10,189,800 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **mbeturinave** | | | | | |
| **Kosto fshirje** | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 |
| **Kosto Lagie** | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 |
| **Kosto totale per larje dizifektim dhe deritazim i kontenierеve** | 795,600 | 795,600 | 795,600 | 795,600 | 795,600 |
| **Kosto totale mirembajtja e venddepozitimit** | 6,320,990 | 6,320,990 | 6,320,990 | 6,320,990 | 6,320,990 |
| **TOTALI** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** |
| **Koficenti I rritjes buxhetit** | 0.98 | 1.03 | 1.0 | 1.1 | 1.2 |
| **Te ardhura** | 21,780,000 | 22,748,000 | 22,748,000 | 23,232,000 | 23,474,000 |
| **Mbulimi kostos** | **90%** | **94%** | **94%** | **96%** | **97%** |

*Grafiku 11: Ndryshimi i kostos së shërbimeve 2020-2024*

Nëse do analizonim grafikun e mësipërm me strukturën e kostos së shërbimeve të pastrimit në vite, do vërejmë se është e njëjtë për 5- vitet e fundit. Nga viti 2025në vitin 2029 ka një rritje që në vitin 2029 është e njëjtë, e cila lidhet me koston e transportit për në inceneratorin e Elbasanit.

# V. PERSPEKTIVA FINANCIARE

## *5.1. Çështja e financimit dhe strategjia e "mbulimit të kostos"*

**Investimet kapitale**
Sipas vlerësimit paraprak të prezantuar më lart, investimet kapitale duhet të rriten në mënyrë progresive në 5 vitet e ardhshme sipas nevojave për përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të manaxhimit të mbetjeve. Investimet do të kërkohen të mbulohen nga burimet financiare vendore (nga të ardhurat e vetë bashkisë) të kombinuara me programet e huaja të donatorëve që janë të pranishëm në rajon për pajisje dhe makineri, si dhe nga burimet kombëtare, nga donatorët e huaj dhe bankat e zhvillimit, sektori privat apo kombinimi i tyre për investimet e tjera.

**Strategjia e mbulimit të kostos dhe niveli i tarifave**
Sipas legjislacionit ekzistues, autoritetet vendore kanë përgjegjësinë të kontrollojnë caktimin dhe përshtatjen e tarifave të mbetjeve në përputhje me politikat e tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak dhe të bazuara në principet e mëposhtme:

- Parimi "ndotësi paguan"
- Rakordimi me buxhetin vjetor
- Prioritetet lokale dhe politike
- Mundësia e pagesës

Shqyrtimi paraprak i strukturës aktuale financiare të sektorit të manaxhimit të mbetjeve në Bashki tregon se ajo nuk ka një performancë të mirë në realizimin e të ardhurave nga tarifa e pastrimit duke mbuluar deri 29% të shpenzimeve aktuale për shërbimet e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, por edhe buxheti aktual është i pamjaftueshëm për modernizimin e shërbimeve të pastrimit dhe përmbushjen e standarteve kombëtare për depozitimin mjedisor të mbetjeve.

Gjithashtu vihet re dhe një planifikim me rezerva i të ardhurave. Në vitin 2018 të ardhurat vendore realizohen 80.9%, ndërkohë që nga ky vit, baza e tatueshme për tarifën e pastrimit me është rritur me 200%, por niveli i tarifës së pastrimit prej 200 lekë/vit për familjet është planifikuar të rritet me 400 lekë/vit për familjet.

Baza e përmirësimit të mëtejshëm të sistemit aktual të tarifave dhe të të ardhurave nga mbetjet duhet të mbështet në parimin "*ndotësi paguan*" apo mbi "*përgjegjësia e prodhuesit të mbetjeve*" si dhe në elasticitetin e sistemit në mbështetje të iniciativave për minimizimin e mbetjeve. Qëllimi i bashkisë është të zbatojë sistemin e mbulimit të kostos që lidhet me objektivat e saj. Prandaj, nëse bashkia synon të përmbushë objektivin menjëherë, plani rekomandon rritjen e nivelit të tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, kostos së mirëmbajtjes dhe amortizimit si dhe duke përdorur subvencione apo të ardhura të tjera të bashkisë për të mbështetur kostot administrative.
Ngritja e strategjisë për mbulimin e kostos fillon nga llogaritja totale e kostos, ku të gjitha kostot që lidhen me komponentët e sistemit të administrimit të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme evidentohen dhe përmblidhen në tabelën e mëposhtme.

| KOSTO TOTALE E MENAXHMIT TE MBETJEVE | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| Kosto e mbledhjes se grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave | 10,189,800 | 10,189,800 | 10,189,800 | 10,189,800 | 10,189,800 |
| Kosto fshirje | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 | 5,067,640 |
| Kosto Lagie | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 | 1,817,550 |
| Kosto totale per larje dizifektim dhe deritazim i kontenieреve | 795,600 | 795,600 | 795,600 | 795,600 | 795,600 |
| Kosto totale mirembajtja e venddepozitimit | 6,320,990 | 6,320,990 | 6,320,990 | 6,320,990 | 6,320,990 |
| **TOTALI KOSTOS SHERBIMIT** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** |
| INVESTIME | - | | - | - | - |
| **TOTALI KOSTOS SE MENAXHMIT MBETJEVE** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** | **24,191,580** |
| TE ARDHURA | 21,780,000 | 22,748,000 | 22,748,000 | 23,232,000 | 23,474,000 |
| **KOEFIÇENTI MBULIMIT KOSTOS SHERBIMIT (*PA INVESTIME*)** | **90%** | **94%** | **94%** | **96%** | **97%** |

*Tabela 46: Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2024-2029*[10]

***Politika vendore dhe planifikimi i mbetjeve***

Mbledhja e mbetjeve urbane, pastrimi i rrugëve, etj, konsiderohen shërbime publike në shërbim të të gjithë qytetit nga i cili është e vështirë të përjashtojmë pa krijuar probleme urbane, mjedisore, por njëkohësisht është një shërbim me kosto të konsiderueshme për të cilën të gjithë që përfitojnë duhet të paguajnë.

Për të mundësuar një parashikim dhe strategji reale të llogaritjes së të ardhurave për periudhën 5-vjeçare, rekomandohet që bashkia të marrë në konsideratë faktorë të tjerë socialë[11] (si psh. pamundësia e disa familjeve për të paguar), apo eksperienca nga bashki të tjera që do ta ndihmojnë bashkinë të orientojë veprimet dhe strategjitë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit fiskal të mbetjeve. Tabela e mëposhtme paraqet se si janë marr në konsideratë dhe kanë ndryshuar këta faktorë shoqërorë, si dhe performancën e bashkisë në vjeljen e tarifave dhe në parashikimin e të ardhurave për vitet e ardhshme.

[10] Skenari i grumbullimit dhe transportit miks të mbetjeve dhe përdorimi i venddepozitimit të Krastes deri në vitin 2024.

*Tabela 47: Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave*

| | TABELA ANALITIKE E TARIFES SE PASTRIMIT 2025-2029 | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Tarifa e sherbimeve publike sipas Paketes fiskale** | **2025** | | | **2026** | | | **2027** | | | **2028** | | | **2029** | | |
| | | **Baza e tatueshme** | **Tarifa miratuar** | **Vlera e planifikuar lek/vit** | **Baza e tatueshme** | **Tarifa miratuar** | **Vlera e planifikuar lek/vit** | **Baza e tatueshme** | **Tarifa miratuar** | **Vlera e planifikuar lek/vit** | **Baza e tatueshme** | **Tarifa miratuar** | **Vlera e planifikuar lek/vit** | **Baza e tatueshme** | **Tarifa miratuar** | **Vlera e planifikuar lek/vit** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5=3*4** | **6** | **7** | **8=6*7** | **9** | **10** | **11=9*10** | **12** | **13** | **14=12*13** | **12** | **13** | **14=12*13** |
| **1** | Tarifa familjare: | | | 11,620,000 | | | 12,370,000 | | | 12,370,000 | | | 11995000 | | | 12,370,000 |
| **a)** | a) Tarifa per familjet e Bashkise Prrenjas | 7,500 | 500 | 3,750,000 | 7,500 | 600 | 4,500,000 | 7,500 | 600 | 4,500,000 | 7,500 | 600 | 4500000 | 7,500 | 600 | 4,500,000 |
| **b)** | b) Tarifa per familje Nj.Rrajce Fshati Rrajce ,Katjel, Kotodesh dhe Urake, Sutaj, Bardhaj, 6 Lis | 7340 | 500 | 3,670,000 | 7340 | 500 | 3,670,000 | 7340 | 500 | 3,670,000 | 7,340 | 500 | 3670000 | 7,340 | 500 | 3,670,000 |
| **c)** | c) Tarifa per familje NJA Qukes,fshati Qukes Qender, Shkumbin, Q.Sken derbej,Fanje ,B erzeshte,Karkavec, Dritaj, Pishkash Qender, Pishkash Veri , Skroske | 7650 | 500 | 3,825,000 | 7650 | 500 | 3,825,000 | 7650 | 500 | 3,825,000 | 7650 | 500 | 3825000 | 7650 | 500 | 3,825,000 |
| **d)** | c) Tarifa per familje NJA Stravaj,fshati Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponje, Sopot, Sharre | 750 | 500 | 375,000 | 750 | 500 | 375,000 | 750 | 500 | 375,000 | 750 | 500 | 375000 | 750 | 500 | 375,000 |
| | **Totali familjeve taksapaguese (pastrim per fryme)** | **23,240** | | **11,620,000** | **23,240** | | **12,370,000** | **23,240** | | **12,370,000** | **23,240** | | **12,370,000** | **23,240** | | **12,370,000** |
| **1** | Tarife institucione shteterore | 3 | 90,000 | 270,000 | 3 | 100,000 | 300,000 | 3 | 100,000 | 300,000 | 3 | 100,000 | 300,000 | 3 | 100,000 | 300,000 |
| **2** | Tarife per cdo njesi, dyqan mish,mallra,konsumi,njesi sherbimi etj. | 195 | 8,000 | 1,560,000 | 195 | 8,000 | 1,560,000 | 195 | 8,000 | 1,560,000 | 195 | 8,000 | 1560000 | 200 | 9,000 | 1,800,000 |
| **3** | PROFESIONE TE LIRA (Avokat,noter,arkitekt, inxhinier, topograf ,projektue s, ekonomist, agronom, ekspert kontabel i rregjistruar,kurse kualifikimi, | 4 | 8,000 | 32,000 | 4 | 8,000 | 32,000 | 4 | 8,000 | 32,000 | 4 | 8,000 | 32000 | 4 | 9,000 | 36,000 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontabilist,ndryshuar sipas ligjit dhe vleresues i miratuar i pasurise). | | | | | | | | | | | | | | | |
| **4** | Tarife per cdo bar kafe e te ngjashme,etj. | 83 | 9,000 | 747,000 | 83 | 9,000 | 747,000 | 83 | 9,000 | 747,000 | 83 | 10,000 | 830000 | 83 | 10,000 | 830,000 |
| **5** | Tarife per cdo Bar-Restorant | 22 | 12,000 | 264,000 | 22 | 12,000 | 264,000 | 22 | 12,000 | 264,000 | 22 | 12,000 | 264000 | 22 | 12,000 | 264,000 |
| **6** | Klinike Dentare, Farmaci | 12 | 12,000 | 144,000 | 12 | 12,000 | 144,000 | 12 | 12,000 | 144,000 | 12 | 15,000 | 180000 | 12 | 15,000 | 180,000 |
| **7** | Bime medicinale, Fizioterapist, Mjek i specializuar, Farmaci veterinare | 4 | 9,000 | 36,000 | 4 | 9,000 | 36,000 | 4 | 9,000 | 36,000 | 4 | 10,000 | 40000 | 4 | 10,000 | 40,000 |
| **8** | Tarife sherbime, riparime, perpunim,materiale ndertimi | 64 | 12,000 | 768,000 | 64 | 12,000 | 768,000 | 64 | 12,000 | 768,000 | 64 | 15,000 | 960000 | 64 | 15,000 | 960,000 |
| **9** | Njesi Fondacioni ,Banka | 4 | 90,000 | 360,000 | 4 | 100,000 | 400,000 | 4 | 100,000 | 400,000 | 4 | 100,000 | 400000 | 4 | 100,000 | 400,000 |
| **10** | Lavazhe, bazene peshku | 18 | 12,000 | 216,000 | 18 | 12,000 | 216,000 | 18 | 12,000 | 216,000 | 18 | 15,000 | 270000 | 18 | 15,000 | 270,000 |
| **11** | Tarife per shoqerite e sigurimit, transferta parash,sherbime optike, kabllor internet etj, te ngjashme me to | 10 | 60,000 | 600,000 | 10 | 75,000 | 750,000 | 10 | 75,000 | 750,000 | 10 | 75,000 | 750000 | 10 | 75,000 | 750,000 |
| **12** | Subjekte ndertimi ,fabrika perpunimi dhe prodhimi | 2 | 120,000 | 240,000 | 2 | 120,000 | 240,000 | 2 | 120,000 | 240,000 | 2 | 120,000 | 240000 | 2 | 130,000 | 260,000 |
| **13** | Tarife per cdo njesi gurore, hece, shfrytezim pyjesh | 25 | 120,000 | 3,000,000 | 25 | 120,000 | 3,000,000 | 25 | 120,000 | 3,000,000 | 25 | 120,000 | 3000000 | 25 | 120,000 | 3,000,000 |
| **14** | Pike Karburanti | 4 | 120,000 | 480,000 | 4 | 120,000 | 480,000 | 4 | 120,000 | 480,000 | 4 | 120,000 | 480000 | 4 | 120,000 | 480,000 |
| **15** | Tarife per cdo njesi supermarket, Shitje me shumice dhe pakice artikuj industrial , Materiale ndertimi, Hotel Restaurant, | 21 | 100,000 | 2,100,000 | 21 | 100,000 | 2,100,000 | 21 | 100,000 | 2,100,000 | 21 | 100,000 | 2100000 | 21 | 100,000 | 2,100,000 |
| **16** | Tarife per subjekte me nipt sekondar dhe te ngjashme me to | 19 | 60,000 | 1,140,000 | 19 | 75,000 | 1,425,000 | 19 | 75,000 | 1,425,000 | 19 | 80,000 | 1520000 | 19 | 80,000 | 1,520,000 |
| **17** | Tarife per cdo tregtar ambulant | 10 | 7000 | 70,000 | 10 | 7000 | 70,000 | 10 | 7000 | 70,000 | 12 | 7000 | 84000 | 12 | 8000 | 96,000 |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Totali i biznese taksapagues** | **500** | | **12,027,000** | **500** | | **12,532,000** | **500** | | **12,532,000** | **502** | | **13,010,000** | **507** | | **13,286,000** |
| | **TOTALI nga 1 deri ne 17** | | | 23,647,000 | | | 24,902,000 | | | 24,902,000 | | | 25,380,000 | 23,747 | 0 | 25,656,000 |

Për të vlerësuar efektivitetin e sistemit drejt arritjes së objektivave të mbulimit të kostos, të ardhurat e planifikuara për secilin konsumator përmblidhen së bashku dhe krahasohen me koston totale operative kapitale. Në rastin tonë, përqindjet e mbulimit të kostos për vitet në vazhdim paraqitet e lartë dhe në progres drejt mbulimit me 105 % në vitin 2029. Por duhet theksuar se plani rekomandon rritjen e nivelit të realizimit të të ardhurave nga tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, kostos së mirëmbajtjes si dhe duke përdorur subvencione apo të ardhura të tjera të bashkisë për të mbështetur kostot administrative.

| KOSTO TOTALE E MENAXHMIT TE MBETJEVE | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| **TOTALI KOSTOS SHERBIMIT** | **24,200,000** | **24,200,000** | **24,200,000** | **24,200,000** | **24,200,000** |
| **TE ARDHURA** | 21,780,000 | 22,748,000 | 22,748,000 | 23,232,000 | 23,474,000 |
| **KOEFIÇENTI MBULIMIT KOSTOS** | **90%** | **94%** | **94%** | **96%** | **97%** |

*Tabela 48: Koeficineti i mbulimit të kostos 2025-2029*

## VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

### *6.1 Rregullorja vendore*

Në plotësim të kuadrit ligjor të administrimit të mbetjeve, Bashkia Prrenjas duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren e vet lokale, ku të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, për të siguruar administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të vet administrativ.

Ky dokument duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve dhe pastrimin e qytetit duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Rregullorja duhet të jetë në përputhje me pjesën më të madhe të Direktivave të BE për Mbetjet dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.
Qëllimi i rregullores është mbajtja pastër dhe sigurimi i një mjedisi të shëndetshëm për banorët e bashkisë.

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja do të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

**a) Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, procedurat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;**

**b) Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve, si:**

- Të mos dëmtohen kontenierët, të mos ndryshohet destinacionit i tyre, të mos dëmtohet dhe ndryshohet destinacionit i pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të mos depozitohen mbetjet, të mos digjen mbetjet në kazanë, të mos hidhen mbetjet në rrymat ujore dhe kanalizimet, të mos hidhen mbetjet në territore publike;
- Të shmanget dhe parandalohet hedhja abuzive e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, të mos depozitohen kafshët e ngordhura dhe materialet helmuese;
- Të shmanget parkimi i automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të pastrohet hapësira rreth dyqaneve dhe pikave ambulatore të shitjes; të mbahet higjienë dhe të dezinfektohen kontenierët dhe koshat e hedhurinave;
- Të paguhen taksat dhe tarifat vendore për mbetjet;
- Çështje të tjera të shëndetit publik.

**c) Të drejtat dhe detyrimet e administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve) si:**

- Proçedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
- Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Mbajtja e të dhënave për mbetjet;
- Parandalimi i problemeve për shëndetin publik;
- Çështje të tjera të shëndetit publik, të tilla si procedurat e shëndetit, sigurisë dhe urgjencës;

Synimi i rregullores duhet të përfshijë të gjitha institucionet qendrore e lokale me seli në territorin e bashkisë, të gjithë individët, të gjithë operatorët publikë e privatë, vendas e të huaj të angazhuar në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve urbane (grumbullimi, depozitimi, transportimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe asgjësimi). Rregullorja duhet të përfshijë edhe një seksion për marrëdhëniet me publikun, aktivitetet e ndaluara, sanksionet dhe masat ndëshkimore.

Një nga rregullat synuese më të rëndësishme që duhet përcaktuar në rregullore është grumbullimi i diferencuar dhe trajtimi i mbetjeve në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre, si edhe ndalimi i përzierjes së tyre me mbetjet e rrezikshme.

### *6.2 Detyrimi dhe sanksionet*

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve duhet të parashikojë dhe sanksionojë një listë sa më gjithëpërfshirëse ndalimesh dhe detyrimesh. Në këtë listë mund të përfshihen ndalimet dhe detyrimet si më poshtë:

- është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin e bashkisë, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurta, gjysëm e ngurta, e lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensioni, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjt, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve, etj.
- është e ndaluar dorëzimi i mbeturinave në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.
- cilido shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryej largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese, operacionet e nevojshme dhe

afatet brenda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar;

- është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;
- është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit;
- është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve voluminoze që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensioni, përbërja dhe karakteristika të tjera që mund t'i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin;
- është e detyrueshme për të gjithë llojet e prodhuesve dhe mbajtësve të mbetjeve urbane, objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rekuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto materiale në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respektive;
- është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdoruara për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo pëmbysja,
- janë të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes;
- është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti, shishe dhe të ngjashme);
- është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;
- është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit të mbetjeve speciale për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme;
- djegia e mbeturinave në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambjent tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.
- ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre.
- nuk pranohet e drejta për kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e bashkisë.

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve të shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksione që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin "ndotësi paguan" ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijojë një sistem të drejtë dhe të shkurajojë dhe parandalojë ndotësit.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo

juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve lokale (Neni 61, 62 i Ligjit për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve), sipas rregullores së ardhshme të administrimit të mbetjeve dhe listës së gjobave dhe shkeljeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

### *6.3 Licencimi Mjedisor*

Një element i domosdoshëm i menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipëri, në të ardhmen, është përputhshmëria me ligjin. Legjislacioni Shqiptar mbi mbetjet vjen kryesisht nga Direktivat e Bashkimit Evropian – Kuadri Udhëzues për mbetjet i vitit 2008 dhe direktiva të tjera të ndryshme përfshirë, në veçanti Direktivën e Landfilleve të vitit 1999.

Çështjet që duhen patur parasysh lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Prrenjas përfshijnë (lista nuk është shteruese): Kontrollin e Ndikimeve Mjedisore të Menaxhimit të Mbetjeve, Planifikimin e Përdorimit të Tokës, Zhvillimin e Tregut të Riciklimit, etj.

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

(i) Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me DRM (Drejtorinë Rajonale të Mjedisit) kur japim miratime për aktivitete që ushtrojnë veprimtari apo projekte për administrimin e mbetjeve (Neni 25 i ligjit për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta)

(ii) Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme)

(iii) Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.

(iv) Të shikohet mundësia për një mekanizëm kontrolli jo vetëm për shërbimin e pastrimit nga vetë Bashkia, por edhe nga të tretë (audituesë të pavarur) apo dhe kur të bëhen vlerësime për ndonjë vendepozitim lokal, apo rehabilitim hotspoti.

(v) Të stimulohen bizneset për t'u certifikuar me standartet e sistemeve të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 të cilat do të rrisin pjesëmarrjen e bizneseve në zinxhirin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

### *6.4 Pjesëmarrja e Sektorit Privat*

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze apo mbetjeve të riciklueshme, duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve.

Duke iu referuar eksperiencës ndërkombëtare dhe në disa raste kombëtare, ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, ku disa prej tyre mund të jenë:

- sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, atëherë dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve;
- i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standarteve operative dhe teknike, etj.

Duke dashur të punësojë qytetarët e saj dhe të zgjidhë problemin social të papunësisë por edhe të arrijë përfitimet maksimale nga përfshirja e sektorit privat në aktivitetet e manaxhimit të mbetjeve, bashkia duhet të ketë në vëmendje rekomandimet e mëposhtme:

a. ***Konkurrenca:*** Duhet të sigurojë një konkurrencë të vërtetë mes kompanive të sektorit privat dhe madje, nëse është e mundur, midis kompanive private dhe ndërmarrjeve publike të komercializuara që operojnë në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane.
b. ***Kërkesa e llogarisë***: për të siguruar se kontrata funksionon: Me qëllim që kontrata me sektorin privat të japë përmirësimet e duhura dhe të matshme në efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimit, duhet të përmbushen një sërë kriteresh bazë:
    - Masat e mirë-përcaktuara të performancës;
    - Sanksione të zbatueshme për punën e dobët;
    - Monitorim vigjilent dhe
    - Kërkesa e llogarisë për kostot.
c. ***Transparenca***: Marrëveshjet financiare dhe marrja e vendimeve duhet të jenë transparente. Arsyet për vendimet, veçanërisht për zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve nga sektori privat, si dhe administrimi i fondeve publike duhet të jenë të hapura për publikun;
d. ***Kohëzgjatja e duhur e marrëveshjes dhe ofrimi i pajisjeve:*** kontratat që përfshijnë edhe investime në makineri duhet të kenë të paktën një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, ndërsa investimet në prona të patundshme kërkojnë të paktën një kohëzgjatje prej 10 vjetësh për marrëveshjet dhe kontratat.

### *6.5 Mbështetja Politike*

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve paraqet sfida reale për të gjitha palët e interesuara për të mbajtur një qasje të koordinuar të menaxhimit të tranzicionit drejt një sistemi modern të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Prrenjas. Në këtë kuadër do të jetë thelbësor komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet palëve të interesuara dhe një mënyrë efektive për të vijuar progresin e zbatimit të PVMMU.

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për banorët e bashkisë dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të

arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori ashtu si masat për përmirësimin e buxhetit, investimet dhe përmirësimin e paketës fiskale, nga ana tjetër bashkia duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj këshillit dhe publikut. Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit.

Bashkia në bashkëpunim me kompaninë e pastrimit duhet të përcaktojë dhe publikojë grafikun për pastrimin e qytetit (çdo ditë, herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje), dhe grafikun për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve (gjatë ditës).

Me ndryshimet administrative të territorit, shtrirjen e shërbimit përtej qytetit duhet të rishikohet struktura që të sigurojë një shërbim sa më cilësor. Kjo përfshin një strukturë vertikale më të mirë dhe vendosjen e rregulloreve të duhura. Për të siguruar një angazhim të plotë dhe për të mundësuar shërbimin e kërkuar, është e nevojshme një përshkrim më i mirë i punës ose të paktën një ndarje më e mirë e punës për stafin ekzistues.

Për këtë arsye, janë parashikuar dy drejtime kryesore:
1. Struktura e menaxhimit
2. Rregullore lokale për menaxhimin e mbetjeve

Objektivi kryesor i ketij sektori do të jetë:

- mbulimi me shërbimin e pastrimit të të gjithë territorit,
- mbulimin 99% të kostos nga tarifa, dhe
- monitorimin e vazhdueshëm të PVMMU.

## VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Nëse duam që PVMMU të funksionojë dhe zbatohet me sukses në Prrenjas, është mjaft e rëndësishme që publiku ta kuptojë dhe mbështesë atë në çdo hallkë të tij. Po ashtu, suksesi i skemave që propozohen, nismave që do të ndërmerren varen tërësisht nga shkalla e angazhimit nga vetë përdoruesit si: familjarët, bizneset, etj.

Menaxhimi i mbetjeve është sa problem teknik dhe kërkon organizim të mirë dhe përdorim të teknologjive moderne, por është dhe problem komunikimi me zbatuesit e saj, qofshin këta banorë, biznese apo institucione publike. Ndërsa incentivat ligjore dhe ato ekonomike mund të ndryshojnë sjelljen e qytetarëve, krijimi i ndërgjegjes së duhur të publikut dhe dëshira për të menaxhuar sa më mirë mbetjet është po aq e rëndësishme.

Promovimi i ndërgjegjësimit publik mbi problemet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, dhe inkurajimi i individëve dhe komuniteteve për të marrë më tepër përgjegjësi për mbetjet që ata vetë prodhojnë, është një aspekt i rëndësishëm i informimit qytetar por edhe i mirë artikuluar nga vetë bashkia në Vizionin e PVMMU. Ndaj bashkia duhet të fokusohet në:

I. **Informimin e publikut mbi shërbimin e ri të menaxhimit të mbetjeve** – duke i mundësuar publikut të bashkëpunojë në mënyrë konstruktive me një skemë të re. Publiku duhet të njoftohet mbi vendet e përcaktuara si PGM, oraret e zbrazjes së kontenierëve, frekuencën e tërheqjes së mbetjeve, standartin e shërbimit të pastrimit. Informacioni duhet të komunikohet në mënyrë të qartë për t'i mundësuar ata të koordinohen me rregullat e shërbimit dhe t'u tregohen dhe mjetet që do të përdoren për mbledhjen e mendimeve dhe ankesave të tyre. Ky proçes duhet të përfshijë gjithashtu edhe informacion mbi rregulloren, penalitetet dhe sanksionet, strategjinë e mbulimit të kostos dhe nivelin e tarifës, mbi mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

II. **Rritja e ndërgjësimit ndaj praktikave të mira në menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane** – duke nisur nga identifikimi i grupeve të interesit dhe hartimi së bashku me to i programeve për zbatimin e skemave të ndarjes në burim të mbetjeve, riciklimit, apo kompostimit. Në grupet e interesit duhet të përfshihen familjet, bizneset, institucionet, grupet në nevojë, të rinjtë dhe fëmijët si pjesë e grupeve të fokusuara të cilat do të përfitojnë nga shërbimi i pastrimit. Ata do të marrin një rol të rëndësishëm në promovimin, kryerjen dhe zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit publik.

III. **Edukimi i brezit të ri** përmes një programi të detajuar edukues brenda dhe jashtë ambjenteve të shkollës për të rritur njohuritë e tyre mbi shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe për të inkurajuar minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin.

Praktikat apo aksionet konkrete të pastrimit janë një metodë shumë e mirë edukimi duke bashkëpunuar me grupet rinore apo dhe me stafet pedagogjike të shkollave.

IV. **Forcimi dhe rritja e përfshirjes publike dhe biznesit** – duke rritur bashkëpunimin me grupe të ndryshme interesi në sigurimin e mbështetjes publike për iniciativat e menaxhimit të mbetjeve, alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin, mobilizimin e publikut dhe grupeve të tjera të interesit në mbështetjen e zbatimit të tyre, futjen e pagesës së rregullt të tarifës duke vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë e tyre për të paguar.

**Metodat që mund të përdoren**

Bashkia Prrenjas duhet të diversifikojë sa më shumë mjetet e komunikimit që edhe qytetarët të kuptojnë sfidat dhe ecurinë e bashkisë në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe në të gjithë territorin. Synimi i fushatave duhet të jetë ofrimi i informacionit të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së qytetit, rritja e ndërgjegjësimit qytetar për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore dhe nxitja e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta me qarkullim kombëtar dhe rajonal, njoftimet, tabelat informuese dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Duhet të përdoren materiale komunikimi për të ndihmuar banorët të kuptojnë sfidat për administrimin e mbetjeve të komunitetit si dhe përparimin për trajtimin e këtyre sfidave. Po ashtu tabelat e informimit mund të përdoren për dhënien e mesazheve ndërgjegjësues, informative dhe kontakteve për informim të mëtejshëm apo ankesa. Nga bashkia mund të shpërndahet falas një broshurë me orientime për përdorimin e kontenierëve dhe vendndodhjen e tyre; orientime mbi fraksionet që grumbullohen, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndryshme sipas fraksioneve, detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve, nevojat dhe pretendimet e bashkëpunimit të qytetarëve, etj.

Metoda e komunikimit *derë më derë* rekomandohet si mjaft efektive për të ftuar qytetarët të bëhen pjesë e nismave të ndryshme, sic është ajo e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret por edhe të mbështesin bashkinë në zbatimin e skemave të përzgjedhura. Banorëve dhe bizneseve duhet t'u shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, për metodologjinë e kompostimit, etj.

*Të përdoren kamionët dhe kontenierët për informim:* Tek të gjithë kamionët dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme (me germa të paktën 10 cm të mëdha) parrulla "Mbani pastër qytetin tuaj " apo ndonjë parullë tjetër.

Në mënyrë periodike mund të kryhet një reklamim në masë të gjërë, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasiore të arritura gjatë viteve paraardhës, në veçanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesmarrjen aktive të publikut në këtë proces.

**Mekanizmat e marrjes së mendimit dhe reagimit qytetar –** Autoritetet lokale kanë identifikuar ndërgjegjen e ulët qytetare një nga faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në pastërtinë e qytetit dhe më konkretisht në papastërtinë e disa PGM, (hedhjen pa kriter të mbetjeve urbane dhe voluminoze jashte kontenierëve) si dhe ekzistencën e pikave informale ku hidhen pa kriter mbetje. Për këtë qëllim, ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve.

Bashkia duhet që përmes njoftimeve publike të ftojë qytetarët të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak edhe kur diskutohen çështje të menaxhimit të mbetjeve. Institucionalizimi i një mekanizmi të tillë do të rrisë besimin tek banorët se bashkia i merr parasysh mendimet, idetë dhe sugjerimet e tyre. Kjo realizohet duke ngritur zyrën e informacionit për të mundësuar marrjen e mendimit nëpërmjet:

- Mbledhjes së ankesave të qytetarëve.
- Sondazheve të herëpashershme si një mjet i mirë monitorimi të shërbimit dhe standarteve që ai ofron. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 150 dhe 200 të intervistuar.

## VIII. PLANI I AKTIVITETEVE

**VIZIONI**: "BASHKIA PRRENJAS PËR NJË MJEDIS TË PASTËR ME CILËSI TË LARTË DHE KONTRIBUT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE,DUKE SYNUAR MINIMIZIMIN E MBETJEVE,RUAJTJEN E BURIMEVE NATYRORE DHE PËR NJË JETESË TË SHËNDETSHME!"

| Objektivi Strategjik | Objektivi | Aktivitete | Rolet Përgjegjëse | Aktorët mbështetës | Afatet Kohore | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **I. Infrastruktura dhe Mjedisi** | **1.1 Përmirësimi i shërbimit të MM duke përdorur teknologji bashkëkohore** | 1.1.1 Investim në përmirësimin e sistemit të grumbullimit të mbetjeve në Bashkinë Prrenjas(shtimi i sipërfaqes së grumbullimit) | Bashkia Prrenjas | Bashki te Forta | 5 vjet | Nuk eshte percaktuar akoma lekë/vit |
| | **1.2 Ofrimi i shërbimit cilësor,në kohë dhe në të gjithë territorin** | 1.2.1 Konsultim me publikun i PVMMU(Ndërgjegjësimi) | Bashkia Prrenjas | GP i PVMMU,DSHP, MiA,OSHC | Cdo vit/5 vjet | Pa kosto |
| | | 1.2.2 Miratimi i PVMMU | Këshilli Bashkiak | Kryetari Bashkisë,GP i PVMMU,MiA | Maj 2024 | Pa kosto |
| | | 1.2.3 Krijimi i një ekipi zbatimi dhe monitorimi të PVMMU | Kryetari i Bashkisë,Përgjegjësi i shërbimit publik | GP i PVMMU,MiA | Afat shkurtër | Pa kosto |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.2.4 Hartimi i një skeme funksionale të shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane në inceneratorin e Elbasanit | MiA,Përgjegjësi i Shërbimit Publik,Grupi i punës | Kryetari i Bashkisë,MiA | Afat shkurtër | Pa kosto |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **1.3 Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit** | 1.3.1 Mbyllja dhe rehabilitimi i vend-depozitimit aktual | Ekipi i zbatimit | Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak | 2025 | Planifikim në buxhet(Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) |
| | | 1.3.3 Transportimi i mbetjeve në incinerator. | Bashkia Prrenjas | Drejtoria e shërbimeve | 5 vjet | Buxheti Bashkisë |
| | **1.4 Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim** | 1.4.1 Projekte pilot për ndarjen e mbetjeve në burim dhe nxitjen e riciklimit | Ekipi i zbatimit | Kryetari i Bashkisë,Biznes e Private,Donatorë. | 2025 | Buxheti Bashkisë |
| | | 1.4.2 Nisma kompostimi të shoqëruara me trainime teknologjike | Ekipi i zbatimit | Kryetari i Bashkisë,Biznes e Private,Donatorë. | 2025 | Planifikim në buxhet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **II. Forcimi institucional** | **2.1 Forcimi i kapaciteteve të stafit për menaxhimin dhe monitorimin e mbetjeve** | 2.1.1 Trajnime të vazhdueshme për menaxhimin e mbetjeve (kuadri ligjor) | Kryetari i Bashkisë | Donatorë | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |
| | | 2.1.2 Hartimi i përshkrimit të punës së stafit që merret me menaxhimin e mbetjeve | Zyra e burimeve njerëzore,MiA | EZM | Afat shkurtër | Pa kosto |
| | **2.2 Forcimi i koordinimit rajonal për një menaxhim të integruar të mbetjeve** | 2.2.1 Takime periodike mes njësive administrative dhe institucioneve të tjera për koordinim më të mire të menaxhimit të mbetjeve | Ekipi i zbatimit | Kryetari Bashkisë | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |
| | | 2.2.2 Vizita studimore në Bashki të tjera për shkëmbim eksperiencash | Ekipi i zbatimit | Kryetari Bashkisë | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |
| | | 2.2.3 Bashkëpunim (Bashki-Institucione Shtetërore-Kombëtare-Ndërkombëtare-OJF-Grupe Interesi | Ekipi i zbatimit | Kryetari Bashkisë | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2.3 Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve** | 2.3.1 Hartimi i rregullores për menaxhimin e mbetjeve | GP I PVMMU | MiA | Afat shkurtër (Maj 2024) | Pa kosto |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.3.2 Hartimi i rregullores së Kosto-Tarifës | Drejtoria e te Ardhurave | GP I PVMMU | Afat shkurtër (Maj 2024) | Pa kosto |
| | | 2.3.3 Hartimi dhe zbatimi i një plani monitorimi për menaxhimin e mbetjeve | GP I PVMMU | Bashki te Forta ,MiA | Afat shkurtër | Pa kosto |
| **III. Ekonomia dhe financa** | **3.1 Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve (Arritja e mbledhjes së taksës së pastrimit gjatë periudhës 5 vjeçare në masën 80 % për të rritur të ardhurat)** | 3.1.1 Zbatimi i një sistemi për menaxhimin e klientit dhe të tarifës.Përditësimi i mëtejshëm i të dhënave dhe verifikim të tyre ,veçanërisht për familjet. Është e nevojshme që me zgjerimin e sistemit të përditësohen rregullisht të dhënat. | Bashkia Prrenjas | Drejtoria e të Ardhurave Drejtoria e Shërbimeve Publike | 2024-2029 | Pa kosto |
| | **3.2 Krijimi i një sistemi financiar të qëndrueshëm** | 3.2.1 Krijimi i një sistemi të ri të mbledhjes së tarifës | Ekipi i zbatimit , Drejtoria e Financës | Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak ,DTSHIP, | 2024-2029 | Pa kosto |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ndërmarrja e Ujësjellësit | | |
| **IV. Ndërgjegjësimi i komunitetit** | **4.1 Sensibilizimi i komunitetit dhe biznesit për tu bërë pjesë e iniciativave të bashkisë.** | 4.1.1 Hartimi i një programi për informimin e qytetarëve (materiale ndërgjegjësuese specifike sipas grupeve të synuara,oraret e grumbullimit të mbetjeve,tarifa e pastrimit,aktivitete,etj). | Ekipi i zbatimit | MiA dhe Bashki te Forta ,Do natorë,OSHC | 2025 | 500,000 |
| | | 4.1.2 Nisma të Bashkisë për ndarje të mbetjeve në burim.(shkollat,bizneset, komuniteti). | Ekipi i zbatimit | DSHP, Kryetari i Bashkisë,DAR | 2025 | Planifikim në buxhet |
| | | 4.1.3 Zhvillimi i orëve të edukimit mjedisor në shkolla. | Ekipi i zbatimit | DAR,Bashkia Prrenjas | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |
| | | 4.1.4 Organizimi i ditëve të pastrimit me pjesmarrjen e komunitetit. | Ekipi i zbatimit | DSHP, DAPKM | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |
| | **4.2 Rritja e transparences dhe e përgjegjshmërisë ndaj komuniteit.** | 4.2.1 Ftesë për komunitetin në takimet e këshillit Bashkiak | Ekipi i zbatimit | DSHP | Afat shkurtër | Pa kosto |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4.2.2Shmangia e hedhjes së mbetjeve në natyrë. Pastrimi,rehabilitimi dhe sinjalistika e nevojshme sidomos në zonat turistike . | Bashkia Prrenjas | Bashkia sëbashku me administratorët e njësive, kryepleqtë e fshatrave dhe qytetarët, Punonjësit e ADZM. | Cdo vit/5vjet | Planifikim në buxhet |
| | | 4.2.3 Hartimi i një raporti periodik për menaxhimin e mbetjeve. | Ekipi i zbatimit | DSHP, Drejtoria e Financave | Cdo vit/5vjet | Pa kosto |
| | | 4.2.4 Bërja publike në bill board,media sociale të raporteve,kontratave, rregulloreve,etj. | Ekipi i zbatimit | Bashkia Prrenjas, IT | Afat mesëm | Planifikim në buxhet |

## IX. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.

Është e rëndësishme të monitorohet progresi i PVMMU, efektiviteti i masave që janë marrë dhe të identifikohen nevojat e reja.

Në punën për zbatimin e PVMMU, Kryetari i Bashkisë dhe stafi i tij duhet të mbështeten nga komuniteti dhe aktorët e tjerë institucional.

Aktorët kryesor janë:

| **Aktori** | **Bashkia (DSHP)** | **Adminsitratorët** | **Firma kontraktuese** | **Qytetarët** |
|---|---|---|---|---|
| **Detyra** | Bën grumbullimin, përpunimin e informacionit, harton raporte dhe jep direktiva. Raporton tek kryetari i Bashkisë. | Lidhja kryesore me qytetaret. Njohje më e mirë e zonave të tyre. Raportojnë tek DSHP. | Mban raporte të detajuara dhe raporton tek DSHP. | Raportojnë/ankohen në NJA; Zyra me një ndalesë, Telefon/faqe internet e Bashkisë; |

*Tabela 49: Aktorët kryesor dhe përgjegjësitë e tyre*

Koordinator i pëgjithshëm për zbatimin e monitorimit duhet të jetë Drejtoria e shërbimeve publike. Ekipi do të fillojë të punojë menjeherë. Njerëzit e ngarkuar me këtë detyrë duhet të (i) kenë njohuritë e duhura në fushë për të realizuar monitorimin si dhe (ii) në numër të mjaftueshëm për të siguruar që janë matur të gjithë treguesit e monitorimit në të gjithë territorin, që janë përpunuar të dhënat dhe që në fund janë arritur konkluzionet. Ekipi i zbatimit duhet të siguroj informacion të saktë në lidhje me ecurinë e zbatimit të planit me të gjithë elementet e tij nëpërmjet:

- Organizimit të vizitave në terren gjatë orareve të punës sipas grafikut javor përgjatë gjithë vitit.
- Organizimit të takimeve të hapura me grupe qytetarësh.
- Monitorimit të dokumentacionit.

Detyra e parë e këtij ekipi do të jetë hartimi i planit të detajuar të monitorimit, i cili duhet të konsistojë në indikatorët e performancës që vijojnë:

- Indikatorët e performancës mjedisore
- Indikatorët financiarë
- Indikatorët administrative

.

Shkalla e hierarkisë





*Tabela 50 Skema e raportimit mbi monitorimin e shërbimit*

Grupi i punës në bazë të informacionit të mbledhur do të raportojë tek Kryetari i Bashkisë mbi ecurinë e planit çdo vit.

Në të njëjtën kohë, të gjitha palët e interest në menaxhimin e mbetjeve, do t'u ofrohen informacione të rregullta mbi zbatimin e planit dhe fletë informative mbi gjendjen e mjedisit, duke përfshirë edhe një raport vjetor.

***Detyrat e ekipit monitorues***

**Bashkia (Drejtoria e Shërbimeve Publike)**
• Përcakton prioritetet, termat e tenderit, planin e menaxhimit të mbetjeve
• Përcakton strategjinë e komunikimit mbi grumbullimin e mbetjeve, fshirjen dhe larjen e rrugëve
• Përcakton buxhetet, miraton faturat, përfshirë gjobat
• Blen materiale të reja (kazanë) dhe hap tenderat e rinj, nëse është e nevojshme
• Përcjell shqetësimet e këshillit/kryetarit/qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar
• Negocion me ndërmarrjen/kompaninë në rast mosmarrëveshjesh
• Raporton periodikisht (një herë në muaj) tek kryetari i bashkisë

**Administratori**

- Kontrollon çdo ditë (vetë ose nëpërmjet specialistëve) shërbimin e ofruar ndaj qytetarëve dhe raporton tek supervizori (cdo javë);
- Verifikon cilësinë dhe sasinë e shërbimit;
- Verifikon dhe përshtat nevojat për kazanë:
- Kur kazanët nuk mjaftojnë (kazanë të mbushur plot dhe mbetje në rrugë): propozon shtimin;
- Propozon të zhvendosë / të heqë ose të shtojë pika grumbullimi
- Identifikon nevojat e veçanta: p.sh. mbetje inerte për t'u mbledhur,
    - Jep informacion:
- ndërmarrjes menjëherë për çdo mangësi në cilësi / sasi:
- Kazanë të papastruar apo të dëmtuar rrugën, ditën dhe orën e vëzhgimit

Dy rolet e reja të propozuara si detyra për stafin e Drejtorisë së shërbimeve publike:

**Supervizori**
***Roli:*** Të kontrollojë respektimin e kontratës, verifikimin dhe çertifikimin e faturave dhe propozimin e pagesave të operatorit si dhe gjobat dhe penalitetet kur cilësia dhe sasia e punës nuk janë në termat e përcaktuara në kontratë. Ndërkohë po ky person duhet të organizojë aktivitetet e vlerësimit të shërbimit nga ana e qytetarëve dhe bizneseve, duke bërë të mundur monitorimin në plan të gjerë të këtij aktiviteti sensitiv.

***Punon:*** në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së shërbimeve publike. Përcakton prioritet dhe bën porosi për nevojat e veçanta që duhet të kryhen nga operatori (inerte, evente, zhvendosje të kontenierëve, etj.) në kuadër të buxhetit.

***Harton:*** statistikat dhe kontrollet e sasive. Verifikon dhe raporton të dhënat (mirëmbajtja e kontenierëve, oraret e grumbullimit, rrugët, km, punonjësit, etj.).

***Raporton*** në mënyre të përjavshme dhe të përmuajshme për bashkinë, duke u bazuar tek të dhënat nga njësitë administrative, dhe statistikat. Raportet do të përmbajnë por nuk do të kufizohen në informacionin si më poshtë:

- Sasitë e shërbimeve: kontrollin dhe miratimin e faturave

.

- Mungesa e cilësisë: mos mbledhja e kontenierëve, vendet e grumbullimit te pa pastruara, kazanët e dëmtuar, mbetjet e depozituara jashtë vend-depozitimit
- Propozime bashkisë për gjobat, kur është e nevojshme, duke u bazuar ne statistikat e mbledhura.
- Vendos reduktimin ose zhvendosjen e kontenierave dhe propozon rritje të numrit, nësë është e nevojshme.
- Zhvillon sondazhe dhe anketime me qytetarët dhe bizneset në lidhje me vlerësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe mbi këtë bazë propozon ndryshimet në strukturat përkatese.

**Specialisti i menaxhimit të mbetjeve:**
***Roli:*** Të personalizojë dhe krijojë sistemin e të dhënave të abonentëve që marrin shërbimin e pastrimit. Të llogarisë koston dhe të përcaktojë tarifën sipas modelit që do të bëhet i detyruar nga qeveria.

***Punon:*** në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së shërbimeve publike. Hedh në sistem të dhënat dhe përcakton prioritet.

***Përgatit:*** faturën e shërbimit; bën shpërndarjen e saj në baza vjetore (ose trimestrale) dhe realizon mbledhjen e saj

***Raporton***: në mënyrë të përmuajshme dhe një vjeçare për bashkinë informacion në lidhje me tarifën e mbledhur;

***Harton:*** propozime për shpenzime të veçanta, dhe ndihmon në përgatitjen e buxhetit vjetor për Bashkinë;

***Propozon*** për politika subvencionimi, kontrata paralele për 3R, analiza dhe sugjerime për të arritur objektivat e menaxhimit të mbetjeve në lidhje me kosto/tarifën, Shpenzime të veçanta jashtë buxhetit vjetor.

***Statistika të ofruara nga kompania***

Kontraktuesi duhet të mbajë statistika ditore në pikat kryesore dhe t'i raportojë ato çdo muaj, në formë elektronike apo në letër, tek mbikqyresi.

- ✓ Sasinë ditore të mbetjeve të grumbulluara dhe të depozituara në venddepozitim
- ✓ Numrin e kazanëve të pastruar
- ✓ Orët e sakta të grumbullimit: kohën e saktë të nisjes së kamionëve, kohën e zbrasjes në venddepozitim dhe kohën e kthimit në garazh
- ✓ Kilometrat ditore të çdo kamioni
- ✓ Numrin ditor dhe itinerarin e lëvizjes së kamionëve
- ✓ Listën ditore të pastrimit dhe të larjes së rrugëve
- ✓ Oraret ditore të larjes dhe të fshirjes manuale/ mekanike
- ✓ Listën e punonjësve dhe oraret ditore të punës

- ✓ Inventarin mujor të kazanëve, nga rruga në rrugë dhe gjendjen fizike të tyre
- ✓ Zhvendosjen, mbajtjen ose humbjen e kazanëve: kazanët e larë: listën e kazanëve me probleme (rrugën, numrin e kazanit), riparimet specifike, datën etj.
- ✓ Sasinë e mbetjeve të ricikluesshme të grumbulluar/përpunuar nga qendra (t) e grumbullimit
- ✓ Marrjen e komenteve/reagim ndaj kërkesave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve ose supervizorit rreth mungesës së cilësisë apo të sasisë së grumbulluar

**Kontrollori në venddepozitim**

- ✓ Raporton mbi aktivitetet në venddepozitim, kontrollon dhe mbledh informacione mbi sasinë e shërbimit
- ✓ Raporton për çdo kamion: ID-në e kamionit, orën, llojin e mbetjeve (nëse është e veçantë)
- ✓ Raporton orët e punës së makinerive (buldozerit)
- ✓ Raporton për ndonjë ngjarje të veçantë në venddepozitim: zjarr, aksident, etj. dhe kontrollon cilësinë e mbetjeve
- ✓ Informon supervizorin në rast mbetjesh ose kamionësh jo në përshtatje me atë çka është përcaktuar
- ✓ Siguron raporte javore për supervizorin

.

# SHTOJCA

***Inventari i rrjetit rrugor, Bashkia Prrenjas***

| Nr. | Emërimi i rrugës | Lloji i shtresës | Gjatësia (Km) | Gjerësia (m) |
|---|---|---|---|---|
| | **Bashkia Prrenjas** | | | |
| **1** | Rruga Blerimi | I asfaltuar | 0.38 | 6 |
| **2** | Rruga Qybra Sokoli | I asfaltuar | 0.48 | 5 |
| **3** | Rruga 10 Nentori | I asfaltuar | 0.16 | 6 |
| **4** | Rruga Rinia | I asfaltuar | 0.31 | 6 |
| **5** | Rruga Domozdova | I asfaltuar | 0.21 | 10 |
| **6** | Rruga Minatori | I asfaltuar | 0.36 | 6 |
| **7** | Rruga 1 Maji | I asfaltuar | 0.15 | 6 |
| **8** | Rruga Muhamet Kadia | I asfaltuar | 0.5 | 6 |
| **9** | Rruga Demokracia | I asfaltuar | 0.26 | 6 |
| **10** | Rruga Bogdani | - | 0.29 | 4 |
| **11** | Rruga Skenderbej | - | 0.27 | 4 |
| **12** | Rruga Bitumi | - | 0.71 | 4 |
| **13** | Rruga Ali hana | - | 0.56 | 4 |
| **14** | Rruga 5 Maji | I asfaltuar | 0.27 | 4 |
| **15** | Rruga 1 Qershori | I asfaltuar | 0.24 | 4 |
| **16** | Rruga Gjorgj Golemi | I asfaltuar | 0.32 | 6 |
| **17** | Rruga Dalip Tocka | - | 0.46 | 4 |
| **18** | Rruga Karriqi – Çentrali | - | 0.96 | 4 |
| **19** | Rruga Halit Berzeshta | I asfaltuar | 0.41 | 6 |
| **20** | Rruga Branica | - | 0.65 | 4 |
| **21** | Rruga Kukli | - | 0.58 | 4 |
| **22** | Rruga e Gabines | - | 0.28 | 4 |
| **23** | Rruga Kllogjeri | - | 0.41 | 4 |
| **24** | Rruga e Pusanikeve | I asfaltuar | 1.88 | 4 |
| **25** | Rruga  Prrenjes – Rashtan | I asfaltuar | 4.81 | 4 |
| **26** | Rruga Plize | - | 1.9 | 4 |
| **27** | **Shuma** | | **17.81** | |

| *Nr.* | *Emërimi i rrugës* | *Lloji i shtresës* | *Gjatësia (Km)* | *Gjerësia (m)* |
|---|---|---|---|---|
| | **Njësia Administrative Qukes** | | | |
| **1** | Rruga Gjymenga | - | 1.44 | 4 |
| **2** | Rruga Pishkash Veri | - | 1.93 | 4 |
| **3** | Rruga Komici | - | 1.43 | 4 |
| **4** | Rruga Xhel Ozuni | - | 0.5 | 4 |
| **5** | Rruga Belbes | - | 1.35 | 4 |
| **6** | Rruga Kompula | - | 1.91 | 4 |
| **7** | Rruga e Kales - Lapidari Skroske | I asfaltuar | 2.22 | 4 |
| **8** | Rruga Qukes Shkumbin | I asfaltuar | 1.81 | 4 |
| **9** | Rruga e Kales | - | 1.85 | 4 |
| **10** | Rruga e Alliut | - | 0.65 | 4 |
| **11** | Rruga Xixillasit | - | 0.6 | 4 |
| **12** | Rruga e Xhamise | - | 2.1 | 4 |
| **13** | Rruga Stacionit i Trenit | - | 1.21 | 4 |
| **14** | Rruga Cela | - | 1.65 | 4 |
| **15** | Rruga Skura | - | 1.47 | 4 |
| **16** | Rruga e Kopacit | - | 1.5 | 4 |
| **17** | Rruga Ozuni | - | 0.65 | 4 |
| **18** | Rruga e Nezhes | - | 2.87 | 4 |
| **19** | Rruga e Berzeshtes | I asfaltuar | 3.59 | 4 |
| **20** | Rruga e Gurres | - | 1.38 | 4 |
| **21** | Rruga Rrapi Berzeshtes | I asfaltuar | 1.71 | 4 |
| **22** | Rruga e Alles | - | 2 | 4 |
| **23** | Rruga e Osmerise | - | 1.51 | 4 |
| **24** | Rruga e Pocit | - | 1.93 | 4 |
| **25** | Rruga e Fanjes | - | 2.95 | 4 |
| **26** | Rruga e Kullollit | - | 1.54 | 4 |
| **27** | Rruga Gocit | - | 1.7 | 4 |
| **28** | Rruga Dheri Bardhe | - | 0.58 | 4 |
| **29** | Rruga e Memes | - | 1.22 | 4 |
| **30** | Rruga Kryemadhi | - | 1.63 | 4 |
| **31** | Rruga e Benos | - | 2.34 | 4 |
| **32** | Rruga e Sules | - | 1.45 | 4 |
| **33** | Rruga Kuriqi | - | 3.14 | 4 |
| **34** | Rruga Radici | - | 1.27 | 4 |
| **35** | Rruga Qukut | - | 1.44 | 4 |
| | **Shuma** | 5.4 | **58.52** | |


.

| Nr. | Emërimi i rrugës | Lloji i shtresës | Gjatësia (Km) | Gjerësia (m) |
|---|---|---|---|---|
| | **Njësia Administrative Rrajce** | | | |
| 1 | Rruga e Dardhes | - | 3.3 | 4 |
| 2 | Rruga e Kovanikut | - | 2.4 | 4 |
| 3 | Rruga Shkalla e Skenderbeut | - | 2.7 | 4 |
| 4 | Rruga e Damianit | - | 1.88 | 4 |
| 5 | Rruga Almeta | - | 0.8 | 4 |
| 6 | Rruga e Gurit te Bletes | - | 4.1 | 4 |
| 7 | Rruga Lagjja e Tarushit | - | 1.46 | 4 |
| 8 | Rruga Vorsh | - | 0.32 | 4 |
| 9 | Rruga Vorsh 1 | - | 0.27 | 4 |
| 10 | Rruga Kuvendi | - | 0.54 | 4 |
| 11 | Rruga Vellcani | - | 1.41 | 4 |
| 12 | Rruga Bregu i Males - Gjashte Lisat | - | 2.91 | 4 |
| 13 | Rruga e Re | - | 1.32 | 4 |
| 14 | Rruga Bregu i Males | I asfaltuar | 0.44 | 4 |
| 15 | Rruga Bregu i males - Lagjja e Hanollarve | - | 0.77 | 4 |
| 16 | Rruga e Madhe | - | 1.6 | 4 |
| 17 | Rruga Unaza e Rrajces - Lagjja e Tarushit | - | 0.34 | 4 |
| 18 | Rruga e Rires | - | 0.28 | 4 |
| 19 | Rruga Moni i Bardhe - Lagjja e Hallidrit | - | 0.9 | 4 |
| 20 | Rruga e Rrajces | I asfaltuar | 2.79 | 4 |
| 21 | Rruga Unaza e Rrajces | I asfaltuar | 1.98 | 4 |
| 22 | Rruga Hena | - | 0.59 | 4 |
| 23 | Rruga Bregu i Isufit | - | 0.85 | 4 |
| 24 | Rruga Rrezipe | - | 0.57 | 4 |
| 25 | Rruga e Çakos | - | 0.42 | 4 |
| 26 | Rruga Kuradese | - | 0.82 | 4 |
| 27 | Rruga Halili | - | 0.24 | 4 |
| 28 | Unaza e Balles | - | 0.57 | 4 |
| 29 | Rruga e Gjate | - | 1.97 | 4 |
| 30 | Lagje Balles | - | 0.46 | 4 |
| 31 | Rruga Unaza e Urakes | - | 0.91 | 4 |
| 32 | Rruga Urake | I asfaltuar | 0.13 | 4 |
| 33 | Rruga e Vreshtit | - | 0.86 | 4 |
| 34 | Rruga 24 Maji | - | 0.97 | 4 |
| 35 | Rruga e Dushkut | - | 0.26 | 4 |
| | | | | |
| 36 | Rruga e Mullirit | - | 0.4 | 4 |
| 37 | Rruga Unaza e Kotodeshit | - | 0.85 | 4 |
| 38 | Rruga e Lugut | - | 0.46 | 4 |
| 39 | Rruga Dheri i Bardhe | - | 1.12 | 4 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **40** | Rruga Beliku | | 1.84 | 4 |
| **41** | Rruga e Rrodokalit | - | 1.98 | 4 |
| **42** | Rruga Unaza Katjel | - | 0.8 | 4 |
| **43** | Bregu i Lemuar | - | 0.4 | 4 |
| **44** | Rruga Bregu i Vladit | - | 0.66 | 4 |
| **45** | Rruga Poçivalle – Golik | I asfaltuar | 8.52 | 4 |
| **46** | Rruga e Qafe Thanes | - | 2.17 | 4 |
| | **Shuma** | | **61.33** | |

| Nr. | Emërimi i rrugës | Lloji i shtresës | Gjatësia (Km) | Gjerësia (m) |
|---|---|---|---|---|
| | **Njësia Administrative Stravaj** | | | |
| **1** | Rruga Kiminik | - | 2 | 4 |
| **2** | Rruga Godovushe | - | 4.27 | 4 |
| **3** | Rruga e Curres | - | 1.5 | 4 |
| **4** | Rruga e Vretos | - | 1.17 | 4 |
| **5** | Rruga Lagjja e Facja | - | 0.64 | 4 |
| **6** | Rruga e Njesise Stravaj | - | 0.26 | 4 |
| **7** | Rruga Stravaj fshat | - | 1.37 | 4 |
| **8** | Rruga Qershize | - | 0.79 | 4 |
| **9** | Rruga Bratil | - | 4.96 | 4 |
| **10** | Rruga Sharre | - | 1 | 4 |
| **11** | Rruga Rruga Lagjja e Bardhos | - | 0.25 | 4 |
| **12** | Rruga e Krastes | I asfaltuar | 1 | 4 |
| **13** | Rruga e Mezit | I asfaltuar | 0.43 | 4 |
| **14** | Rruga Bregu Aratine | I asfaltuar | 0.52 | 4 |
| **15** | Rruga Liras | - | 5.89 | 4 |
| **16** | Rruga Vishok | - | 1.52 | 4 |
| **17** | **Shuma** | | **27.57** | |

.




**BASHKIA PRRENJAS**

# PLAN BIZNESI: Shtrirja e shërbimit të grumbullimit dhe transportit në zonat rurale


## Përgatitur nga *EcoDES Consultancy*

**Email:** info@ecodes-studio.com

**Web:** http://www.ecodes-consultancy.com

https://www.facebook.com/profile.php?id=100054464259264

https://www.linkedin.com/company/ecodes-studio/posts/?feedView=all

**TABLE OF CONTENTS**

**PLANI I BIZNESIT** ____ **3**
**PËRMBLEDHJA** ____ **5**

A. Prezantimi me aspektet kryesore të zgjerimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve 5

B. Qëllimi i zgjerimit të shërbimit të grumbullimit dhe trasnportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas ____ 5

C. Çfarë synon bashkia të arrijë duke zgjeruar shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas? ____ 5

D. Përfitimet që do vijnë nga shtrirja e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas: ____ 5

**OBJEKTIVAT** ____ **6**
**ANALIZIMI I TREGUT** ____ **8**

**ANALZIMI I PËRFITUESVE** ____ **8**
**ANALIZIMI I SHËRBIMIT TË MBETJEVE** ____ **8**

**PLANIFIKIMI I SHËRBIMIT** ____ **9**

**HAPI 1 – PLANIFIKIMI I SHËRBIMIT** ____ **9**
**HAPI 2 – ORGANIZIMI I SHËRBIMIT** ____ **9**

**ANALIZA FINANCIARE** ____ **10**

**MODELI I TË ARDHURAVE** ____ **10**
**ANALIZIMI I KOSTOS** ____ **10**
**MENAXHIMI DHE ZBUTJA E RISKUT** ____ **12**
**TIPET E RISQEVE** ____ **12**

**PLANI I BIZNESIT**



- **Çfarë do të kuptojmë me një plan biznesi në sektorin e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve? -** Një plan biznesi për ofrimin e shërbimit të mbetjeve në një njësi vendore është ***një dokument strategjik*** që përshkruan se si njësia vendore do të ofrojë shërbime efikase, me kosto efektive dhe të përgjegjshme për mjedisin për një komunitet të caktuar.
  Plani detajon shërbimet e ofruara, analizën e tregut, procedurat operacionale, çmimet, parashikimet financiare dhe pajtueshmërinë me rregulloret lokale. Plani synon të sigurojë që biznesi të përmbushë nevojat e komunitetit për menaxhimin e mbetjeve duke qenë i qëndrueshëm financiarisht dhe i ndërgjegjshëm për mjedisin.



- **Komponentët kryesorë të një plani biznesi për një shërbim të caktuara në sistemin e menaxhimit të mbetjeve**
  - Përmbledhje ekzekutive: Përmbledhje e shkurtër e ofertave, misionit dhe shërbimeve.
  - Qëllimet dhe objektivat:
    - Ofrimi i shërbimeve të besueshme dhe në kohë të grumbullimit të mbetjeve në nivelin vendor.
    - Promovimi i praktikave të asgjesimit dhe riciklimit me përgjegjësi mjedisore.
    - Arritja e përfitimeve, duke optimizuar kostot e shërbimit të arsyeshme për njësinë vendore.
    - Ndërtimi i partneriteteve afatgjata me autoritetet lokale, bizneset dhe banorët.
    - Zgjerimi i shërbimeve në lagje të reja ose zona lokale.
    - Prezantimi i programeve inovative të reduktimit ose riciklimit të mbetjeve.
    - Ndërtimi i një reputacioni për shërbime të besueshme, efikase dhe miqësore me mjedisin nga ana e pushtetit lokal.
  - Analiza e tregut: Kuptimi i nevojave të komunitetit lokal për menaxhimin e mbetjeve, shërbimet ekzistuese, konkurrenca dhe rregulloret.
  - Planifikimi i shërbimit: Llojet e shërbimeve të ofruara të mbetjeve (p.sh., rezidenciale, komerciale, riciklimi, mbetje të rrezikshme, etj.).
  - Plani Financiar: Buxheti, të ardhurat e parashikuara, shpenzimet dhe parashikimet financiare për të siguruar qëndrueshmëri dhe përfitim.
  - Plani Operacional: Detaje mbi logjistikën, oraret e grumbullimit të mbetjeve, transportin dhe metodat e përpunimit.
  - Menaxhimi dhe zbutja e riskut për shërbimin e ri të ofruar.






Figura 1 Skema e hapave të një plani biznesi

Bashkia Prrenjas po harton një plan biznesi për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale të bashkisë për të kuptuar kostot operative dhe të investimeve për ofrimin e këtij shërbimi, në mënyrë të tillë që bashkia të analizojë burimet e financimit të këtoj shërbimi.



**PËRMBLEDHJA**

**A. Prezantimi me aspektet kryesore të zgjerimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve**

- Rritet zona e mbuluar me shërbim.
- Forma e organizimit të shërbimit ndryshon për të ofruar një shërbim sa më efficient.
- Rinovohet infrastruktura e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- Zonat turistike dhe rurale kanë shërbim të dedikuar të menaxhimit të mbetjeve.
- Kosto rillogaritet sipas VKM për t'iu afruar sa më shumë buxhetit të bashkisë.
- Tarifat e pastrimit rishikohen për të mundësuar mbulimin e kostos së shërbimit.

**B. Qëllimi i zgjerimit të shërbimit të grumbullimit dhe trasnportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas**

- Qëllimi kryesor për zgjerimin e shërbimit të pastrimit në disa fshatra të largëta të Bashkisë Prrenjas është të sigurojmë përmirësim e kushteve të jetesës për banorët e këtyre zonave,
- Mbrojtjen e mjedisit (ajër, ujë dhe tokë) dhe uljen e ndotjes nga mbetjet dhe pikat ilegale nga mungesa e shërbimit.
- Mbulimin e 92% të territorit të bashkisë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

**C. Çfarë synon bashkia të arrijë duke zgjeruar shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas?**

- **Përmirësimin e shëndetit publik dhe mjedisit:** Me ofrimin e shërbimit në një zonë ku nuk është ofruar më parë, do të minimizojmë përhapjen e mbetjeve dhe ndotjen e mjedisit, duke kontribuar në një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm për banorët.
- **Konsolidimin e menaxhimit të mbetjeve:** Zgjerimi i shërbimit do të mundësojë menaxhim më të mbledhur dhe efikas të mbetjeve, duke siguruar mbledhjen dhe transportimin e rregullt dhe të koordinuar.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor:** Banorët e zonës do të kenë mundësinë të edukohen dhe të krijojnë një kulturë të re të menaxhimit të mbetjeve, duke i inkurajuar ata të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

**D. Përfitimet që do vijnë nga shtrirja e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas:**

| | | |
|---|---|---|
|  1 |  2 |  3 |
| ***Banorët*** e zonave rurale do të mundësohen më shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe do të kenë kushte më të mira jetese. Ofrimi i këtij shërbimi në këto zona do të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit të komunitetit. | ***Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit***: Ofrimi i këtij shërbimi në këto zona do të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit të komunitetit për hedhjen e mbetjeve në PGM të përcaktuara nga Bashkia dhe pagesën e tarifës së pastrimit. | ***Mjedisi*** në zonën e re të shërbimit do të jetë më i pastër dhe higjenik, duke eleminuar pikat ilegale të grumbullimit të mbetjeve, nga mungesa e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. |

# OBJEKTIVAT



Në këtë seksion përcaktohen ***4 objektiva specifike*** për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale në Bashkinë Prrenjas:

**Objektivat që do të përmirësojnë kushtet higjenike të zonës**

- Përmirësimi i higjienës publike: Zgjerimi i shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve në zonën e re do të kontribuoj në rritjen e nivelit të higjienës, duke eleminuar grumbullimet e mbetjeve apo krijimin e venddepozitimeve ilegale dhe mbrojtjen e shëndetit nga infeksionet dhe sëmundjet që mund të shkaktohen nga ndotja e shkaktuar nga mbetjet.
- Ulja e ndotjes mjedisore nga dekompozimi i mbetjeve të papërpunuara, duke parandaluar krijimin e kushteve për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme ·
- Përmirësimi i kushteve të jetesës të banorëve të zonës me një mjedis të pastër, cilësi më e lartë e jetesës dhe një ndjenjë më e lartë sigurisë dhe mirëqënies.

**Objektiva që lidhen me rritjen e zonave të mbuluara me shërbim të mbetjeve**

- Rritja e zonës së mbulimit do të përfshijë fshatrat rurale, duke bërë të mundur që çdo banor të ketë mundësinë e përfitimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, pa marrë parasysh vendndodhjen e tij.
- Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve do të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve më të shpeshta të mbledhjes së mbetjeve.
- Sigurimi i mbështetjes për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve duke zbatuar strategji të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve, si grumbullimi i materialeve të riciklueshme dhe të kompostueshme, duke ndihmuar në uljen e sasisë së mbetjeve që dërgohen në inceneratorë.

**Objektiva për rifreskimin e databazës së konsumatorëve të rinj**

- Rifreskimi i të dhënave të konsumatorëve, duke përfshirë informacionin për adresat e reja, llojin e shërbimit të kërkuar dhe historikun e pagesave të shërbimit, për të mundësuar një menaxhim efikas të shërbimit.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimi i banorëve që marrin shërbimin, informacioni për tarifat dhe rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, duke rritur angazhimin dhe bashkëpunimin e banorëve me bashkinë

**Objektiva për rishikimin e sistemit të tarifave dhe planifikimin e të ardhurave**

- Rishikimi dhe optimizimi i tarifave duke marrë parasysh mundësitë ekonomike të grupeve të ndryshme të popullatës, si ato vulnerabël.
- Zhvillimi dhe krijimi i një plani të qëndrueshëm të financimit afatgjatë për mbulimin e kostove të shërbimit dhe për sigurinë e qëndrueshmërisë financiare të tij.
- Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave: Për të siguruar që të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbledhjen në mënyrë efektive, duhet që të bashkëpunojmë me ujësjellesin e Pogradecit që të kemi një sistem më efikas i mbledhjes dhe monitorimit të pagesave, duke zvogëluar borxhet dhe duke siguruar që burimet financiare të jenë të mjaftueshme për funksionimin e vazhdueshëm të shërbimit.

## ANALIZIMI I TREGUT



## ANALZIMI I PËRFITUESVE

| Nr. popullsisë Bashkia Prrenjas | Zona ku do të ofrohet shërbimi dhe popullsia | Tipologjia e zonës së ri të shërbimit |
|---|---|---|
| 32,302 banorë | - NJA Administrative Rrajcë (fshatrat Bardhaj dhe Skëndërbej)<br>- NJA Qukës (fshatrat Bërzeshtë, Fanjë, Skroskë, Gurrë)<br>- NJA Stravaj (fshatrat Stravaj, Farret, Sopot, Shqiponjë, Stranik)<br>Nr. banorëve të zonës së re: 8,753 banorë | Zonë rurale |


## ANALIZIMI I SHËRBIMIT TË MBETJEVE

- Në Bashkinë Prrenjas ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të pajisur me 77 kontenierë në 65 PGM me kapacitet 1.1m$^3$.
- Shërbimi ofrohet 6 ditë në javë në qytetin e Prrenjasit, 2 ditë në javë në NJA Qukës dhe 1 herë në javë në zonat e reja që do të behën pjesë e skemës me 1 mjet teknologjik 5 ton, që nuk është i pajisur me një sistem GPS.
- Bashkia ka të angazhuar një staf prej 3 punonjësish (1 shofer + 2 punëtorë) për ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin e saj, të cilët punojnë me 1 turn.
- Sasia ditore e mbetjeve që gjenerohen në këtë zonë është 3.5 ton/ditë dhe ato transportohen në Inceneratorin e Elbasanit në distancë 60km nga qyteti i Prrenjasit.
- Bashkia ka probleme edhe mungesë të mjeteve teknologjike për në zonën e re të shërbimit.


# PLANIFIKIMI I SHËRBIMIT



## HAPI 1 – PLANIFIKIMI I SHËRBIMIT




## HAPI 2 – ORGANIZIMI I SHËRBIMIT




- Bashkia Prrenjas do të shtrijë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat e largëta rurale, të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara me shërbim.
- Bashkia do të kërkojë të bëjë një investim me kontenierë 1.1m$^3$, të cilët do të vendosen në zonat e banuara në fshatrat e tre njësive administrative.
- Bashkia do të kërkojë të investojë edhe për një mjet teknologjik për realizimin e këtij shërbimi me kapacitet 5 ton.
- Shërbimi do të kryhet nga vetë bashkia 1 herë në javë dhe me pas mbetjet do të transportohen për në inceneratorin e Elbasanit.



# ANALIZA FINANCIARE


## MODELI I TË ARDHURAVE

Analizimi i burimeve të financimit (bashkia, grantet, tarifat etj)

- Bashkia do të përpiqet të alokojë buxhet për ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat e reja rurale.
- Pjesë e të ardhurave që do të mundësojnë ofrimin e shërbimit do të jenë edhe të ardhurat e grumbulluara nga komuniteti i zonës nga tarifa e pastrimit.
- Për pjesën e investimeve të mjeteve teknologjike bashkia do të kërkojë ndihmë për investime nga qeveria apo donatorë të tjerë.

## ANALIZIMI I KOSTOS

Kosto e këtij shërbimi do të llogaritet sipas kërkesave ligjore të VKM nr. 319/2018 " Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", siç tregohet në skemën më poshtë:




Nga analizimi i të dhënave në lidhje me koston e shërbimit të ri në zonat rurale të bashkisë Prrenjas, duke përdorur sistemin sipas VKM, në tabelën më poshtë përcaktohen kostot operative dhe të investimit që lidhen shërbimin në zonat e reja:

| | Shërbimi grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale | Bashkia Prrenjas | Totali |
|---|---|---|---|
| **O&M totale vjetore** | 1,635,259.53 Lekë | 15,855,332.49 Lekë | **17,490,592 Lekë** |
| **Kosto totale investimi (kontenierë dhe mjete teknologjike)** | 4,461,077.69 Lekë | 5,817,829.06 Lekë | **10,278,907 Lekë** |

Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e analizës financiare për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale të largëta në Bashkinë Prrenjas:

| | TË DHËNA QË LLOGARITEN NGA SISTEMI |
|---|---|
| 01 **VARIABLA FIKSE** | 03 **KOSTO E ZONËS SË RE** |
| **Tipi i kamionit:** 5 ton (zona rurale) | **Sasia e mbetjeve vjetore:** 126 ton/ vit |
| **Tipi i kontenierit:** kontenier 1.1m$^3$ litra (për grumbullimin e mbetjeve miks në zonat rurale) | **Sasia e mbetjeve ditore:** 4.88 ton/ ditë |
| **Çmimi i 1 litër karburant:** 190 lek/litër | **Nr. i kontenierëve:** 42 me kapacitet (1.1m$^3$) |
| **Çmimi i 1 kontenieri 1.1m$^3$:** 35,000 lekë/ kontenier | **Nr. i turneve të mjetit:** 1 turn |
| **Kosto e landfill:** 3,100 lek/ton | **Kosto operative**: 1,635,259.53 Lekë<br><br>**Investime kapitale:** 4,461,077.69 Lekë (nga të cilat 1,461,078.00 Lekë për 42 kontenierë) |
| 02 **TË DHËNA BAZË** | 04 **KOSTOT NJËSI** |
| **Nr. Popullisë i zonës së shërbimit:** 8,753 banorë dhe totali bashkisë 32,302 banorë | **Kosto për banorë:** 187 lek/ banorë/ vit (zona rurale) |
| **Norma e gjenerimit:** 0.3 kg/ banorë/ ditë (miks) | **Kosto për ton:** 12,974 lek/ ton (zona rurale) |

| | |
|---|---|
| **Distanca për në Inceneratorin e Elbasanit:** 60 km | **Kosto për banorë:** 673 lek/ banorë/ vit (zona urbane) |
| **Distanca për grumbullimin e mbetjeve:** 20 km | **Kosto për ton:** 5,845 lek/ ton (zona urbane) |
| **Frekuenca e shërbimit:** 1 ditë/ javë (48 ditë/ vit) dhe 6 ditë/ javë për shërbimin e grumbullimit ekzistues (288 ditë/vit) | |





## MENAXHIMI DHE ZBUTJA E RISKUT

Lista e mundshme e rrisqeve që mund të hasë Bashkia Prrenjas gjatë zbatimit të planit të biznesit për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat rurale të largëta që janë pa shërbim aktualisht:

| TIPET E RISQEVE | ZBUTJA |
|---|---|
| **Pjesëmarrje e ulët e publikut** | Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi<br>Hartimi i guidave të qarta dhe gjetja e kanaleve eficiente të komunikimit<br>Marrja e rregullt e informacionit nga banorët përmes auditimeve |
| **Sfida në mënyrën e operimit** | Optimizimi i rrugëtimit duke përdorur mjete digjitale apo nëpërmjet GIS sistem<br>Mirëmbajtja e mjeteve do të ul kostot e operimit<br>Trainim i personelit për të menaxhuar situatat dhe problemet që mund të lindin<br>Bashkëpunimi me partnerë të interesuar për të tërhequr rrymat e riciklueshme |
| **Konsiderata në lidhje me shëndetin dhe sigurinë** | Zbatimi i skemës të realizohet me zona pilot e më pas të shtrihet në të gjithë bashkinë<br>Qese të zeza ose mjete alternative grumbullimi duhet të planifikohen në zërat e investimit<br>Puntorët duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse |

# PLANI OPERACIONAL DHE LOGJISTIKA PËR SHËRBIMIN



# Rregullore për Administrimin e Mbetjeve

## Bashki të Forta

C:\Program Files (x86)\PDF Tools AG\3-Heights(TM) Document Converter Service\Temp\a2434c82b1950e24eaf8f20e49e4cecfe1e5560e1c32203d751604ef05d8b050.docx

# RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE – BASHKIA PRRENJAS

## KUADRI QË NDËRMERRET

*Hartimi i rregullores ndërmerret në kuadër të Projektit "Bashki të forta", zbatuar nga Helvetas Albania, financuar nga Qeveria Zviceriane.*

*Në Bashkinë Prrenjas objektivi është përgatitja e një rregullore të administrimit të mbetjeve urbane, si një instrument për të orientuar ndryshimet në administrimin e mbetjeve dhe zgjidhjet në përputhje me legjislacionin dhe në këndveshtrimet, idetë dhe pjesëmarrjen e komunitetit.*

**KËSHILLI I BASHKISË PRRENJAS**

I mbledhur sot më datë ____/____/_____, pasi shqyrtoi projekt rregulloren e paraqitur nga _____ duke vlerësuar se mbrojtja dhe mirëmbajtja e mjediseve urbane/rurale është detyrë e të gjithë qytetarëve dhe u shërben atyre bazuar në:

- ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjeve vendore", nenet 8, 9, 22, 23;
- ligjin nr 9010, datë 13.02.2003 "Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta",nenet 3,7;
- në ligjin nr.10431 datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", nenin 31;
- në ligjin nr.8094, datë 23.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", nenet 1, 9, 19, 20, 25, 31, 34, 37;
- në ligjin nr.10463 date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", 13, 21, 62;
- në ligjin nr. 7697, datë 07.04.1993, "Për kundërvajtjet administrative";
- në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.798, date 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore";
- Rregulloren nr.1, datë 30.03.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit "Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim";
- Udhëzimin nr.6, date 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta";
- Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

**V E N D O S I:**

Të miratojë "Rregulloren për administrimin dhe monitorimin e mbetjeve urbane" si më poshtë.

**PËRMBAJTJA**

**KREU I DISPOZITA TË PËRGJITSHME....1**

Qëllimi....1

Objektivi i Rregullores....1

Përcaktimi i Termave....1

Procesi i ADMINISTRIMIT të Mbetjeve Urbane....4

Fazat e Procesit të ADMINISTRIMIT të Mbetjeve Urbane....5

Klasifikimi i Mbetjeve....5

Mbetjet Objekt i Rregullores....6

**KREU II PASTRIMI I RRUGËVE, SHESHEVE DHE TROTUAREVE....6**

Ndotja e hapësirave publike dhe Pastrimi i territoreve....6

Pastrimi dhe Larja e Rrugëve....7

Koshat rrugor, Konteinerët dhe vendet publike të grumbullimit të mbetjeve nga pastrimi i territoreve publike....7

Pastrimi i pusetave dhe dorëzimi i mbeturinave të pastrimit....8

**KREU III VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETJEVE URBANE....9**

Veçimi dhe sistemimi i mbetjeve urbane sipas zonave dhe subjekteve....9

Dorëzimi i mbetjeve urbane....9

Përdorimi i kontenierëve publikë....10

Kufizimiet për dorëzimin e mbetjeve urbane....10

**KREU IV GRUMBULLIMI, LARGIMI E TRANSPORTIMI I MBETJEVE....10**

Grumbullimi i mbetjeve, dhe skema e përgjithshme e PGM-ve (sipas zonave të shërbimit, përfshirë dhe lëvizja dhe frekuenca e grumbullimit)....11

Vendosja dhe karakteristikat e kontenierëve....11

Grumbullimi me kontenierë të lëvizshëm....12

Grumbullimi me kontenierë të palëvizshëm....13

Grumbullimi me qese....13

Shërbimi i pastrimit në tregje....14

Grumbullimi i mbetjeve bimore, te gjelberta....14

Ruajtja higjeno-sanitare për punonjësit e shërbimit, trainimi në punë....14

Transporti i mbeturinave të grumbulluara, mjetet dhe proçedurat....15

Peshimi i mbetjeve urbane dhe Rregjistrimi i të dhënave ..... 15

Transferimi i të dhënave të rregjistruara ..... 15

**KREU V ADMINISTRIMI I MBETJEVE URBANE NË MËNYRË TË DIFERENCUAR - QëNDRAT E MULTIGRUMBULLIMIT ..... 15**

Objekti i shërbimit të qëndrave të grumbullimit dhe parimet e përgjithshme (sipas llojit dhe subjektit konkret) ..... 15

Mënyrat e dorëzimit dhe grumbullimit të Mbetjeve Urbane ..... 16

Standarte për grumbullimin e mbetjeve urbane nëpërmjet kontenierëve ..... 16

Grumbullimi i diferencuar ..... 17

Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme ..... 17

Grumbullimi i mbetjeve të pariciklueshme ..... 17

Grumbullimi i mbetjeve të vëllimshme ..... 18

Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme ..... 18

**KREU VI QËNDRA(T) E MULTIGRUMBULLIMIT / VEND-DEPOZITIMIT ..... 19**

Hapja e qëndrave të Multigrumbullimit ..... 19

Qëndrat e Multigrumbullimit ..... 19

**KREU VII TARIFAT ..... 20**

Objekti i tarifës ..... 20

Taksapaguesit ..... 20

Vjelja e tarifës ..... 20

**KREU VIII KONTROLLI, NDALIMET DHE SAKSIONET ..... 21**

Kontrolli, objekti i kontrollit dhe funksionimi ..... 21

Ndërveprimi me strukturat e bashkisë dhe palët e tjera ..... 21

Ndalime dhe Detyrime ..... 22

Sanksionet ..... 23

**KREU IX MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN ..... 23**

Detyrimet për informim të publikut ..... 23

Procedurat e ankimimit dhe ekzekutimi i masave ..... 24

Manifestimet publike, panairet, spektaklet lëvizëse dhe veprimtari të stinës ..... 24

Fushatat sensibilizuese dhe informuese ..... 25

Bashkëpunimi me organizma jo qeveritare ..... 25

**KREU X DISPOZITAT E ZBATIMIT TË RREGULLORES.....26**

Zbatimi i rregullores .....26

Amendimet.....26

Hyrja në fuqi.....26

**ANEKSE**

**Aneksi 1 Plani i Përgjitshëm i Infrastrukturës, Territoreve dhe Logjistikës së Mbetjeve**

Aneksi 1.1 Harta e Përgjitshme e Mbulimit

Aneksi 1.2 Zona 1 –Prrenjas Qytet

Aneksi 1.3 Zona 2 –Prrenjas Fshat

Aneksi 1.4 Zona 3 –Katjel

Aneksi 1.5 Zona 4 –Kotodesh

Aneksi 1.6 Zona 5 –Urake

Aneksi 1.7 Zona 6 –Rrajcë

Aneksi 1.8 Zona 7 –Pishkash

Aneksi 1.9 Zona 8 –Karkavec

Aneksi 1.10 Zona 10 –Qukës-Shkumbin

Aneksi 1.11 Zona 11 –Qukës Qëndër

Aneksi 1.12 Zona 12–Berzeshtë

Aneksi 1.13 Zona 13–Fanjë

**Aneksi 2 Skema e administrimit të mbetjeve**

Aneksi 2.1 Skenari optimal i administrimit

Aneksi 2.2 Skenari i zakonshëm i administrimit

**Aneksi3 Itinerari dhe levizjet e mjeteve të grumbullimit**

Aneksi 3.1 Itinerari dhe levizjet e mjeteve të grumbullimit

Aneksi 3.2 Detaje mbi rrugët që fshihen dhe lagen

**Aneksi 4 Skema e monitorimit dhe raportimit**

Aneksi 4.1 Skema e Raportimit dhe Ankesave

Aneksi 4.2 Skema e Monitorimit

Aneksi 4.3 Procesverbal mbi kryerjen e punimeve

Aneksi 4.4 Procesverbal për zbritjen e pagesës për punime të pakryera

Aneksi 4.5 Format tip Situacioni Mujor

Aneksi 4.6 Format tip Raport Kontrolli i Kontratës së sipërmarrjes

Aneksi 4.7 Format tip Analizë vjetore e Kontratës së Sipërmarrjes

**Aneksi 5 Kategoritë e tarifave sipas llojit të subjekteve**

**Aneksi 6 Formularë komunikimi dhe raportimi për ndërveprimin me strukturat e Bashkisë dhe palët e tjera**

Aneksi 6.1 Formular Shkrese model

**Aneksi 7 Formularë të procedurës së ndalimeve dhe detyrimeve**

Aneksi 7.1 Akt Kontrolli

Aneksi 7.2 Fletë Gjobe

**Aneksi 8 Referenca dhe detaje mbi Sanksionet**

**Aneksi 9 Formularë për ankimimin, adresat dhe mënyrat e adresimit të ankesave**

Aneksi 9.1 Formular Ankese

Aneksi 9.2 Formular Kërkese Tip 1

Aneksi 9.3 Formular Kërkese Tip 2

**Aneksi 10 Kalendari dhe faqja zyrtare e aktiviteteve**

Aneksi 10.1 Kalendari i festave Kombëtare dhe Festave të Bashkisë

Aneksi 10.2 Evente me impakt në administrimin e mbetjeve

# KREU I DISPOZITA TË PËRGJITSHME

Neni 1

## QËLLIMI

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja synon të lehtesojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Neni 2

## OBJEKTIVI I RREGULLORES

Kjo rregullore përcakton mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë së Prrenjasit duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, pa përfshirë trajtimin e mbetjeve, me qëllim mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbetje dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për banorët.

Neni 3

## PËRCAKTIMI I TERMAVE

Në kuptimin e kësaj rregulloreje termat janë si vijon:

"**Administrim**": grumbullimi, transporti, rekuperimi dhe trajtimi i mbetjeve, duke përfshirë edhe kontrollin e këtyre operacioneve, për më tepër edhe kontrollin e fushave të shkarkimit dhe impianteve të trajtimit mbas mbylljes së aktivitetit.

"**Administrator/Operator i mbetjeve**": Shoqëria/ndermarrja, të cilës nëpërmjet kontratave të shërbimit, liçencave (leje), Bashkia i beson dhe/ose lejon administrimin e mbetjeve.

"**Mbikëqyrës**": Personi i caktuar nga Bashkia për monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës së administrimit të mbetjeve.

"**Mbetje**" është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë;

"**Mbetje urbane**"janë mbetjet e shtëpive, te ndërtesave administrative, sociale dhe publike. Ne këtë emërtim përfshihen edhe mbetjet qe vijnë si rezultat i veprimtarive tregtare, vendeve te pushimit e argëtimit, sasitë dhe përbërjet e te cilave nukpengojnë trajtimin e tyre bashke me mbetjet urbane.

"Mbetje speciale" janë:

mbetje nga aktivitete industriale, ku përfshihen edhe mbetjet e vëllimshme nga këto aktivitete;

"mbetjet nga aktivitetet bujqësore";

"mbetje spitalore";

mbetjet e krijuara nga "aktivitete ndërtimi" ose prishjesh";

mbetje jo urbanenga "aktivitete artizanale", "tregtare" apo "shërbimi";

"**Mbetje industriale**" janë mbetjet e krijuara nga veprimtaritë industriale, artizanale dhe nga shërbimet, dhe që nuk bën pjesë në Mbetjet e Rrezikshme. Mbetje te tilla mund te perfshijne mbetjet qe gjenerohen nga linjat prodhuese per: energjine elektrike; hekurin dhe celikun; plastikat dhe rezinat; letren; produkte gome; produkte guri, qelqi dhe qeranike; prodhime tekstile; mjete transporti, por nuk janë të kufizura nga to. Ky term, ne kete rregullore, nuk perfshin mbetjet e industrise minerare dhe asaj te naftes dhe gazit.

"**Mbetje te vëllimshme**" janë mbetje me përmasa te mëdha pajisjesh e makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i te cilave kryhet me metoda e teknika te veçanta.

"**Mbetje Bujqësore**": quhen mbetjet e krijuara nga kultivimi i bimëve dhe mbarështimi /mbajtja e kafshëve.

"**Mbetje spitalore**" quhen: "mbeturinat pathologjike" antropogjene që dalin nga operacionet e autopsitë;"mbeturinat mikrobiologjike" që përfshijnë kulturat e mbjella me agjentë të ndryshëm mikrobiologjike. Këtu përfshihen edhe kulturat e laboratorëve mjekësore, patologjike, farmaceutike, kërkimore - shkencore, industriale dhe të bizneseve; "mbeturinat e mprehta" që përfshijnë gjilpërat, shiringat, thikat e operacioneve.

"**Hedhurinë (mbetje të fundme)**" nga aktivitetet e rekuperimit dhe trajtimit të mbetjeve, baltat e prodhuara nga proçesi i pastrimit dhe trajtimeve të tjera për ujin dhe filtrimin e ujrave të turbullta dhe nga shembja e shtretërve të lumenjve.

"**Mbetje të rrezikshme**" janë mbetjet toksike (dhe shumë toksike), të dëmshme, gërryese, irrituese, kancerogjene, toksike për riprodhim, shpërthyese, oksiduese, shumë të djegshme, të djegshme, dëmtuese, infektuese, mutagjenike, rritëse të ndjeshmërisë, ekotoksike ose qe clirojnë gaze toksike ashtu siç përkufizohen në legjislacionin përkatës. Mbetje të rrezikshme nga përdorimi shtëpiak janë:

Bojra për lyerje, bojra shkrimi, ngjitës, tretës, produkte fotokimike, pesticide, mbajtës bosh të etiketuar "T", "C" dhe/ose "F" dhe bombula spray, bateri dhe pila, bateri makinash, ilaçe, shiringa, aksesorë për informatikën, vajra mineral, vajra vegjetal, tuba fluorishent dhe çdo lloj mbetje me përmbajte mërkuri.

"**Mbetje e ngurtë**" është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t'i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

"**Mbetje bio**" janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringu dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

"**Mbetje jo të rrezikshme**" janë mbetjet që nuk mbulohen nga përkufizimi i "mbetjeve të rrezikshme".

"**Mbetje shtëpiake**" janë mbetjet e sektorit familjar nga njësitë administrative, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.

"**Mbetje inerte**" janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut.

"**Mbetje e lëngshme**" është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.

"**Mbetje të ambalazheve**" janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes në këtë ligj, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.

"**Mbetjet nga gomat e përdorura**" janë mbetjet që krijohen kur gomat e vjetëruara, të dëmtuara janë zëvendësuar dhe kur automjetet arrijnë në fundin e jetës së tyre.

"**Ambalazh**" janë të gjitha produktet e prodhuara nga çdo lloj materiali i çdo natyre, që përdoret për mbajtjen, mbrojtjen, dorëzimin, shpërndarjen dhe prezantimin e mallrave, duke filluar që nga lëndët e para e deri te produktet e përpunuara, nga prodhuesi te përdoruesi apo konsumatori. "Elementet e pakthyeshme", që përdoren për të njëjtat qëllime, konsiderohen gjithashtu si ambalazhe.

"**Mbetje të papranueshme**", janë mbetjet e rrezikshme a të vëllimshme, të cilat administrohen me ligje të veçanta.

"**Krijues/prodhues/zotërues i mbetjeve**" është çdo person fizik apo juridik, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

"**Grumbullim**" është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.

"**Grumbullim i diferencuar**" është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh ndahet, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.

"**Grumbullimi i mbetjeve urbane**" quhet proçesi i pranimit, seleksionimit dhe rigrupimit të mbetjeve në vende të caktuara.

"**Parandalim**" janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:

sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;

ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;

përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

"**Rikuperim**" është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:

mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;

mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.

"**Riciklim**" është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t"i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.

"**Ripërdorim**" është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.

"**Ruajtje e përkohshme**" është mbajtja në një vend, me qëllim ruajtjen e mbetjeve për një periudhë kohe jo më shumë se një vit, pa kryer operacione që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së mbetjeve.

"**Transportim**" është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.

"**Dorëzimi**" quhet nxjerrja dhe hedhja e mbetjeve urbane nga prodhuesit e tyre në vendet e mbledhjes së mbetjeve urbane.

"**Trajtim**" janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

"**Vend-depozitimi**" i mbetjeve është sipërfaqe toke e caktuar nga organet e qeverisjes vendore për përpunimet dhe manipulimet që do të realizohen.

"**Groposje përfundimtare (asgjesim)**" : përfshin proçeset pas të cilave nuk parashikohet përpunim tjetër i mbetjes dhe që mbyllen me groposjen e hedhurinës.

"**Përpunim i mbetjes**": është ndryshimi i vetive ose i përbërjes së mbetjes duke e transformuar atë në produkt përfundimtar ose në lëndë të parë apo ndihmëse për prodhimin e produkteve përfundimtare.

"**Stokimi i mbetjeve**": quhet proçesi i ruajtjes (depozitimit) të produktit pas përpunimit të mbetjes deri në destinacionin përfundimtar.

"**Rajon**" është një ose disa njësi të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.

"**Zonë e larjes**" quhet shërbimi i larjes së rrugëve dhe në disa raste tëtrotuareve.

"**Zonë e kontratës**" quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të mbeturinave ndaj konsumatorëve kzistues, si dhe atyre që mund të shtohen gjatë kohështrirjes së kontratës brenda së njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia.

"**Vendndodhja e mbetjeve**" është vendi ku ndodhet lendfilli apo incineratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.

"**Pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM-të)**"- janë sipërfaqe të vogla që shërbejnë për dorëzimin e mbetjeve nga prodhuesit e tyre. Ato duhet të jenë të betonuara ose të asfaltuara.

"**Impiant incinerimi**" është çdo pajisje dhe njësi teknike, e palëvizshme ose e lëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve, që e rikuperon ose jo nxehtësinë që krijohet nga djegia.

"**Lendfill**" është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë.

"**Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve**" është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin.

Neni 4

## PROCESI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE URBANE

Procesi i administrimit të mbetjeve synon që:

Të parandalohet ndotja nga mbetjet dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh;

Të krijohet një sistem transparent dhe efiçentkomunikimi mes të gjitha palëve të interesit;

Të përfshihet më gjerësisht publiku në proçesin e administrimit të mbetjeve;

Të ruhen sidomos burimet natyrore nga ndikimet e mbetjeve;

Të mënjanohet çdo dëm a rrezik për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit;

Të garantohen kërkesat higjieniko-shëndetësore dhe të mënjanohet çdo rrezik për ndotjen e mjediseve urbane;

Të ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peisazhi nga degradimi;

Të rezultojnë sa më pak mbetje nga veprimtaritë prodhuese;

Të krijohet një sistem efiçent i të gjitha hallkave që nga krijimi deri te asgjesimi i mbetjeve;

Në mbetjet e krijuara, ta zënë vendin kryesor mbeturinat e degradueshme, të riciklueshme e të përpunueshme;

Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve;

Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbetjeve me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;

Mbetjet t'i nënshtrohen sa më shumë riciklimit dhe përpunimit;

Të grumbullohen dhe të trajtohen të ndara mbetjet në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbetjet e rrezikshme;

Të mos pengohet përdorimi i mëtejshëm i mbetjeve nga trajtimi i tyre në një fazë të mëparshme;

Të pakësohet sa më shumë levizja dhe transporti i mbetjeve dhe asgjësimi i tyre të kryhet në impiantin më të afërt;

Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizike dhe juridikë ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbetjeve;

Të kryhet groposje e sigurtë për hedhurinat që rezultojnë pas përpunimit të mbetjeve;

Të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, pas dorëzimit të tyre nga krijuesit janë pronë shtetërore.

Neni 5

## FAZAT E PROCESIT TË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE URBANE

Procesi i administrimit të mbetjeve përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga krijuesi, dorëzimin sistematik në kazan, transportimin nga kazanët për në vend-depozitimin, ndarjen, riciklimin, përpunimin dhe asgjesimin përfundimtar në vend-depozitim.

Neni 6

## KLASIFIKIMI I MBETJEVE

Në funksion të kësaj rregulloreje mbetjet ndahen në kategoritë e mëposhtme:

Mbetje urbane;

Mbetje industriale;

Mbetje të vëllimshme;

Mbetje bujqësore;

Mbetje spitalore;

Mbetje të ndërtimit;

Mbetje në sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza, etj.

Sipas origjinës së prodhimit mbetjet ndahen në:Mbetje Urbanedhe Mbetje Speciale dhe sipas karakteristikave të rrezikshmërisë, në: Mbetje të rrezikshme dhe Mbetje jo të rrezikshme.

Neni 7

**MBETJET OBJEKT I RREGULLORES**

Objekt i kësaj rregulloreje janë Mbetjet Urbane.

Në funksion të kësaj rregulloreje, Mbetjet Urbane i ndajmë në dy kategori:

Mbeturina Urbane të Riciklueshme – të cilat përfshijnë mbeturina që mund të ri-përdoren ose ri-ciklohen (mund të përpunohen duke u vënë në përdorim si lëndë e parë). Në këtë kategori përfshihen:

Mbetjet metalike;

Mbetjet e lulishteve, kopeshteve;

Mbetjet plastike;

Letrat dhe kartonat;

Shishet e qelqit (qelqurinat).

Mbetje Urbane të Paricikluesshme – si psh. mbetje ushqimore dhe kuzhine me përbërje të fermentueshme, etj, të cilat përmbledhin të gjitha mbetjet urbane që nuk përfshihen në kategorinë e Mbetjeve Urbane të Riciklueshme.

## KREU II PASTRIMI I RRUGËVE, SHESHEVE DHE TROTUAREVE

Neni 8

**NDOTJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE PASTRIMI I TERRITOREVE[1]**

Autoritetet e Bashkisë, me asistencën apo bashkëpunimin e strukturave përkatëse rajonale si përfaqësuesit e inspektoriatit sanitar shtetëror të qarkut, përfaqësuesit e inspektoriatit të mbrojtjes së mjedisit dhe ata të ndërmarrjes/sipërmarrjes së pastrimit, përcaktojnë dhe publikojnë grafikun e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve si dhe përcaktojnë pozicionimin e koshave apo pikave të grumbullimit të mbetjeve konform dipozitave të kësaj rregulloreje.

[1] Referoju Aneksit 1 për: Planin e Përgjitshëm të Infrastrukturës, Territoreve dhe Logjistikës së Mbetjeve

Mbetjet që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen në Mbetjet Urbane, si për shembull: mbetjet e rrezikshme, mbetjet ndërtimore dhe objektet e vëllimshme, transportohen nga vetë prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit, që specifikohen nga Bashkia përkatësisht për secilën prej mbetjeve. Bashkia mund të ofrojë pika alternative për grumbullimin e tyre pranë zonave të banimit.

Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuarëve bëhet përgjithësisht një herë në 24 orë, herët në mëngjes ose në orët e mbrëmjes, kur është ulur ndjeshëm aktiviteti qytetar. Gjatë ditës pastërtia sigurohet duke grumbulluar dhe larguar nga sheshet, rrugët e trotuaret, hedhurinat e ngurta të kalimtarëve si dhe ndotjet e tjera.

Neni 9

**PASTRIMI DHE LARJA E RRUGËVE**

Pastrimi dhe larja e rrugëve realizohet nga Bashkia, ose nga një palë e tretë e ngarkuar prej saj apo e kontraktuar për të kryer këtë shërbim. Në kontratë specifikohen të gjitha kushtet dhe kërkesat që ka Bashkia për pastrimin, kontrolli për zbatimin e tyre, si dhe sanksionet për shkelje të kushteve e kërkesave të kontratës. Periodiciteti i shërbimit të pastrimit përcaktohet nga Bashkia sipas nivelit të ndotjes që shkaktohet.

Subjekt i pastrimit mund të jenë të gjithë rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotuaret e Bashkisë dhe Njësive Administrative të saj. Bashkia përcakton rrugët dhe sheshet që duhet të lahen. Bashkia administron të gjitha sipërfaqet e gjelbra publike, dhe vetë ose nëpërmjet palëve të treta kryen mirëmbajtjen, ruajtjen dhe pastrimin e territorit nga mbetjet.

Rrugët dhe sheshet lahen pas pastrimit. Gjatë periudhës së nxehtë (maj-shtator) bëhet larja e tyre çdo ditë. Numri i larjeve përcaktohet sipas sezonit dhe kushteve konkrete. Për larjen përdoret uji me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë. Në këto raste mund të përdoret edhe uji i puseve, lumenjve apo baseneve të tjerë ujorë.

Për larjen e rrugëve përdoren automjete të posaçme.Përdorimi i uniformave për punëtorët dhe i trajtimit special në përputhje me normat higjeno-sanitare është rigorozisht i detyrueshëm.

Neni 10

**KOSHAT RRUGOR, KONTEINERËT DHE VENDET PUBLIKE TË GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE NGA PASTRIMI I TERRITOREVE PUBLIKE**

Nxjerrja dhe dorëzimi i mbeturinave bëhet nën kujdesin dhe përgjegjsinë e Krijuesit të mbetjeve. Dorëzimi i mbetjeve bëhet nëpërmjet koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara të vendosura nga Bashkia. Ndalohet ndryshimi arbitrar i PGM-ve të mbetjeve.

Me qëllimin për të garantuar mbajtjen pastër të hapësiravë publike mund të vendosen dhe të administrohen, nën kujdesin e administratorit, kosha rrugor për mbetje të dimensioneve të reduktuara të prodhuara nga kalimtarët.Kalimtarët, mbeturinat e çastit si amballazhe të ndryshme, i dorëzojne vetëm në koshat e vendosur në hapësirat publikeose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.

Mbeturinat që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbeturinave sipas llojit të mbetjeve që prodhohen.

Ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e elektrikut, në pusetat e telefonisë, në pusetat e ujësjellësit, në pusetat e ujrave të zeza, në pusetat e hidranteve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

Neni 11

**PASTRIMI I PUSETAVE DHE DORËZIMI I MBETURINAVE TË PASTRIMIT**

Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të rrugëve, bëhet vetëm nga punonjësit e subjektit të ngarkuar me administrimin e tyre.

Përpara sezonit të shirave kryhet pastrimi i të gjithë pusetave të ujrave atmosferike, për të siguruar në vazhdimësi trasportimin e tyre. Mbas çdo pastrimi, hiqen menjëherë mbeturinat që dalin nga pastrimi dhe kryhet dezinfektimi përreth pusetës me lëndë dezinfektuese ose pluhur gëlqere me 5% përmbajtje klori.

Mbeturinat e nxjerra nga pastrimi i pusetave largohen menjëherë nga subjekti përgjegjës dhe depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

## KREU III VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETJEVE URBANE

Neni 12

### VEÇIMI DHE SISTEMIMI I MBETJEVE URBANE SIPAS ZONAVE DHE SUBJEKTEVE

Familjet si dhe subjektet publike a private që gjatë veprimtarisë së tyre krijojnë mbetje, i veçojnë ato në grupe si:

mbeturina ushqimore

amballazhe (plastike, qelq, letër,karton)

mbeturina ndërtimore (llaç, tulla, beton, dhera)

objekte të vëllimshme ( karrige, tavolina, kolltuqe, etj)

Secili grup trajtohet e amballazhohet më vehte, në qeska a kosha të veçantë.

Mbeturinat e vëllimshme (si automjete, makineri, pajisje), çohen nga pronaret në vendin e posaçëm për depozitimin dhe përpunimin e tyre. Braktisja e tyre jashtë vendeve të përcaktuara, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Të gjithë subjektet që në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre krijojnë lloje të ndryshme mbeturinash, janë të detyruar të kenë më shumë se një kosh për grumbullimin e ndarë të tyre.

Koshat janë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që orientojnë hedhjen e veçuar të mbeturinave. Koshat vendosen në vende të dukshme dhe lehtësisht të përdorshme.

Spitalet, ambulancat, qendrat shëndetësore, laboratorët farmacitë, klinikat stomatologjike, shtetërore a private, detyrohen të përdorin sistemin e disa koshave për mbeturinat, njëri prej të cilëve është për mbeturinat e rrezikshme spitalore që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë.

Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, mund të përdorin sistemin e disa koshave për të edukuar nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.

Neni 13

### DORËZIMI I MBETJEVE URBANE

Sistemimi dhe dorëzimi i mbeturinave nga krijuesi i mbetjeve, bëhet vetëm në vendet publike të mbledhjes së mbeturinave që ka caktuar Bashkia ose me kontenierë individualë që përcaktohen sipas llojit të prodhuesit, sasisë së mbetjeve dhe infrastrukturës. Dorëzimi i tyre jashtërregullave të përcaktuara nga Bashkia, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Tregëtarët dhe persona të tjerë që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me kosh të posaçëm për grumbullimin e mbeturinave që u krijohen gjatë tregëtimit e shërbimit që u ofrojnë qytetarëve.

Të drejtën e përdorimit të kontenjerëve publikë për dorëzimin e mbetjeve e kanë familjet brenda vijës kufizuese të Njësisë Administrative, bizneset kur prodhimi ditor (i çdo biznesi) nuk është më tepër se 20-25 % e volumit të një kontenjeri. Bizneset, institucionet private ose shtetërore që prodhojnë mbetje mbi këtë kufizim, duhet të pajisen me kontenjer individual brenda territorit të tyre.

Dorëzimi i mbetjeve është një detyrim i prodhuesit dhe duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve dhe orëve të përcaktuara nga Bashkia dhe Operatori i shërbimit të pastrimit.

Neni 14

**PËRDORIMI I KONTENIERËVE PUBLIKË**

Mbështetur në Ligjin Nr. 8094 dt.21.03.1996,kanë të drejtë të përdorin kontenierët publik:

Familjet, brenda vijës së verdhë të Njësisë Administrative përkatëse.

Bizneset,të llojit tregtar, artizanal apo shërbimesh,që prodhojnë mbetje urbane, ku prodhimi ditor i çdo subjekti nuk kalon sasinë prej ¼ e volumit të një kontenieri, përcaktuar në Nenin 12 të ligjit Nr.8094 dt.21.03.1996.

Të gjithë bizneset apo institucionet privatë apo shtetërorë që prodhojnë mbetje mbi kufizimin e mësipërm, duhet të kenë detyrimisht kontenierë individualë brenda territorit të tyre.

Neni 15

**KUFIZIMIET PËR DORËZIMIN E MBETJEVE URBANE**

Dorëzimi i mbetjeve është një detyrim i prodhuesit dhe duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve dhe orareve të përcakuara nga Bashkia si dhe mbështetur në kategorizimin e mbetjeve dhe prodhuesve të përcaktuar në këtë rregullore.

Dorëzimi i mbetjeve industriale, ndërtimore, mbeturinave të zanatit, mbeturinave të vajrave lubrifikante, si dhe mbeturina te tjera që nuk konsiderohen si mbetje urbane nga ligji nr.8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave" dhe nga kjo rregullore, do të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Bashkia për këtë qëllim.Dorëzimi i tyre në PGM-të e caktuara për mbeturinat urbane, është i ndaluar dhe ndëshkohet.

Mbetjet ndërtimore dorëzohen në pikat e caktuara nga Bashkia për këtë qëllim. Gjatë procesit të ndërtimit, riparimit apo prishjes, qytetarët, investitorët dhe subjektet ndërtues, marrin masa për largimin e vazhdueshëm të mbeturinave ndërtimore.

Hedhja e mbetjeve ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik, si dhe në pikat që ka caktuar Bashkia për mbeturinat urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje që ndëshkohet si e tillë.

Mbetjet që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të çohen në PGM, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.

## KREU IV GRUMBULLIMI, LARGIMI E TRANSPORTIMI I MBETJEVE[2]

Neni 16

[2] Referoju Aneksit 2 për: Skemën e administrimit të mbetjeve

## GRUMBULLIMI I MBETJEVE, DHE SKEMA E PËRGJITHSHME E PGM-VE (SIPAS ZONAVE TË SHËRBIMIT, PËRFSHIRË DHE LËVIZJA DHE FREKUENCA E GRUMBULLIMIT)

PGM-të ku vendosen konteinerët, kazanët apo stacionet e betonuara për grumbullimin e mbetjeve, caktohen nga Bashkia.Këshilli Bashkiak, miraton dhe publikon skemën konkrete të vend-ndodhjes së PGM-ve dhe strukturën e përmasat e secilës. Ndryshimi i vendndodhjes së PGM-ve, pa miratim të Bashkisë, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Ofrimi dhe pranimi i shërbimit është i detyrueshëm në të gjithë territorin bashkiak, duke mos përjashtuar askënd, vetëm në rastet kur Kryetari i Bashkisë autorizon forma të përkohshme eksperimentale të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në mënyrë jo të diferencuar ofrohet nga Bashkia në një ose disa mënyra specifike, si:

grumbullimi nëpërmjet kontenierëve publikë;

grumbullimi nëpërmjet qeseve; derë më derë

grumbullimi nëpërmjet dorëzimit në platforma (sheshe) bashkiake;

grumbullimi nëpërmjet kontenierëve për hapësira private dhe të përmasave të ndryshme.

Prodhuesi i mbetjeve mund të depozitojë mbetjet në mënyrë individuale direkt në fushën e grumbullimit, në përputhje me këtë rregullore.

Shërbimi duhet të garantojë grumbullimin e të gjithë mbetjeve që për çfarëdo lloj motivi gjenden jashtë kontenitorëve,në pikat ku shërbimi kryhet “derë më derë”, si edhe grumbullimin e mbetjeve që gjenden të shpërndara në hapësirat publike.

Neni 17

## VENDOSJA DHE KARAKTERISTIKAT E KONTENIERËVE

Kontenierët parashikohen në numër të tillë që të sigurojnë grumbullimin nëkohë dhe në sasi, midis flukseve të çdo cikli dorëzimi.

Caktimi i PGM,duhet bërë duke respektuar kriteret e higjenës, aty ku është e mundur në një distancë prej 10 metrash, largësi (vijë) ajrore nga dyert dhe dritaret, në harmoni me infrastrukturën urbane, për më tepër me qëllim lehtësimin e operacionit të zbrazjes dhe tërheqjes.

Për të gjitha ndërtimet e reja, projektet e rikonstruksioneve apo zonave të reja urbane përcaktimi dhe miratimi i vendeve të grumbullimit të mbetjeve është e detyrueshme dhe bëhet në përputhje me Nenin 29 të Ligjit 8094dt. 21.03.1996.

Kontenierët mund të vendosen brenda hapësirave private, brenda dyqaneve, tregjeve dhe pikave të shitjes me pakicë ose shumicë, apo brenda institucioneve publikë, shkollave dhe qendrave sportive, etj mepëlqimin/ose jo të pronarit ose administratorit si dhe miratimin e Bashkisë, në rastet e mëposhtme:

në zonat ku struktura urbanistike e bën të pamundur vendosjen e kontenierëve në hapësira publike;

në raste të veçanta nevojash të shërbimit të grumbullimit, që lidhen me:

dëshirën e konsumatorit për të pasur pikë të pavarur;

sasinëdhe llojin e mbetjeve që prodhon, ku përfshihen edhe mbetjet jo urbane.

llojin e aktivitetit, etj.

Në këto raste mund të ketë shtesë për tarifën e shërbimit që përfiton.

Në rastet kur konsumatori nuk ofron pëlqimin për të pasur kontenierë të pavarur, ai detyrohet të depozitojë mbetjet në pikën më të afërt të grumbullimit kur është në përputhje me kriterin e vendosuar në nenin 20 "Përdorimi i kontenierëve pub likë", ose në të kundërt duhet të bëjë vetë depozitimin e mbetjeve në fushën e depozitimit të tyre në përputhje me normat e përcaktuara në këtë rregullore.

Grumbullimi i mbeturinave që krijohen nga bisnesi (i vogël, i mesëm, i madh), por që nuk përfshihen në kategorinë "mbeturinat të bizneseve" (si p.sh tallash, xham,etj.), bëhet me kontenierë privatë të vendosur brenda sipërfaqes ku kryhet aktiviteti. Kontenierët private duhet të kenë të njëjtët parametra si edhe ata publikë.

Kontenierët duhet të kenë sipërfaqe të lëmuara, material me qëndrueshmëri të lartë dhe të papërshkueshëm nga uji, material metalik (trashësi të llamarinës=1.5-2 mm) apo plastik, të pajisura me kapak dhe me rrota (ose këmbë fikse), të kapaciteteve të ndryshme.

Kontenierët mbahen gjithmonë në kushte optimale pune nga subjekti që është angazhuar me shërbimin e mbledhjes dhe transporit të mbetjeve.

Kontenierët mund të jenë të llojeve, si më poshtë vijojnë:

Kontenierë të brendshëm, me kapacitet vëllimetrik prej 120 / 240 / 360 litër, Kontenierë publikë urban, me kapacitet vëllimetrik prej 1.100, 2.400, 3200 litra, për qëndrim jashtë;

Kontenierë për mbetje të vëllimshme, palëvizshëm, pa rrota, me kapacitet vëllimetrik mbi 5.500 litra, për qëndrime fikse dhe proçesi i zbrazjes kryhet në mënyrë mekanike.

Kontenierë me kompaktim, të palëvizshëm, pa rrota, me kapacitet volumetrik të madh, me vetëkompaktim (të pajisura me sistem hidraulik apo mekanik të pavarur).

Neni 18

## GRUMBULLIMI ME KONTENIERË TË LËVIZSHËM

Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve kryhet në hapësirat publike bashkiake të banimit, bizneseve ose në oborre të shoqërive private a publike dhe në përgjithësi në të gjithë vendet ku është parashikuar një prodhim i konsiderueshëm mbetjesh.

Zbrazja e kontenierëve kryhet sipas një grafiku të caktuar në kontratë në bazë të një kalendari operativ e që i komunikohen paraprakisht përdoruesit nën kujdesin e operatorit;

Menjëherë mbas largimit të mbeturinave territori përreth sheshit të konteinerëve pastrohet në një sipërfaqe 20-25 m2. Kontenierët dezinfektohet me gëlqere të kloruar (deri 5% klor aktiv) ose lëndë dezinfektuese pas zbrazjes së mbeturinave.

Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve ose në pikat e përcaktuara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori duhet të njoftojë menjëherë dhe tëmarrë masa për pastrimin e tyre.

Neni 19

## GRUMBULLIMI ME KONTENIERË TË PALËVIZSHËM

Mbetjet e vëllimshme dhe të ndërtimit, të prodhuara nga ekonomitë familjare, mund të dorëzohen dhe grumbullohen, me mënyrat e përcaktuara nga Bashkia, si më poshtë vijojnë:

nëpërmjet dorëzimit në kontenierët e palëvizshëm, me dimensione të mëdha;

nëpërmjet grumbullimit pranë ishpërdoruesit, me anë të telefonimit të administratorit;

nëpërmjet dorëzimit pranë Qendrave të Multigrumbullimit.

Në ditën e parashikuar për grumbullim, materiali duhet të nxirret jashtë nga ishpërdoruesi, në pikën më të afërt të grumbullimit, në mënyrë që të evitojë çdo pengesë ndaj lëvizjes së mjeteve dhe/ose këmbësore.

Administratorët e tregjeve, persona të veçantë apo grup personash tregtarë që zënë vendet e shitjes në tregjet privatë apo publikë, të organizuar në hapësirat publike ose private, duhet të administrojnë vetë pastrimin e territorit të tregut menjëherë pas mbylljes së aktivitetit ditor. Për sa i përket administrimit të mbetjeve që dalin këto tregje duhet të operohet simë poshtë vijon:

Administratori i tregut privat apo përfaqsuesi i tregtarëve është përgjegjës për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve për në fushën e depozitimit duke lidhur detyrimisht kontrata të veçanta me Bashkinë ose operatorë privatë, që të garantojnë zbatimin e kushteve higjeno sanitare të kësaj rregulloreje.

Në rastet e tregjeve publikë që administrohen nga Bashkia, ky shërbim përfshihet në shërbimet e tjera të pastrimit që administron Bashkia.

Detyrimisht çdo treg duhet të ketë të miratuar nga Bashkia “PGM” të përkohshëm ose të përhershëm, brenda territorit të tregut, për të mundësuar vendosjen e kontenierëve.

Të gjithë shitësat e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbeturinat që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga Bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbeturinave është shkelje që ndëshkohet me moslejimin për të tregëtuar përsëri në treg.

Neni 20

## GRUMBULLIMI ME QESE

Bashkia, në pamundësi të kryerjes së shërbimit me kontenierë publikë mund të ofrojë shërbim alternativ të grumbullimit me qese të mbetjeve në zona të caktuara urbane.

Përdoruesi familjar ka detyrimin të nxjerrë jashtë banesës së tij, pranë derës ose në një vend të përcaktuar në hapësirën publike, qeset në mënyrë të dukshme, të mbyllura (lidhura), në mënyrë të rregullt, për të mos krijuar pengesa apo rreziqe për kalimtarët në orare të përcaktuara paraprakisht.

Mund të aplikohen pika grumbullimi të lëvizshme që janë mjete vetë shkarkuese të hapura të tonazhit të vogël gjithmonë me orare dhe frekuencë të përcaktuar.

Frekuenca dhe ora e grumbullimit përcaktohet nga operatori me miratimin e Bashkisë, kurse lajmërimi i orarit bëhet nga operatori i shërbimit.

Qeset duhet të jenë të të njëjtit lloj dhe i shpërndahen përdoruesit nga operatori në proporcion me konsumin.Qeset duhet të jenë në peshë jo më të madhe se 20kg dhe nuk duhet të kenë objekte që presin, me majë, gjithsesi materiale të rrezikshme për përsonin përgjegjës për shërbimin manual të grumbullimit.

Neni 21

**SHËRBIMI I PASTRIMIT NË TREGJE**

Administratorët e tregjeve, persona të veçantë apo grup personash tregtarë që zënë vendet e shitjes në tregjet privatë apo publikë, të organizuar në hapësirat publike ose private, duhet të administrojnë vetë pastrimin e territorit të tregut menjëherë pas mbylljes së aktivitetit ditor. Për sa i përket administrimit të mbetjeve që dalin këto tregje duhet të operohet simë poshtë vijon:

Administratori i tregut privat apo përfaqsuesi i tregtarëve është përgjegjës për mbledhjendhe largimin e mbetjeve për në fushën e depozitimit duke lidhur detyrimishtkontrata të veçanta me Bashkinë ose operatorë privatë, që të garantojnë zbatimin e kushteve higjeno sanitare të kësaj rregulloreje.

Në rastet e tregjeve publikë që administrohen nga Bashkia, ky shërbim përfshihet në shërbimet e tjera të pastrimit që administron Bashkia.

Detyrimisht çdo treg duhet të ketë të miratuar nga Bashkia “PGM” të përkohshëm ose të përhershëm, brenda territorit të tregut, për të mundësuar vendosjen e kontenierëve.

Të gjithë shitësat e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbeturinat që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga Bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbeturinave është shkelje që ndëshkohet me moslejimin për të tregëtuar përsëri në treg.

Neni 22

**GRUMBULLIMI I MBETJEVE BIMORE, TE GJELBERTA**

Grumbullimi i mbetjeve të imta bimore kryhet nëpërmjet dorëzimit pranë vendeve të përcaktuara nga Bashkia, në kontenierët publikë të mbeturinave urbane ose me shërbim grumbullimi “derë më derë”.

Neni 23

**RUAJTJA HIGJENO-SANITARE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT, TRAINIMI NË PUNË**

Për ruajtjen higjeno-sanitare të punonjësve të shërbimit të administrimit të mbetjeve zbatohen normat në dispozicion për sigurinë dhe higjenën e punës. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me veshje të përshtatshme dhe me mekanizma apo pajisje për mbojtje personale, dhe duhet t’i nënshtrohen trajtimeve për kontrolle sanitare të parashikuara në ligj.

Neni 24

## TRANSPORTI I MBETURINAVE TË GRUMBULLUARA, MJETET DHE PROÇEDURAT[3]

Transporti i mbeturinave për në vendet e depozitimit bëhet nga Bashkia ose nga një palë e ngarkuar prej saj.Transporti organizohet e funksionon në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes.

Transportimi i mbeturinave nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me mjete teknollogjike të posaçme dhe të mbuluara, ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbeturinave.

Kamionët që transportojnë lëndë dhe materiale ndërtimi ose që çojnë mbeturinat ndërtimore në vendet e depozitimit të tyre, marrin masa që gjatë lëvizjes të mos ketë derdhje apo rrjedhje të materialeve që transportojnë.

Kamionët, autoveturat, etj, kur hyjnë në rrugët e zonave urbanenga kantierët e ndërtimit dhe nga rrugë dytësore të paasfaltuara, janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta, llaçet, betonet e çdo papastërti tjetër që ndot zonën urbane.

Neni 25

## PESHIMI I MBETJEVE URBANE DHE RREGJISTRIMI I TË DHËNAVE

Të gjithë mbetjet e grumbulluara, përpara se të depozitohen apo dërgohen në proçeset e rekuperimit apo përpunimit final, duhet të peshohen nëpërmjet përdorimit të një sistemi peshimi rregullisht të kolauduar. Në vazhdim të operacionit të peshimit duhet të kryhen edhe rregjistrimet e të dhënave.

Neni 26

## TRANSFERIMI I TË DHËNAVE TË RREGJISTRUARA[4]

Të gjitha të dhënat do të mblidhen dhe ruhen në kujdesin e administratorëve të ndryshëm të shërbimeve dhe mund të mbikëqyrenapo kërkohen nga Bashkia me ritme periodike që përcaktohen më parë.

## KREU V ADMINISTRIMI I MBETJEVE URBANE NË MËNYRË TË DIFERENCUAR - QëNDRAT E MULTIGRUMBULLIMIT

Neni 27

## OBJEKTI I SHËRBIMIT TË QËNDRAVE TË GRUMBULLIMIT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME (SIPAS LLOJIT DHE SUBJEKTIT KONKRET)

Kreu aktual ka të bëj me administrimin e fraksioneve të ndryshme të mbetjeve urbane të përcaktuara në Nenin 7 dhe 12 të Rregullores, të cilat duhet të depozitohen dhe grumbullohen duke respektuar dispozitat e përgjithshme dhe të veçanta në vazhdim.

Shërbimi organizohet në mënyrë të tillë që të arrij sa më tepër të jetë e mundur objektivin e reduktimit të prodhimit të mbetjeve urbane dhe të ndarjes së burimeve për llojet e ndryshme të materialeve që i

[3] Referoju Aneksit 3 për: Itinerarin dhe oraret e lëvizjes së mjeteve të grumbullimit

[4] Referoju Aneksit 4 për: Skemën e monitorimit dhe raportimit

përbëjnë ato, duke tentuar reduktimin, me kalimin e kohës, të sasisë së materialit të padifierencuar jo të riciklueshëm dhe jo të rekuperueshëm.

Neni 28

**MËNYRAT E DORËZIMIT DHE GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE URBANE**

Mënyrat e dorëzimit dhe grumbullimit të Mbetjeve Urbane janë:

Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve (kazanë, ose të tjerë)

Grumbullimi nëpërmjet sistemit të grumbullimit "derë më derë".

Grumbullimi nëpërmjet qendrave multigrumbulluese dhe/ose shesheve të vogla ekologjike.

Sheshi ekologjik shërben për të kryer grumbullimin e fraksioneve të ndryshme të materialeve në një sipërfaqe ku janë sistemuar kontenierë të ndryshëm sipas llojit të mbetjes.Ky shesh ekologjik mund të marr karakteristikat e një qendre multigrumbullimi kur bëhet fjalë për një sipërfaqe të rrethuar, e lejueshme për përdoruesit vetëm në orare të caktuara, dhe ku për të cilën është caktuar një përgjegjës.

Neni 29

**STANDARTE PËR GRUMBULLIMIN E MBETJEVE URBANE NËPËRMJET KONTENIERËVE**

Për grumbullimin e mbetjeve urbane nëpërmjet kontenierëve, standartet minimale që duhet ndjekur për organizimin e tyre duhet të përcaktohen konform dispozitave të kësaj rregulloreje si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore ku ajo bazohet. Llogaritja e numrit të nevojshëm të kontenierëve duhet të bëhet duke marrë në konsideratë:

Zonën e kontratës;

Numrin e popullsisënë zonën e Kontratës;

Kategoritë e prodhuesve të mbetjeve (banorë, biznese, industri, institucione publike etj) dhe koeficientët përkatës të prodhimit.

Llojin e mbetjeve të prodhuara në zonën e kontratës;

Largësinë e PGM-ve nga Krijuesi i Mbetjeve si dhe nga njëra tjetra;

Pozicionimi i PGM-ve sipas normave higjeno-teknike në fuqi;

Tonazhin e Makines teknologjike apo mjeteve të tjera transportuese;

Frekuencën e grumbullimit të mbetjeve;

Sezonin (sezoni i verës njihet për rritje të volumit të mbetjeve)

Koeficenti i mbushjes;

Kapaciteti i kontenierëve

Neni 30

**GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR**

Kryerja e grumbullimit të diferencuar bëhet konform parimeve të përmendura në këtë Rregullores.

Për të mundësuar shërbimin e grumbullimit të diferencuar, do të bëhen publike ndaj përdoruesve, vendndodhja e kontenierëve dhe qendrave të grumbullimit, si dhe mënyrat e ndryshme të kryerjes së shërbimeve.

Përdoruesi, në mënyrë të detyrueshme, do të dorëzoj në mënyrë të ndarë të gjithë mbetjet për të cilat është përcaktuar kryerja e shërbimit të grumbullimit të diferencuar.

Bashkia përcakton:

Mënyrat e dorëzimit nga përdoruesi, i mbetjeve dhe fraksioneve për t'u grumbulluar;

Mënyrat dhe frekuencat e grumbullimit në funksion me franksionet e ndryshme;

Mënyrat e dhënies hua të kontenierëve, përdoruesve, sipas tipologjive të veçanta;

Kontenierët specifik mund të vendosen brenda hapësirave private në përputhje me Nenin 20 të kësaj rregulloreje.

**Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme**

Mbetjet e riciklueshme përfshin letrën, kartonin, qelqin, plastikën, kanaçet metalike, veshjet, si dhe materiale të tjera të konsideruar si të rekuperueshme. Për këto lloje mbetjesh mund të përcaktohen mënyra grumbullimi të ndryshme, nëpërmjet grumbullimit "derë më derë" ose nëpërmjet kontenierëve.

Kontenierët e caktuar për këto lloj mbetjesh do të vendosen në mënyrë të tillë, që të bëjnë të mundur dorëzimin nga ana e përdoruesve të të gjitha materialeve të sipër shënuar në të njëjtën pikë grumbullimi, që konfigurohet si "shesh ekologjik".

Për përdoruesit që prodhojnë sasi të mëdha të këtyre mbetjeve, si shkolla, shtëpi pushimi ose komunitete, aktivitete ekonomike ose te ngjashme, mund të organizohet një shërbim grumbullimi më kontenierë të përshtatshëm për objekte apo godina specifike.

Përkufizohet "grumbullim multimaterial", grumbullimi i përbërsave të ndryshëm (p.sh qelq – kanaçe, ose qelq-kanaçe-plastikë) që mund të mblidhen në një lloj kontenieri të vetëm, për t'u ndarë më pas në mënyrë mekanike gjatë fazave të tjera të rekuperimit.

**Grumbullimi i mbetjeve të paricklueshme**

Këto mbetjepërfshijnë, llojet e mbetjeve në vijim: hedhurina ushqimore nga gatimet, mbetje (teprica) ushqimesh, ushqime të prishura, levozhga vezësh, hedhurina perimesh dhe frutash, llumra kafeje, filtra të çajit, lule të vyshkura dhe bimë shtëpiake, letër prej celuloze të pastër, hi të fikur nga furrat, sobat apo oxhaqet, kocka të vogla, dhe gjëra të ngjashme.

**Grumbullimi i mbetjeve të vëllimshme**

Mbetjet voluminoze,si janë klasifikuar në Nenin 6, mund të dorëzohen dhe grumbullohen,me mënyrat e përcaktuara nga Bashkia, si më poshtë vijojnë:

nëpërmjet grumbullimit pranë përdoruesit, me anë të telefonimit të administratorit;

nëpërmjet grumbullimit derë më derë, e kryer me frekuencëminimale mujore;

nëpërmjet dorëzimit pranë Qendrave të Multigrumbullimit.

**Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme**

Grumbullimi i mbetjeve fuqimisht të rrezikshme, të prodhuara nga ekonomitë familjare, kryhet me kontenierë të përshtatshëm, të vendosur në territorin bashkiak, të ndryshëm sipas tipologjive homogjene të mbetjeve.

Kontenierët mund të vendosen pranë shitësve të të mirave prej nga vijnë këto lloj mbetjesh ose kryhen shërbime në këto subjekte tregtare.

## KREU VI QËNDRA(T) E MULTIGRUMBULLIMIT / VEND-DEPOZITIMIT

Neni 31

### HAPJA E QËNDRAVE TË MULTIGRUMBULLIMIT

Mbetjet mund të dorëzohen në ditët dhe oraret e vendosura nga Administratori dhe të paraqituar me sinjalistikën përkatëse, në hyrje të Qendrës Grumbulluese.

Neni 32

### QËNDRAT E MULTIGRUMBULLIMIT

Qendrat e Multigrumbullimit janë pika grumbullimi të ruajtura, të destinuara për dorëzimin e materialeve të rekuperueshme, të rrezikshme ose voluminoze të mbetjeve urbane. Këto qendra përcaktohen nga Bashkia në zona përshtatshme, të pajisuara me infrastrukturën e nevojshme.

Qendrat e Multigrumbullimit kanë si qëllim atë të promovimit, duke shqyrtuar kriteret ekonomike dhe të efiçencës, të sistemeve me prirje drejt rikuperimit nga mbetjet të materialeve dhe energjisë.

Llojet e mbetjeve që grumbullohen pranë Qendrave të Multigrumbullimit duhet të tregohen në tabelat sinjalizuese përkatëse të vendosura në hyrje tyre, të shprehura si më poshtë vijon:

bimore;

dru;

letër dhe karton;

qelq;

metale;

të mira të qëndrueshme;

voluminoze;

plastika;

bateri, pila;

ilaçe të skaduara;

mbetje fuqimisht të rrezikshme (me prejardhje shtëpiake);

akumulator plumbi (me prejardhje shtëpiake);

vajra minerale dhe bimore të papërdorshëm (me prejardhje shtëpiake);

pneumatik (me prejardhje shtëpiake);

inerte nga prishjet, ndërtimet dhe gërmimet (me prejardhje shtëpia

Bashkia, ka të drejtën e prezantimit ose modifikimit, në çfarëdolloj momenti, të grumbullimit të diferencuar për llojet e ndryshme të mbetjeveqë do të pranohen në Qendrat e Grumbullimit.Në rastet kur kryhen shërbime plotësuese për grumbullimin e mbetjeve speciale të përbërë nga materiale të pranueshme në Qendrat e Multigrumbullimit, prodhuesit e tyre mund t'i dorëzojnë ato sipas një

marrëveshje, kontrate, të lidhur në respekt të kushteve të përmendura në këtë rregullore.Përdoruesit jo shtëpiak mund të dorëzojnë mbetjet e tyre pranë Qendrave të Grumbullimit vetëm me autorizim të lëshuar nga Bashkia, pas një kërkese të paraqitur më parë nga përdoruesi. Bashkia ka të drejtën e përcaktimit, nëpërmjet masave paraprake, të mënyrave me anë të të cilave përdoruesit jo shtëpiak duhet të marrin pjesë në shpenzimet e Qendrës në funksion të llojit të mbetjes dhe sasisë së mbetjes së dorëzuar.

## KREU VII TARIFAT

Neni 33

### OBJEKTI I TARIFËS

Tarifat vilen për pastrimin e Njësisë Administrative, për vënie në gjendje pune dhe përdorimin e impianteve për largimin, transportin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve.

Neni 34

### TAKSAPAGUESIT

Niveli i tarifës përcaktohet me një vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak.

Vendosja e tarifës së pastrimit, pagesa dhe vjelja e saj kryhen sipas vendimit te Keshillit Bashkiak për tarifën e pastrimit.

Bashkia mund të aplikojë tarifa të ndryshme sipas llojeve të ndryshme të prodhuesve, duke u bazuar në shërbimin që përfitojnë, sasisë dhe llojit të mbetjeve që gjenerojnë. Mund të aplikohen gjithashtu pagesa shtesë mbi tarifat për biznese të veçantë ku lloji dhe sasia e mbetjeve që prodhojnë nuk mund të përballohet nga shërbimi publik i mbledhjes së mbetjeve.

Për këto biznese mund të aplikohen zbritje të tarifës nëse marrin vetë përsipër largimin e mbetjeve. Në këtë rast mund të aplikohet vetëm tarifa për depozitimin e mbetjeve në fushat e trajtimit të tyre.

Per çdo ndryshim te mases se taksave shpallet nje vendim ndryshimi. Afati i tarifës së re përcaktohet në vendimin e ndryshimit. Mbipagesat trashegohen.

Neni 35

### VJELJA E TARIFËS[5]

Tarifa e pastrimit vilet nga autoritetet e bashkisë për mbulimin e shpenzimeve të mbledhjes, largimit e trajtimittë mbetjeve dhe pastrimin e Njësisë Administrative.

Autoritetet e bashkisë duhet të përcaktojnë vetë ose mund të ngarkojnë një palë të tretë, me përllogaritjen e tarifave, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për këto tarifa, marrjen dhe transferimin e tyre,

[5] Referoju Aneksit 5 për:Kategoritë e tarifave sipas llojit të subjekteve

lëshimin e vërtetimeve për autoritetet e bashkisë, përpunimin e të dhënave të kërkuara dhe vënien në dijeni të autoriteteve.

## KREU VIII KONTROLLI, NDALIMET DHE SAKSIONET

Neni 36

### KONTROLLI, OBJEKTI I KONTROLLIT DHE FUNKSIONIMI

Përveç kompetencave të Organizmave përgjegjëse me ligj për kontroll, Bashkia aktivizon mbikëqyrjen për të respektuar Rregulloren duke aplikuar sanksione administrative të parashikuara nga normativat në fuqi.

Autoritetet e caktuara për kontroll janë të autorizuara të kryejnë të gjitha inspektimet që mendojnë të nevojshme për të vërtetuar respektimin e normave të caktuara në rregullore.

Bashkia ka të drejtën të kërkojë nga prodhuesit e mbetjeve speciale të paraqesin dokumentacionin vërtetues të përpunimit që kryhet.

Në rastet e vërtetimit për mos respektimi të rregullores, Bashkia nëpërmjet një urdhërese të motivuar nga arsye sanitare, higjenike dhe mjedisore, vendos kryerjen e punimeve të nevojshme, barrë kjo në ngarkim të subjektit përgjegjës për ndotje. Gjithashtu urdhëron adaptimin e masave oportune për të parandaluar përsëritjen e mosrespektimit të rregullores, si dhe marrjen e masave penalizuese sipas normativave në fuqi.

Në rastet e lënies së mbetjeve në hapësirat publike ose për përdorim publik, ku nuk është identifikuar subjekti përgjegjës për ndotje, Bashkia kryen me shpenzimet vetjake grumbullimin e mbetjeve dhe përpunimin e mëtejshëm.

Neni 37

### NDËRVEPRIMI ME STRUKTURAT E BASHKISË DHE PALËT E TJERA[6]

Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, për fushën e tyre të përgjegjësisë, informojnë me shkrim organet e qeverisjes qendrore për çdo çështje që u kërkohet informacion. Organet e qeverisjes qendrore, kur kërkohet nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, japin informacion, sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikat dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.

Ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për funksionet e deleguara kanë të drejtë t'i mbikëqyrin ato.

Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim. Bashkia gjithashtu ka për detyrë që tëjapë përgjigje apo përcjelle shqetesimet e publikut në organet përkatëse.

[6] Referoju Aneksit 6 për: Formularë komunikimi dhe raportimi për ndërveprimin me strukturat e Bashkisë dhe palët e tjera

Neni 38

**NDALIME DHE DETYRIME**[7]

Shkeljet ndaj Rregullores ndërshkohen sipas akteve ligjore e nenilgjore në fuqi dhe siç është përcaktuar në Rregullore.

Përveç ndalimeve të shpehura qartë në nenet e Rregullores:

është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin bashkiak, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurta, gjysëm e ngurta, e lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensioni, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjt, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve, etj.

është e ndaluar dorëzimi i mbeturinave në vendet e zbuluara të hapsirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.

cilido shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryej largimin e mbetjeve. Ky veprime duhet të kryhetnga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i Bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese, operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar;

është e ndaluar për qytetarët dhe për këdo person të pautorizuar, të kryej çdo lloj selektimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, gërmimi apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë, ose pranë impianteve të rekuperimit dhe përpunimit final;

në rastet e shërbimit të grumbullimit "derë më derë" është i ndaluar ekspozimi i qeseve dhe/ose kontenierëve shtëpiak që kanë mbetje, përgjatë rrugës së grumbullimit, në ditë të ndryshme dhe jashtë orareve të përcaktuara nga Bashkia;

është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;

është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit;

është i ndaluar dorëzimii mbetjeve voluminoze që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensioni, përbërja dhe karakteristika të tjera që mund t'i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin;

është e detyrueshme për të gjithë llojet e prodhuesve dhe mbajtësve të mbetjeve urbane, objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rekuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto materiale në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respektive;

është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdoruara për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo pëmbysja,

[7] Referoju Aneksit 7 për: Formularë të procedurës së ndalimeve dhe detyrimeve

janë të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes;

është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti, shishe dhe të ngjashme);

është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;

është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit të mbetjeve speciale për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme;

Djegia e mbeturinave në kazan, rreth tyre dhe në çdo ambjent tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.

Ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kazanëve e në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbeturinave e ushqimeve për kafshët si mbeturina buke, etj.

Nuk pranohet e drejta për kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e Bashkisë.

Neni 39

**SANKSIONET[8]**

Ndaj personave fizikë dhe juridikë që nuk respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, zbatohen sanksionet e legjislacionit në fuqi.

Mosrespektimi i kësaj rregulloreje dënohet sipas URDHËRESËS PUBLIKE Nr._____ Datë _____.

## KREU IX MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Neni 40

**DETYRIMET PËR INFORMIM TË PUBLIKUT**

Bashkia bën publike skemën e pastrimit, oraret e pastrimit dhe oraret e preferueshme për dorëzimin dhe largimin publik të mbeturinave.

Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e vend-depozitimeve për njësi kompostimi dhe për shfrytëzimin e tyre, ftohen të marrin pjesë OJF-të mjedisore dhe publiku i interesuar.

Kushdo ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të largimit publik të mbeturinave sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara për këtë çështje.

Personat fizikë e juridikë që janë angazhuar në largimin publik të mbeturinave, që kanë dhe përdorin vend-depozitime apo njësi te kompostimit, publikojnë të dhënat që u rezultojnë nga monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive të tyre, jo më rrallë se një herë në tre muaj.

[8] Referoju Aneksit 8 për: Referenca dhe detaje mbi Sanksionet

Neni 41

## PROCEDURAT E ANKIMIMIT DHE EKZEKUTIMI I MASAVE[9]

Marrja e Ankesës dhe Shqyrtimi

Çdo konsumator ka të drejtën e ankimimit me gojë ose me shkrim mbi proçesin e largimit publik të mbeturinave. Fillimisht të gjithë ankesat e klientëve depozitohen tek zyra e informacionit në Bashki dhe adresohen për tek drejtuesi i seksionit të shërbimeve publike.

Pala që kryen shërbimin merr çdo ditë nga seksioni i shërbimeve listën e ankesave, e cila përmban llojin dhe burimin e ankesës. Ajo detyrohet të ndreqë shkakun e ankesës brenda 24 orësh. Në rast mosndreqje ajo detyrohet të japë shpjegime pranë drejtuesit të seksionit të shërbimeve brenda këtij afati, lidhur me arsyet e mosndreqjes së shkakut të ankesës.

Zgjidhja e Ankesës

Mosndreqja e shkaqeve të ankesës, kur ato merren parasysh si të drejta konsiderohet shkelje kontrate. Bashkia ka të drejtën të dërgojë një mbikëqyrës për të kontrolluar zgjidhjen e ankesës. Në qoftë se mbikëqyrësi vëren mangësi, ai duhet të njoftojë palën që kryen shërbimin për këto mangësi. Pala duhet të njoftojë Bashkine kur këto mangësi janë plotësuar. Pala duhet të rikontrollojë punën për të parë nëse gjithçka është plotësuar në mënyrë të kënaqshme.

Në qoftë se mbikëqyrësi vëren që mangësitë e njoftuara më parë nuk janë korrigjuar, atëherë shpenzimet për kohën e mbikëqyrësi sipas kostos reale të kësaj kohe, plus kostot e tjera do t'i zbriten palës që kryen shërbimin për çdo inspektim, derisa të gjithë mangësitë e njoftuara të jenë korrigjuar.

Neni 42

## MANIFESTIMET PUBLIKE, PANAIRET, SPEKTAKLET LËVIZËSE DHE VEPRIMTARI TË STINËS[10]

Veprimtaritë e stinës, Entet Publike ose Fetare, Fondacionet apo Shoqatat, Cirqet, Partitë Politike, apo çfarëdolloj grupi qytetarësh që ka për qëllim organizimin e iniciativave si, festa, panaire, festime popullore, vrapime, spektakte lëvizese ose manifestime edhe të llojit kulturor apo sportiv, etj, në rrugë, sheshe dhe hapësira publike apo për përdorim publik, janë të detyruar të sigurojnë direkt, ose nëpërmjet marrëveshje të veçanta me Administratorin, mbajtjen pastër të hapësirave, që i janë dhënë atyre për përdorim, si gjatë ashtu edhe në fund të iniciativës, duke dorëzuar në kontenierët e përshtatshëm të vendosur nga administratori, si mbetjet e prodhuara direkt nga aktiviteti i tyre ashtu edhe ato të prodhuara nga frekuentimi i manifestimit prej qytetarëve.

Detyrimet suplementare të dala nga kryerja e shërbimit publik do t'i ngarkohen organizuesve të manifestimeve.

Neni 43

[9] Referoju Aneksit 9 për: Formularë për ankimimin, adresat dhe mënyrat e adresimit të ankesave

[10] Referoju Aneksit 10 për: Kalendarin dhe faqen zyrtare të aktiviteteve

## FUSHATAT SENSIBILIZUESE DHE INFORMUESE

Bashkia kujdeset për fushatat e nevojshme të edukimit, sensibilizimit dhe stimulimit për bashkëpunimin me komunitetin.

Në mënyrë periodike kryhet një reklamim në masë të gjërë, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasiore të arritura gjatë viteve paraardhës, në veçanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesmarrjen aktive të komunitetit.

Në mënyrë periodike shpërndahet falas një broshurë me orientime, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndryshme, për përdorimin e kontenierëve dhe vendndodhjen e tyre; ndër të tjera do të jepen edhe orientime mbi fraksionet që grumbullohen, mënyrat e dorëzimit, destinacionet e tyre, mbi arsyet, nevojat dhe pretendimet e bashkëpunimit të qytetarëve.

Duhet të promovohen, nga drejtoritë përkatëse në Bashki, sipas rastit në bashkëpunim me personat juridik të përfshirë, fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve me synim specifikimin:

llojet e mbetjeve për të cilat është aktivizuar shërbimi i diferencuar;

qëllimin dhe mënyrat e kryerjes së shërbimeve;

destinacionet e fraksioneve që rekuperohen;

detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve;

Në mënyrë të veçantë promovimi mund të realizohet:

nëpërmjet tabelave pranë pikave të grumbullimit;

nëpërmjet komunikimeve në shtyp;

nëpërmjet fletëpalosjeve të shpërndarë tek pëdoruesit e interesuar;

nëpërmjet formave të tjera të shpërndarjes së materialeve informuese;

Personi juridik, si administrator i shërbimit të grumbullimit është i detyruar të komunikoj çdo lloj ndryshimi në lidhje me mënyrat e kryerjes së shërbimit tek përdoruesit e interesuar me një paralajmërim verbal, minimumi 7 ditë.

Neni 44

## BASHKËPUNIMI ME ORGANIZMA JO QEVERITARE

Në aktivitetin e administrimit të mbetjeve urbane Bashkia mund të shfrytëzoj bashkëpunimin e shoqatave të vullnetarizmit, OJQ-ve, pjesëmarrjes së publikut, etj.

Organizatat jo qeveritare kryejnë kontribute të nevojshme, me qëllim ndihmën në grumbullimin në mënyrën e duhur të mbetjeve, që frymëzohen nga qëllime mjedisore, pa qëllime përfitimi duke përdorur aktivitete vullnetarizmi.

Organizatat jo qeveritare që operojnë pa përfitime mund të përfshihen edhe në grumbullimin e fraksioneve specifike të rekuperueshme të mbetjeve urbane, pas nënshkrimit të marrëveshjeve me Bashkinë, me paraqitjen e kërkesave të nevojshme që tregojnë mënyrat e kryerjes së grumbullimit, llojet e materialeve që grumbullohen dhe destinacioni i tyre, për më tepër edhe mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit me qëllim garantimin e higjenës dhe sigurisë së punës që do të kryhet.

Organizatat jo qeveritare autorizohen nga Bashkia, e cila përcakton vendin dhe mënyrat e ndërhyrjes, etj.

## KREU X DISPOZITAT E ZBATIMIT TË RREGULLORES

Neni 45

### ZBATIMI I RREGULLORES

Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

Organet shtetërore dhe organizatat vendore

Gjithë individët, banorë të territorit të Bashkisë, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezident në territorin e Bashkisë, punonjës në organe e organizma publike e private.

Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregëtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike.

Personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të liçensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave.

Neni 46

### AMENDIMET

Kjo rregulloreje është objekt rishikimi me ose pa amendime çdo herë që ka ndryshime në ligjet dhe aktet nënligjore tek të cilat është bazuar kjo rregullore,apo kemi përditësime të legjislacionit të fushës prej të cilit dispozitat e kësaj rregulloreje mund të ndryshojnë.

Anekset e kësaj rregulloreje janë objekt rishikimi dhe përditësimi nga Bashkia sipas rastit, duke respektuar dispozitat e paraqitura në këtë rregullore.

Neni 47

### HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn nëfuqi njëmuaj pas shpalljes dhe publikimit lokal të saj.

## Aneksi 1 Itinerari dhe levizjet e mjeteve të grumbullimit

### Aneksi 1.1 Itinerari dhe lëvizjet e mjeteve të Grumbillimit

Lëvizja e Mjeteve bëhet sipas itinerarit të përcaktuar në hartat e aneksit 1 në oraret e caktuara nga Bashkia sipas kushteve te përcaktuara në këtë rregullore.

| Lloji i Mjetit | Nr. i rrugëve | Nr. i Kazanëve | Kapaciteti (Ton) | Orari i Aktivitetit | Emërtimi i rrugëve ku behet largimi i mbeturinave |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |


### Aneksi 1.2 Detaje mbi rrugët që fshihen dhe lagen

| Nr. | Emertimi i rrugës | Rrugë | | | Trotuar | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjatësia ml | Gjerësia ml | Sipërfaqja $m^2$ | Gjatësia ml | Gjerësia ml | Sipërfaqja $m^2$ |
| 1 | Rruga “Minatori” | 346 | 6 | 2076 | 329 | 6 | 1974 |
| 2 | Bulevardi “Rinia” | 305 | 6 | 1830 | 300 | 8 | 2400 |
| 3 | Rruga “Blerimi” | 370 | 6 | 2220 | 346 | 4 | 1384 |
| 4 | Rruga “Qybra Sokoli” | 340 | 5 | 1700 | 332<br>322 | 1.5<br>2.5 | 498<br>805 |
| 5 | Rruga“Demokracia” | 421 | 6 | 2526 | 354<br>67 | 4<br>1.1 | 1416<br>73.7 |
| 6 | Rruga “10 Nentori” | 150 | 6 | 900 | 146 | 4 | 584 |
| 7 | Rruga “1 Maji” | 150 | 6 | 900 | 146 | 5 | 730 |
| 8 | Rruga “Halit Berzeshta” | 406 | 6 | 2436 | 404 | 3 | 1212 |
| 9 | Rruga “Domosdova” | 201 | 10 | 2010 | 200 | 4 | 800 |
| 10 | Rruga “Muhamet Kadia” | 513 | 6 | 3078 | 513 | 2 | 1026 |
| 11 | Rruga | 327 | 5.6 | 1832 | 325 | 1.5 | 487.5 |


| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | "Gjorg Golemi" | | | | | | |
| 12 | Rruga "Skenderbeu" | 202 | 6 | 1212 | 198 | 2 | 396 |
| 13 | Rruga e brendshme M-B | 163 | 6 | 978 | 159 | 2 | 318 |
| 14 | Rruga e brendshme M-B | 144 | 4.2 | 605 | 140 | 2 | 280 |
| 15 | Rruga Nacionale | 140 | 1 | 140 | 140 | 8 | 1120 |
| 16 | Qendra e Qytetit | | | 6288 | | | |
| 17 | Trotuari "Rr:Nacionale | | | | | | 3182 |
| Shenim: siperfaqja totale rruge +trotuare =49 416 m² | | | | | | | |

Aneksi 2 Skema e monitorimit dhe raportimit

Aneksi 2.1 Skema e raportimit dhe ankesave




Aneksi 3.2 Skema e monitorimit


Sherbimet publike
raporton çdo muaj
tek Zv. Kryetari ose Kryetari
Supervizori
raporton çdo jave
Sherbimet publike
Administratori
raporton çdo jave
Supervizori
kryeplaku
raporton çdo dite
Administratori
Kompania
raporton çdo muaj
Supervizori

Aneksi 3.3 Procesverbal mbi kryerjen e punimeve

**PROÇES-VERBAL**

I mbajtur sot më date dd/mm/vvvv mbi marrjen në dorëzim të zërave të shërbimeve të kryera në Sektorin e Pastrimit.
Proçes-verbali mbahet në presence të Administratorit ligjor Z.(Administratori) firmes dhe Mbikëqyrësit Z.(Mbikëqyrës).
Zërat e shërbimeve të kryera janë si më poshtë vijon:

**I- Sektori i Pastrimit**

1-Pastrim dhe fshirje të rrugëve të asfaltuara me sipërfaqe X m2.
2-Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane X ton.
3-.....
4-.....
5-.....
6-.....

Sa mësipër palët bien dakort dhe nëshkruajnë rregullisht për zërat e shërbimeve të kryera.
Proçes-verbali mbahet në dy kopje për efekt dokumenti.

**Administratori ligjor** **Mbikëqyrësi**

_____ _____

Aneksi 3.4 Procesverbal për zbritjen e pagesës për punime të pakryera

**PROCESVERBAL**

**PËR ZBRITJEN E PAGESËS PËR SHËRBIME TË PAKRYERA**

I mbajtur më *dd/mm/vvvv* midis kontrollorit të kontratës së sipërmarrjes të Sektorit te Pastrimit (*mbikëqyrësi)* nga njëra anë (*administratori ligjor*) i firmës private *"X''* nga ana tjetër.

Proçesverbali mbahet për zbritjen e pagesës *(Sipas zërit përkatës),*kur nuk kryhet shërbimi.

Gjatë verifikimit që u krye nga ana jonë rezultoi:

*(Përmbajtja)*

_____
_____
_____
_____

*(Vlera/lekë)*

_____
_____
_____

Sa mësipër palët ranë dakord dhe proçesverbali u nënshkrua rregullisht nga të pranishmit.

Proçesverbali u hartua në *X* kopje të cilat i dërgohen për miratim Kryetarit te Bashkisë_____
_____

**Administratori ligjor** **Mbikëqyrësi**

_____ _____

Aneksi 3.5 Format tip Situacioni Mujor

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA PRRENJAS**

**(EMËRTESA E STRUKTURËS)**

Nr_____prot Prrenjas, më dd/mm/vvvv

SITUACION MUJOR

SITUACION Nr.xxx

**Lenda:** Për punimet e kryera në sektorin e Pastrimit për muajinX

| Nr | Përshkrimi i punimeve | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fshirje rruge sheshe e trotuare | $m^2$ | | | |
| 2 | Grumbullim transport mbeturine | ton | | | |
| 3 | Lagie rruge | dite | | | |
| | Shuma | | | | |

MBIKËQYRËSI PËR FIRMËN ADMINISTRATORI

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

Aneksi 3.6 Format tip Raport Kontrolli i Kontratës së Sipërmarrjes

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

**(EMËRTESA E STRUKTURËS)**

Nr_____Prot Prrenjas, më dd/mm/vvvv

**Lënda:** Raporti i mbikëqyrësit të kontratës së sipërmarrjes së sektorit "mirëmbajtje me sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit, grumbullimit dhe evadimit të mbeturinave urbane për muajin X.

Drejtuar:KRYETARIT TË BASHKISË

FIRMËS PRIVATE "X"

Kompania e pastrimit për muajin X u mobilizua, duke angazhuar forcat, mjetet e punës dhe bazën e nevojshme materiale për kryerjen e zërave të shërbimeve në sektorin e pastrimit.

Gjatë këtij muaj në këtë sektor u realizuan këto punime:

Fshirja e rrugëve, shesheve e trotuareve të asfaltuara gjatë gjithë muajit në një siperfaqe prej X m2 sipas planit.

Grumbullimi e transporti i mbeturinës urbane në sasinë gjithsej X ton,për çdo ditë në zonën qëndrore urbane të Njësisë Administrative X dhe X herë në muaj në zonën periferike, si dhe u krye dezinfektimi venddepozitimeve me gëlqere pluhur.

U krye sistemimi i mbeturinave urbane në venddepozitimin nga vetë firma X herë gjatë këtij muaji.

U krye lagia e rrugeve nga X ditë të planifikuar X ditë të realizuara si rrjedhoje e plotësimit të diteve të zbritura të muajit kaluar.

Theksojmë se dhe për këtë muaj me gjithë ndërhyrjet në venddepozitim për sistemimin e mbeturinave urbane nga ana e firmës së pastrimit por dhe nga ana e Bashkisë fusha e depozitimit mbetet problem shqetësues për depozitimin e mbetjeve në të ardhmen.

Punimet e realizuara këtë muaj u kryen në kohë sipas planit e detyrave që janë caktuar në kontratën përkatëse, lidhur midis Bashkisë e Firmës X.

Për punimet e realizuara gjatë këtij muaji u përdor kjo bazë materiale:

Fshesa melakuqe nga X cope plani,në fakt X copë.

Naftë nga X litra plani u përdoren X litra.

Uji nga X m3 plani u përdorën X m3.

Gëlqere, nga X kg plani u realizuan X kg.

Goma nga X copë planifikuar, jane realizuar X copë

Ndotje të ambientit nga kafshët sidomos ditët e pazarit, e qentë rrugaçë që qarkullojnë në teritorin e Njësisë Administrative, të cilët janë bërë problem e shqetësim për banorët.

Ndotje nga qarkullimi i mjeteve ku ka ndalim qarkullimi dhe i mjeteve të tonazheve të rënda që

qarkullojnë me material rrjedhëse nga spondet e tyre.

Si çdo muaj edhe për muajin X problem në ndotje mbetet hedhja e mbeturinave inerte e urbane vend e pavend nga qytetarë, familjarë, biznese, tregtarë etj.

Në teritorin e Njësisë Administrative edhe gjatë këtij muaji u vunë re nëpër vende të ndryshme

mbeturina inerte e dhera të cilat janë evaduar pjesërisht nga firma X dhe pjesërisht nga sektori i shërbi-meve publike.

Për këtë problem vazhdimisht gjatë ketij muaji kemi mbajtur korespondencë të vazhdueshme me

Policinë Bashkiake ku për disa raste të konstatuara janë marë dhe masa me gjobë.

Ketij raporti i bashkëngjitet:

Proces-verbali i zbritjes së proçesit të fshirjes së rrugëve, shesheve e trotuarëve.

Proçes-verbali i zbritjes së ditëve të procesit të lagies së rrugeve.

Situacioni i punimeve të muajit X.

Ky raport u shtyp në pesë kopje të cilat i dërgohen për miratim Kryetarit të Bashkisë, dhe pas

miratimit dy i jepen X, një qëndron në arkiv, një Specialisti i punimeve me sipërmarrje dhe një firma private X".

Mbikëqyrësi i Kontratës

_____

Konceptoi: Mbikëqyrësi

Pranoi:Pergjegjesi

Konfirmoi: Juristi

Miratoi: Drejtori

Dosja nr:_____

Afati i ruajtjes:

Aneksi 3.7 Format tip Analizë vjetore e Kontratës së Sipërmarrjes

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

**(EMËRTESA E STRUKTURËS)**

Nr_____prot Prrenjas, më dd/mm/vvvv

ANALIZË

MBI PUNËN E BËRË DHE PROBLEMET QË KANË DALË NË REALIZIMIN VJETOR TË KONTRATAVE TË SEKTORËVE ME SIPËRMARRJE TË PASTRIMIT TË BASHKISË PËR VITIN X

Gjatë vitit xxxx në sektorët me sipërmarrje u punua në bazë të kontratave të lidhura midis Bashkisë e kompanisë private me sipërmarrje "X", në planet vjetore të buxhetit e bazës materiale, inventareve përkatëse e planet e punës mujore, urdhërat e vendimet e Kryetarit të Bashkisë, detyrat e drejtorisë së shërbimeve, aktet ligjore e n/ligjore që kanë të bëjnë me këta sektorë.

Puna e bërë në sektorin e pastrimit është përqëndruar në këto drejtime kryesore:

Në forcimin e kontrollit të përditshëm ndaj firmës private për plotesimin e detyrave Kontraktore, e përdorimin me efektivitet të fondevetë vëna në dispozicion tëkëtyre sektorëve.

Në rritjen e bashkëpunimit me policinë bashkiake inspektoriatin policis, sanitar, të mjedisit e sektorin komunal,zyrat e komunitetin.

Në rritjen e eficencës e mirëadministrimit të burimeve materiale e financiare në sektorët përkatës.

Në njohjen e zbatimin e ligjshmërisë, udhëzimet e Ministrisë e vendimet e urdhërat e Kryetarit te Bashkisë dhe detyrat e dhëna nga Drejtori i Shërbimeve.

Gjatë kësaj periudhe vjetore në sektorin e pastrimit janë realizuar këto zëra shërbimesh:

Fshirja e rrugëve ,shesheve e trotuarëve tëasfaltuar X m2 siperfaqe totale. Defakto siperfaqja reduktohet në X m2, pasi zbriten X m2 nga sipërfaqja totale që i takojnë rrugës X si rrjedhoj e rehabilitimit që po i bëhet kësaj rruge.

U krye grumbullimi e transporti i mbeturinës urbane në X ton,nga X ton plani. Grumbullime transporti kryer çdo ditë në Zonën qëndrore urbane të Njësisë Administrative X,e X herë në muaj në lagjet periferike, si dhe dezinfektimi me pluhur gëlqere i kontinierëve metalike në zonën qëndrore e periferike, dezinfektim i cili filloi në muajin X e përfundoi në muajin X sipas kontratës.

U krye gërryerja e anëve të rrugëve të asfaltuara e trotuarëve nga llumrat e barërat disa herë gjatë kësaj periudhe në të gjithë territorine Njësisë Administrative.

U krye mbulimi e ngjeshja e mbeturinës në fushën e shkarkimit të mbeturinave gjatë gjithë periudhës procesi cili ka vazhduar e vazhdon te kryhet nga ana e firmes ‘X”.

U krye lagia e rrugëve të asfaltuara,shesheve e trotuarëve gjatë kësaj periudhe kohore nga X ditë plani në X ditë fakti.

Gjatë kësaj periudhe një rëndësi e vecantë i është kushtuar edukimit publik,ku në këtë drejtim për X.

Firma“X” u/nuk u mobilizua me të gjitha forcat e bazën e nevojshme materiale në drejtim të pastrimit në teritorin e qytetit.

Në bazë të kontratës për sektorin e pastrimit në tabelën më poshtë janë pasqyruar treguesit financiar. Shpenzimet e buxhetit në sektorin e pastrimit për këtë periudhë vjetore janë si më poshte :

| **Nr** | **Pershkrimi** | **Plani** | **Realizimi faktik** |
|---|---|---|---|
| 1 | Fshirje rruge, sheshe e trotuare | | |
| 2 | Grumbullim e transport mbeturine | | |
| 3 | Lagierrugee trotuare | | |
| 4 | Amandament shtesë pagash | | |
| | **Totali** | | |

Në këtë sektor janë planifikuar X lekë në fakt janë realizuar X leke me diference X leke me pak. Kjo diferencë i përket zbritjes së sipërfaqes së fshirjes së rrugëve, prej X m2 rrugë e tregut industrial.

Në vazhdim në sektorët me sipërmarrje dalin këto detyra:

Rritja e nivelit të kontrollit ndaj firmës si në zbatimin e kontratave ashtu edhe në përdorimin me efektivitet të fondeve për çdo sektor.

Bashkëpunimi me Policinë Bashkiake, Inspektorin e Mjedisit, Inspektorin sanitar, agjensine e shërbimeve publike.

Zgjidhja e kërkesa—ankesave të qytetarëve për problemet më shqetësuese që kanë sektorët me sipërmarrje.

Njohja e zbatimi i ligjeve, udhëzimeve, urdhërat e vendimet e Kryetarit të Bashkisë, detyrat e Drejtorisë së Shërbimeve.

Rritja e performancës në sektorët me sipërmarrje nepërmjet rritjes së efiçencës e mirëadministrimit të burimeve materiale e financiare.

Këto ishin disa nga problemet dhe mendimet që trajtuam në këtë material, të cilat do të jenë objekti i punë sonë përvitin X

Mbikëqyrësi i Kontratës

_____

Konceptoi: Mbikëqyrësi

Pranoi:Pergjegjesi

Konfirmoi: Juristi

Miratoi: Drejtori

Dosja nr:_____

Afati i ruajtjes:

## Aneksi 4 Formularë komunikimi dhe raportimi për ndërveprimin me strukturat e Bashkisë dhe palët e tjera

Organet e Njësive Vendore kanë për detyrim ligjor informimin me shkrim të organeve të qeverisjes qëndrore sa herë që u kërkohet informacion. Gjithashtu Njësitë Vendore kanë korrespodence me palë të tjera si grupe interesi, OJQ, publikun etj. Formati tip i korrespodencave zyrtare është paraqitur në aneksin 6.1 dhe aplikohet për të gjitha shkresat/raportimet, përvecse në rastet kur institucionet e tjera si psh INSTAT kanëformatet e tyre të detyrueshme për shkresat/raportimet.

## Aneksi 5.1 Formular Shkrese Model

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PRRENJAS**
**(EMËRTESA E STRUKTURËS)**

Nr_____prot. Prrenjas, më____/___/_____

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit në mënyrë të përmbledhur, sa më të qartë dhe konçize por nuk lejohen shënimet *''dërgohet një shkresë*", "*përcjellje shkrese*", "*për kompetencë*", "*përcjellje për mendim*" si dhe shkurtime të tjera të kësaj natyre).

Drejtuar: **(EMËRTIMI I PLOTE NË RASËN DHANORE, ME GËRMA KAPITALE,**
**(Emërtimi i vendit ku ka selinë institucioni të cilit i dërgohet)**

**Për dijeni**: (në rastet kur janë institucione të tjera për dijeni shënohet emërtesa dhe vendi ku ka selinë institucioni, njësoj si më sipër).

Në vijim/ Në përgjigje suajës nr._____, datë __.__._____/ tonës me nr._____, datë __.__._____,
.....
.....
.....
.....

**KRYETARI I BASHKISË**
**_____**

Konceptoi:
Pranoi:
Miratoi:
Konfirmoi:
Dosja nr:_____

Afati i ruajtjes: _____

## Aneksi 6 Formularë të procedurës së ndalimeve dhe detyrimeve

Drejtoria e shërbimeve ka detyrën e informimit të organeve ligjzbatuese në rast të konstatimit të kundravajtjeve ligjore. Organet ligjzbatuese si psh policia Bashkiake kanë për detyrë që për këto kundravajtje të hartojnë aktkontrollet dhe të aplikojnë gjobat apo masat e tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Aneksi 7.1 Akt Kontrolli

**BASHKIA PRRENJAS**
**POLICIA BASHKIAKE**

# AKT-KONTROLLI

I mbajtur sot më datë _____,në subjektin me përfaqësues Z/Znj_____

Me aktivitet _____.

Adresa:_____,Prrenjas,në të cilën rezultoi se:

_____
_____
_____
_____

Për sa mësipër,urdhërojmë:

_____
_____
_____
_____

Për mos zbatim urdhëri do të merren masat sipas ligjit Nr.8224,date 15.05.1997 "Për Policinë Bashkiake" i ndryshuar si dhe Ligjit Nr.10279,date 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative''

**PËR SUBJEKTIN**
_____

**PËR POLICINË BASHKIAKE**
_____
_____

Aneksi 7.2 Fletë Gjobe

**BASHKIA PRRENJAS**
**POLICIA BASHKIAKE**

# FLETË-GJOBE

Mbajtur sot më datë _____,nga unë _____punonjësi i Policisë

Bashkiake,pasi konstatova kundravajtjen si më poshtë:

_____
_____

Data _____ Ora _____

Në mbështetje të Ligjit të Policise Bashkiake Nr.8224,datë 15.05.1997 i ndryshuar me Ligjin Nr.8335,datë 23.04.1998,Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr._____,datë _____ dhe në mbështetjet e Ligjit Nr.83787,date 22.07.1998" Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë,(i ndryshuar),nenet 2,15,16,17 dhe 22 të tij; Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, "Për largimin publik të mbeturinave",

**VENDOSA**

1.Të gjobisë kundravajtësin _____ ,drejtuesi mjetit _____ me gjobë prej(_____)lekë.
2.Kundravajtësi është i detyruar të paguajë gjobën brenda 5 ditëve në arkën e bashkisë.
3.Për çdo ditë vonesë,deri në një muaj gjoba paguhet me kamatën 2%,mbas një muaji për vjeljen e gjobës zbatohet ligji "Përkundravajtjet administrative".
4.Për automjetet,në rast mospagimi,bëhet bllokimi i mjetit deri në shlyerjen e saj.
5.Të gjitha subjektet dhe individet për gjobat e marra, Brenda 5 ditëve kanë të drejtën e ankimit tek Kryetari i Bashkisë.

GRUPI I KONTROLLIT
_____

KUNDRAVAJTËSI
_____

## Aneksi 8 Referenca dhe detaje mbi Sanksionet

Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje, në rastin që nuk përbën shkelje penale, përbën shkelje administrative dhe dënohet sipas ligjeve të poshtëshënuara dhe akteve nënligjore të tyre:

Ligj Nr.10463 date 22.9.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”

Ligji 9010 “Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”

Ligji nr. 8094/1996 “Për largimin publik të mbeturinave”

Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”i ndryshuar

Ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqiperise”

Niveli i gjobave sipas paketës fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Aneksi 9 Formularë për ankimimin, adresat dhe mënyrat e adresimit të ankesave

Aneksi 9.1 Formular Ankese

| |
|---|
| Nr._____prot. |
| Datë ____/____/_____ |
| Bashkia Prrenjas |

Nr._____Ankesës

ANKESË

BASHKISË PRRENJAS

Une i nënshkruari/a_____banues/e në adresë _____

Nr.tel_____Cel._____dhe dokument identifikimi_____nr _____

**Bazuar në:**Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin 119/2014 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" Ligjin Nr.8094 datë.21.03.1996 "Për Largimin Publik të Mbeturinave;

***Ankohem:***_____

_____

_____

_____

***Ankesën time e bazoj në arsyetimin se :*** _____

_____

_____

_____

Bashkëlidhur do të gjeni dokumentat e poshtëshënuara :

1. _____

_____

_____

_____

_____

Ankuesi_____

Firma Prrenjas më datë__/__/_____

VËRTETIM

Sot më datë _____/_____/_____ qytetari, (ose subjekti) _____ _____

Paraqiti pranë institucionit tonë ankesën për_____ _____ _____.

Specialisti

_____

(nënshkrimi)

Aneksi 9.2 Formular Kërkese Model 1

| |
|---|
| Nr._____prot. |
| Datë ____/____/_____ |
| Bashkia Prrenjas |

Nr._____Ankesës

ANKESË

BASHKISË PRRENJAS

Une i nënshkruari/a_____banues/e në adresë _____

Nr.tel _____Cel._____dhe dokument identifikimi_____nr_____

**Bazuar në:**Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin 119/2014 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" Ligjin Nr.8094 datë.21.03.1996 "Për Largimin Publik të Mbeturinave;

***Kërkoj:*** _____

_____

_____

_____

***Kërkesën time e bazoj në arsyetimin se :*** _____

_____

_____

_____

Bashkëlidhur do të gjeni dokumentat e poshtëshënuara :

1. _____

_____

_____

_____

_____

Ankuesi_____

Firma Prrenjas më datë__/__/_____

VËRTETIM

Sot më datë _____/_____/_____ qytetari, (ose subjekti) _____
_____

Paraqiti pranë institucionit tonë ankesën për
_____
_____

Specialisti

_____

(nënshkrimi)

Aneksi 9.3 Formular Kërkese Model 2

KËRKESË

Unë i/e nënshkruari/a **Emer, Atësi, Mbiemër**, banues/e në lagjen "_____" , rruga ___, pallati nr._____, ap.___, shkalla ____, Bashkia Prrenjas, me numer identiteti NID: _____, nr kontakticel:_____.

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative;Ligjin 119/2014 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit Ligjin Nr.8094 date.21.03.1996 "Për Largimin Publik të Mbeturinave"

KËRKOJ:

Kërkesën time e bazoj në arsyetimin: Heqjen e mbetjeve urbane në lagjen _____, rruga _____, Prrenjas.

Aktualisht banoj ne lagjen "_____",rruga____, pallati nr._____, ap.___, shkalla ____,Prrenjas dhe kërkoj nga Bashkia Prrenjas, Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit, Specialistet e fushës, heqjen e mbetjeve urbane në lagjen _____, rruga _____,

KËRKUESI

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)

Plotësohetnga specialisti i pranimit

MARRËSI NË DORËZIM

(Pozicioni i punës)

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)

Kërkesa i drejtohet: Sektorit të Mbrojtjes së Mjedisit

Kërkesa përpilohet në dy kopje te barasvlefshme, ku pasi protokollohet një kopje i jepet kërkuesit.

## Aneksi 10 Kalendari dhe faqja zyrtare e aktiviteteve

### Aneksi 10.1 Kalendari i Festave Kombëtare dhe Festave të Bashkisë

| | |
|---|---|
| 01 Janar | Festa e Vitit të Ri |
| 02 Janar | Festa e Vitit të Ri |
| 14 Mars | Dita e Verës |
| 22 Mars | Dita e Novruzit |
| 21 Prill | E diela e Pashkëve Katolike |
| 28 Prill | E diela e Pashkëve Ortodokse |
| 01Maj | Dita Ndërkombëtare e punëtorëve |
| 05 Qershor | Dita e Bajramit të Madh |
| 12 Gusht | Dita e Kurban Bajramit |
| 05 Shtator | Dita e Shenjtërimit të Nënë Terezës |
| 28 Nentor | Dita e pavarsisë |
| 29 Nentor | Dita e Çlirimit |
| 08 Dhjetor | Dita Kombëtare e Rinisë |
| 25 Dhjetor | Krishtlindjet |

### Aneksi 10.2 Eventeve me Impakt në Administrimin e Mbetjeve

| | |
|---|---|
| 01 Janar | ‘’Mjedisi i Pastër’’ |
| 5 Qershor | ’’Dita e Mjedisit’’ |
| Çdo të djelë | “Pazari industrial” |
| Çdo të djelë | “Pazari ushqimor” |
| 22 prill | “Dita e tokës” |